

KARAKTERISTIKAT E TREGUT TË PUNËS

DHE POLITIKAT E PUNËSIMIT NË KOSOVË

Doktoranti: **ARTAN HAZIRI**

Dorëzuar:

Universitetit Europian të Tiranës

Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të doktoratës në **Shkenca Ekonomike**, profili **Ekonomi dhe Zhvillim i Qëndrueshëm**, për marrjen e gradës shkencore “*Doktor*”

Udhëheqës shkencor:

Prof. Dr. LULJETA MINXHOZI

Numri i fjalëve: 51800

Tiranë, janar 2017

DEKLARATË E AUTORËSISË

Unë, Artan Haziri, deklaroj se punimi im për marrjen e gradës “Doktor i Shkencave”, i titulluar “Karakteristikat e tregut të punës dhe politikat e punësimit në Kosovë” është më shumë se 51800 fjalë, duke përfshirë figurat, tabelat, bibliografinë, referencat dhe citimet. Kjo temë përmban materiale që nuk janë publikuar më parë për marrjen e ndonjë diplome tjetër apo gradë akademike të mëparshme. Pra, kjo tezë është tërësisht fryt i punës sime.

ABSTRAKTI

Zhvillimi ekonomik i një vendi është faktor kyç i zhvillimit të të gjitha sferave të tjera të jetës në atë vend. Pra, zhvillimi ekonomik ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë edhe në zhvillimin e tregut të punës. Qeveritë e vendeve të ndryshme, vazhdimisht, gjenden para sfidës për gjetjen e zgjidhjeve adekuate për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe uljes së numrit të të papunëve. Edhe Kosova, si vendet e tjera në botë, përballlet me këtë sfidë. Duke qenë një vend i dalë prej lufte që 17 vjet dhe me pavarësi të shpallur para 8 vjetësh, pra një vend dhe ekonomi në zhvillim, pa dyshim, kjo sfidë është edhe më e vështirë. Populli me moshën mesatare më të re në Evropë dhe pamundësia për t'u ofruar mundësi punësimi, çdo ditë e më shumë po e shton pakënaqësinë në popull. E, kjo pakënaqësi po vërehet edhe me numrin e madh të migruesve ilegalë kohëve të fundit, të cilët në pamundësi për të gjetur punë marrin përsipër rrezikun e udhëtimit ilegal drejt Evropës, me shpresë për të gjetur mundësi më të mira punësimi dhe jetese. Mungesa e të dhënave të sakta për numrin e të papunëve e bën vështirë analizimin e kësaj çështje, e kjo ndodh, kryesisht, shkaku i numrit të madh të punëtorëve të paregjistruar, ekonomia informale etj.

Me një GDP prej afërsisht 2.600 € për kokë banori, Kosova është një nga vendet më të varfra në Evropë. Nga 1.8 milion banorë, 34.5 për qind jetojnë në varfëri, me më pak se 1.55 € në ditë (12% jetojnë në varfëri të skajshme, me më pak se 1 € në ditë). Pra, varfëria është shumë e lartë. Nuk ka dallime të dukshme ndërmjet varfërisë në zonat urbane dhe rurale, por ka dallime të mëdha në rajonet e ndryshme të Kosovës, ku shkalla e varfërisë ndryshon prej 53.8 deri në 18 për qind.

Pjesë e punimit do të jetë analiza e një modeli ekonometrik, e që ka të bëjë me lidhjen e arsimit me punësimin dhe lidhjen e arsimit me të ardhurat e individëve. Ky model ngrihet mbi bazën e anketimit të kryer në qytetet kryesore në Kosovë. Kjo është bërë që përfundimet dhe rekomandimet të jenë sa më të sakta.

FUSHA E STUDIMIT: Ekonomia dhe zhvillimi i qëndrueshëm

FJALËT KYQE: *Tregu i punës, papunësia, varfëria*

ABSTRACT

The economic development of a country is a key factor for the development of all other spheres of life in the country. So, economic development affects directly, or indirectly in the development of the labor market. Governments of different countries, constantly found the challenge of finding appropriate solutions for sustainable economic development and reducing the number of the unemployed. Even Kosovo, like other countries around the world, faces this challenge. As a country emerging from war for 16 years, and with the declared independence since 2008, a country with a developing economy, of course this challenge is even more difficult. People with average age of the youngest in Europe, and inability to provide employment opportunities, every day more and more is adding frustration to people. The dissatisfaction was observed even with the large number of illegal migrants in recent months, who are unable to find work, take the risk of traveling illegally to Europe, with the only hope of finding better opportunities of employment and lifestyle. Lack of accurate data on the number of unemployed, made it difficult to analyze this issue, this happens mainly due to the large number of unregistered workers, informal economy etc.

With a GDP of approximately 2,600 € per capita, Kosovo is one of the poorest countries in Europe. 34.5% of the 1.8 million inhabitants live in poverty, on less than € 1.55 per day (12% live in extreme poverty, with less than 1 € per day), so poverty is very high. There are no significant differences between poverty in urban and rural areas, but there are significant differences in different regions of Kosovo, where the poverty rate varies from 53.8 to 18 percent. Part of the paper will be the analysis of an econometric model with regard to the relevance of education to employment and relationship between education with the income of individuals. This model is based on the survey conducted in major cities in Kosovo. This is done with the intention that the conclusions and recommendations to be more accurate.

FIELD OF STUDY: *Economy and sustainable development*

KEY WORDS: *Labor market, unemployment, poverty*

D e d i k i m

Këtë punim ua dedikoj prindërve të mi të dashur, gruas sime dhe vajzave të mia: Arianës, Leartës dhe Suelës. Dashuria, sakrifica dhe mbështetja e madhe e tyre më kanë ndihmuar dhe frymëzuar shumë në punën time.

U jam mirënjohës!

FALËNDERIM

Falënderim dhe mirënjohje pa kufi për udhëheqësin shkencor, Prof. Dr. Luljeta Minxhozi, e cila, me durimin dhe këshillat e saj të pakursyera, më ka mbështetur dhe motivuar gjatë gjithë kohës, që nga momenti i përcaktimit për këtë temë e deri në momentin e finalizimit të saj.

Falënderim për kolegët e mi, të cilët në mënyrë të drejtpërdrejtë a indirekt më ndihmuan në realizimin e këtij punimi. Falënderim i veçantë për Ph.D. Labeat Mustafa (pedagog në Universitetin e Pejës), për këshillat dhe ndihmën e dhënë. Gjithashtu, mirënjohje dhe falënderim i veçantë për sugjerimet dhe kontributin e tij në aspektin teknik për Mr. sci. Valdet Kaçanolli (Business development & Project Manager në Rima Engineering Ltd.), si dhe Mr. sci Petrit Dërguti (zyrtar i lartë në BKT).

E, falënderoj Zotin, për gjithçka që kam.

STRUKTURA E TEMËS

Abstrakti.....	3
Dedikimi.....	5
Falënderimet.....	6
Lista e shkurtimeve dhe fjalorit.....	11
Lista e figurave dhe tabelave.....	13

1. HYRJE.....	17
2. Shtrimi i problemit.....	18
3. Qëllimi i punimit dhe pyetjet kërkimore.....	20
4. Objektivat e studimit.....	20
5. Hipotezat e studimit.....	21
6. Debati aktual mbi problematikën e zgjedhur.....	21
7. Përshkrimi i shkurtër i metodologjisë	23

1. KAPITULLI I: RISHIKIM LITERATURE

Hyrje.....	24
1. Teoritë bazë të punës dhe kapitalit njerëzor në rritjen ekonomike.....	24
1.1. Roli i faktorit punë në zhvillimin ekonomik.....	24
1.2. Roli i arsimit në formimin e kapitalit njerëzor.....	27
1.3. Teoritë bazë mbi tregun e punës dhe pagat.....	30
1.3.1 Teoria Neokejnsiane.....	32

1.4. Rishikimi i literaturës.....	40
1.4.1. Rëndësia e arsimit për të papunët.....	40
1.4.2. Ndikimi i nivelit të arsimit dhe gjinisë në punë.....	41
1.4.3. Investimi në edukimin e të rinjve.....	44
1.4.4. Tregu i Greqisë si hallka më e dobët.....	48
1.4.5. Efektet e arsimit në papunësinë në Evropë.....	50
1.4.6. Moshë, tregu i punës dhe papunësia.....	52

2. KAPITULLI II: KARAKTERISTIKAT E TREGUT TË PUNËS

Hyrje.....	53
2. Tregu i punës (oferta dhe kërkesa e punës) dhe faktorët përcaktues të ekuilibrit të tij.....	54
2.1. Ekuilibri i tregut të punës.....	54
2.2. Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies në arsimin parauniversitar.....	57
2.3. Ndërlidhja më e mirë ndërmjet sistemit arsimor dhe tregut të punës.....	58
2.4. Angazhimi afatshkurtër i ekspertëve dhe studentëve nga diaspora.....	59
2.5. Intervistimi i firmave.....	60
2.6. Bizneset më të mëdha në Kosovë sipas pasurisë dhe të ardhurave.....	63
2.7. Raporti ndërmjet zhvillimit ekonomik të rajoneve dhe fuqisë punë.....	64
2.7.1. Tregjet e punës.....	67
2.8.1 Ligji mbi pagat.....	70
2.8.2 Sindikatat.....	75
2.8.2.1 Historiku i BSPK-së.....	75

2.8.2.2 Legjislacioni për organizimin sindikal.....	76
2.8.2.3 Sindikatat dhe gjendja momentale.....	78
2.9 Roli i qeverisë në përcaktimin e pagës minimale	79
3. KAPITULLI III: PAPUNËSIA NË KOSOVË DHE MIGRIMI	
Hyrje.....	84
3. Dinamika e popullsisë në Kosovë (politikat e punësimit dhe korniza e nevojshme makroekonomike).....	84
3.1 Ç'është papunësia?	86
3.2 Papunësia në Kosovë ndër vite (2000-2014).....	87
3.3 Papunësia sipas moshës.....	94
3.4 Papunësia sipas gjinisë	95
3.5 Punësimi sipas sektorit.....	97
3.6. Migrimi i fuqisë punëtore.....	98
3.7. Migrimi kombëtar.....	99
3.8. Trendet e migrimit në Kosovë.....	100
3.9. Modelet e analizës së kostove dhe përfitimeve	102
3.10. Sa është kostoja e emigranteve që e lëshojnë Kosovën dhe cilat janë masat parandaluese?.....	106
3.10.1. Cila është mundësia për parandalimin e emigrantëve?	108
3.10.2. Hartimi i një strategjie për parandalimin e migracionit nëpërmjet bujqësisë.....	109
3.11. Migrimi i brendshëm	109

3.11.1 Faktorët që shtyjnë apo tërheqin (faktorët Pull-Push) lëvizjen e popullsisë nga njëri rajon i Kosovës në tjetrin, si dhe nga Kosova.....	111
3.12. Pasojat e migrimit.....	114
4. KAPITULLI IV: POLITIKAT PËR RRITJEN E PUNËSIMIT	
Hyrje.....	116
4.1 Indikatorët makroekonomikë të Kosovës.....	116
4.2 Politikat për rritjen e punësimit në Kosovë.....	122
4.2.1 Politikat fiskale të Kosovës.....	123
4.2.2 Politikat monetare-kreditore.....	125
4.2.3 Politikat tregtare të Kosovës.....	128
4.2.4 Politikat e tregut të punës në Kosovë.....	131
4.3. Përfundimi.....	137
5. KAPITULLI V: MODELI EMPIRIK	
5.1 Metodologjia e kërkimit dhe burimet e informacionit.....	139
5.2 Burimet kryesore për vërtetimin e hipotezave	139
5.2.1 Popullata dhe kampioni i studimit.....	139
5.3 Analiza e të dhënave empirike.....	140
5.4. Variablat.....	161
5.5. Regresioni.....	168
6. KONKLUDIMET DHE REKOMANDIMET	169
7. LISTA E REFERENCAVE DHE SHKURTESAVE	179

LISTA E SHKURTIMEVE DHE FJALORIT

IHD	Investimet e huaja direkte
AKP	Agjencia Kosovare e Privatizimit
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
EJL	Evropa Juglindore
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
NVM	Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme
EUCEP	European Center for Elastomeric Powders
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
PBB	Produkti i brendshëm bruto
TI	Teknologjia Informative
BiH	Bosnja dhe Hercegovina
MKD	Maqedonia
MZI	Mali i Zi
SRB	Serbia
IÇK	Indeksi i çmimeve të konsumatorit
AFP	Anketimet e fuqisë punëtore
BSPK	Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës
GDP	Bruto-produkti kombëtar
DSS	Departamenti i Statistikave Sociale
ABEF	Anketa e Buxhetit të ekonomive familjare
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
BE	Bashkimi Evropian

BB	Banka Botërore
DPP	Departamenti për punësim
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
PTK	Posta dhe Telekom i Kosovës
CEFTA	Marrëveshja për tregti të lirë e vendeve të Evropës Juglindore
OBT	Marrëveshja për tregti të lirë
ALMP	Politikat aktive të tregut të punës
DAP	Divizioni i aftësimeve profesionale
SHPP	Shërbimet publike të punësimit

LISTA E FIGURAVE DHE TABELAVE

Lista e tabelave

Tabela 1. Bizneset më të mëdha në Kosovë sipas pasurisë dhe të ardhurave, Burimi: Autori, fq.62.

Tabela 2. Evropa Juglindore (Gjashtë): Rritja reale ekonomike, 2009-12, Burimi: Zyrat kombëtare të statistikave të vendeve të EJT6 dhe stafi i Bankës Botërore.

Tabela 3. EJT6: Rritja reale e prodhimit industrial sipas tremujorëve (në %, vit më vit). Burimi: Zyrat kombëtare të statistikave dhe përlogaritjet e stafit të Bankës Botërore.

Tabela 4. Pagat minimale në Bashkimin Evropian, Burimi: Eurostat, Instituti i statistikave të vendeve përkatëse.

Tabela 5. Shkalla e papunësisë nga burime të ndryshme përgjatë viteve. Burimi: Raporti i performancës MPMS/DPP 06/2010.

Tabela 6. Papunësia e regjistruar 2007-2013. Burimi: Raporti i performancës (Puna dhe punësimi 2013, MPMS).

Tabela 7. Papunësia sipas gjinisë. Burimi: Raport i performancës (Puna dhe punësimi 2013, MPMS).

Tabela 8. Imigrimi ndërkombëtar/kombëtar në Kosovë. Burimi: Raporti i zhvillimit ekonomik në Kosovë, 2011.

Tabela 9. Arsyt kryesore të migrimit kombëtar (brenda dhe jashtë komunës së tyre) të shprehur në përqindje. Burimi: Raporti i zhvillimit ekonomik në Kosovë, 2011.

Tabela 10. Indikatorët kryesorë të tregut të punës në përqindje. Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, Rezultatet e fuqisë punëtore në Kosovë, 2013.

Tabela 11. Imigrimi ndërkombëtar/kombëtar në Kosovë. Burimi: ASK-Kosovë.

Tabela 12. Arsyt kryesore të migrimit kombëtar (brenda dhe jashtë komunës së tyre) të shprehur në përqindje. Burimi: ASK.

Tabela 13. Bruto-produkti vendor 2004-2009. Burimi: MEF, 2009.

Tabela 14. Norma e inflacionit BQK 2003-2009. Burimi: BQK.

Tabela 15. Bilanci tregtar në Kosovë. Burimi: MEF, 2009.

Tabela 16. Struktura e aseteve të sektorit bankar (në milion). Burimi: BQK.

Tabela 17. Bilanci i suksesit i sistemit bankar (në milion). Burimi: BQK.

Tabela 18. Numri i të papunëve të regjistruar. Burimi: MPMS, puna dhe punësimi.

Tabela 19. Hyrjet dhe daljet nga viti 2005-2010. Burimi: MPMS, puna dhe punësimi.

Tabela 20. Kualifikimi i të papunëve, MPMS, puna dhe punësimi. Burimi: MPMS, puna dhe punësimi.

Tabela 21. Numri i të aftësuarve të të papunëve, MPMS, puna dhe punësimi.

Tabela 22. Vërtetimi i hipotezës së dytë.

Tabela 23. Vërtetimi i hipotezës së dytë.

Tabela 24. Anova.

Lista e grafikëve

Grafiku 1. Ekuilibri i tregut të punës. Burimi: Autori, fq. 53.

Grafiku 2. Oferta dhe kërkesa për punë. Burimi: Autori.

Grafiku 3. Rritja ekonomike dhe papunësia në Evropën Juglindore. Burimi: Evropa Juglindore, Raporti i zhvillimeve ekonomike, nr. 3, 18 dhjetor 2012.

Grafiku 4. EJT 6: Inflacioni IÇK dhe ushqimet (%). Burimi: Zyrtar kombëtare të statistikave të EJT6.

Grafiku 5. Ndryshimi në nivelet e papunësisë në EJT6, 2008 dhe 2012 (pikë përqindje). Burimi: Anketimet e fuqisë punëtore (LFS) të zyrtar kombëtare të statistikave.

Grafiku 6. Nivelet e papunësisë, EJT6 dhe BE10. Burimi: Anketimet e fuqisë punëtore (LFS) të zyrtar kombëtare të statistikave.

Grafiku 7. Numri i të papunëve të regjistruar gjatë vitit 2011 (Janar 2011=100). Burimi: Zyrtar kombëtare të statistikave.

Grafiku 8. Nivelet e punësimit në EJT6 (2011-2012) në %. Burimi: Anketimet e fuqisë punëtore (LFS) të zyrtar kombëtare të statistikave.

Grafiku 9. Pagat minimale në shtetet ballkanike, Eurostat, Instituti i statistikave të vendeve përkatëse.

Grafiku 10. Paga minimale në vendet e Evropës, Eurostat, Instituti i statistikave të vendeve përkatëse.

Grafiku 11. Shkalla e rritjes së regjistrimeve. Burimi: Raporti i performancës (puna dhe punësimi 2013, MPMS).

Grafiku 12. Shkalla e rritjes së papunësisë sipas moshës. Burimi: Raporti i performancës (puna dhe punësimi 2013, MPMS).

Grafiku 13. Papunësia e regjistruar sipas gjinisë. Burimi: Raporti i performancës (puna dhe punësimi 2013, MPMS).

Grafiku 14. Vendet e lira sipas sektorit në 12 muaj. Burimi: Raporti i performancës (puna dhe punësimi 2013, MPMS).

Grafiku 15. Vendet e lira sipas pronësisë. Burimi: Raporti i performancës (puna dhe punësimi 2013, MPMS).

Grafiku 16. Neto emigrimi në Evropën Perëndimore, 1983–2003. Burimi: Zyrtat statistikore kombëtare; Anketa e migrimit në Kosovë, 2009.

Grafiku 17. Ndarja e migruesve sipas destinacionit (1959–2009). Burimi: Anketa e migrimit 2009 (Banka Botërore 2010).

Grafiku 18. Moshë mesatare e migruesve. Burimi: Anketa e migrimit 2009 (Banka Botërore 2010).

1. HYRJE

Kosova, që nga paslufta, vazhdimisht është përballur me papunësi shumë të lartë. Shkalla e papunësisë ishte 35- 47 për qind, ndërsa te të rinjtë deri në 65 për qind.

Dhe, shkalla e lartë e papunësisë jo vetëm që nuk është zbutur, por ajo ka një trend të rritjes. Së pari, Kosova ka një shtim shumë të lartë, rreth 30.000 të rinj në vit i shtohen tregut të punës, ndërsa mesatarisht 5.000 vende të reja të punës krijohen në vit, hendek shumë i madh ndërmjet punëkërkuessve të rinj dhe vendeve që krijohen. Duke parë situatën në të cilën gjendemi, shumë qytetarë si zgjidhje e shohin emigrimin. Duke iu referuar statistikave zyrtare, nga Kosova largohen mesatarisht 5.000 qytetarë në vit, me anë të rrugëve legale nëpërmjet martesave ose punës jashtë vendi. Ndërsa, nëse i marrim edhe ata të cilët largohen nga vendi në mënyrë ilegale, ku në fund të vitit 2014 ishte edhe fluksi më i madh, atëherë ky numër do të jetë shumë më i madh. Por, edhe pse është tragjike që afër 150.000 qytetarë e lëshuan vendin, kjo ka ndikuar që sadopak të ketë rënie në listat e punëkërkuessve.

Qeveria e Kosovës thaujse në asnjë mandat të saj nuk e kishte prioritet punësimin apo hapjen e vendeve të reja të punës, e me këtë edhe zhvillimin ekonomik. Rritja ekonomike viteve të fundit ishte gati në nivel të njëjtë përgjatë 5 viteve të fundit. Investimet e huaja nga viti në vit kishin rënie, ku mund të veçojmë vitin 2014, si vit me ngecjen më të madhe të Kosovës, rritje rreth 1 për qind ekonomike, rritja më e vogël që nga paslufta, IHD-të më të ulëta, rrjedhimisht më së pakti vende të reja pune të krijuara. Nëse mund ta quajmë vit i dështuar i Kosovës sa i përket aspektit ekonomik, në vitin 2015 vërehet një ndryshim i vogël pozitiv sa i përket instrumenteve ekonomike. Në secilin aspekt mund të themi se kemi rritje krahasuar me vitin 2014, mirëpo as ky ndryshim nuk mund t'i përballojë as kërkesat nga punëkërkuessit e rinj, e jo me ata që janë të rregullt në lista në zyrat për regjistrim në gjithë vendin. Politikat e Qeverisë, sa i përket punësimit, viteve të fundit ishin më shumë të orientuara në sektorin publik, ku janë punësuar një numër i konsiderueshëm, ndërsa sektori privat është lënë anash. Shumë pak vëmendje kësaj problematike po i kushtohet nga ana e shtetit, i cili sektor gjeneron vende të reja të punës, nëse krijohen parakushtet për investuesit, ligji për biznes.

Qeveria e Kosovës në këtë mandat, në strategjinë e saj, ka përfshirë edhe agro-kulturën, e cila nuk ishte marrë në konsideratë deri më tani. Mirëpo, agro-kultura është një sektor shumë i fuqishëm për Kosovën, duke parë traditën e popullit tonë që e ka pasur dikur. Pra, me pak kujdes e mbështetje financiare, me anë të subvencioneve të ndryshme në bujqësi e blegtori, do të hapeshin shumë vende të reja të punës, duke shtuar edhe prodhimin në shumë produkte, si: qumësht, mish, pemë dhe perime. Kosova është importuese gati e të gjitha produkteve, ndërsa me disa investime dhe subvencione do të kishte efekt të shumanshme ekonomike, e ku rëndësi të madhe ka krijimi i vendeve të punës.

Ndër shkaqet e papunësisë së lartë është edhe sistemi arsimor në Kosovë, i cili nuk është në funksion të tregut të punës, e që pas diplomimit studentët përballen me vështirësi për të gjetur punë, shkak i aftësisë joadekuat, mungesës së vendeve të punës dhe profileve të gabuara.

Andaj, mendoj se duhet të zbatohet një strategji e mirëfilltë për zhvillimin ekonomik me politika industriale; të identifikohen sektorët industrialë prioritarë dhe të përkrahen me politika fiskale, monetare, tregtare dhe me subvencione në prodhim. Të mbështetet sektori privat, sidomos në prodhim dhe eksport, në mënyrë që të krijohen vende të reja pune. Të luftohet ekonomia joformale. Të ringjallet zejtaria bashkë me turizmin. Ndërsa, sistemi arsimor në vend duhet t'i forcojë lidhjet me tregun e punës. Të sigurohet zbatimi i ligjeve të punës dhe konkurrenca e mirëfilltë pa favorizime politike për kompani.

2. Shtrimi i problemit

Papunësia, si problem me peshë dhe kosto mjaft të lartë për shoqërinë dhe ekonominë, i ka shkaktarët direkt dhe indirekt, e që mundësojnë që ky lloj problemi të jetë një barrierë për zhvillimin e mëtutjeshëm ekonomiko-social. Elementet ekonomike që shkaktuan një shkallë të lartë të papunësisë në Kosovë, ndër të tjerash, janë: privatizimi, mungesa e IHD-ve, politika fiskale jo e favorshme për bizneset etj.

Privatizimi: Sipas përlllogaritjeve të AKP-së, ndërmarrje shoqërore janë diku mbi 600, të cilat janë privatizuar deri në vitin 2016 në tërësi, ndërsa paradoksi ekonomik është se prej të gjitha ndërmarrjeve të privatizuara numri i punëtorëve të punësuar pas privatizimit është rreth 80 për qind më i vogël sesa numri i punëtorëve që kanë punuar po aty.

Fakt tjetër, e që e bën privatizimin si njërin prej shkaktarëve kryesorë të papunësisë në Kosovë, është mënyra e privatizimit, ngase këto ndërmarrje të privatizuara para se të privatizoheshin kanë realizuar 90 për qind të prodhimit industrial në Kosovë, ndërsa sot ato janë shndërruar në depo, pishina, restorante, hotele etj. Pra, pa pasur një kriter fundamental të privatizimit që t'i kushtëzojë pronarët që pas blerjes së ndërmarrjes të vazhdojnë veprimtarinë ekonomike përkatëse që ka pasur ndërmarrja para privatizimit.

Prandaj, privatizimi është duke e ngulfatur gradualisht zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe është duke e bërë të pamundur dhe vështirë të realizueshëm këndelljen ekonomike të Kosovës, e që ato ndërmarrje kanë qenë katalizatorë të prodhimit vendor, e që sot janë shndërruar në makina të prodhimit të njerëzve të papunë.

Si shkaktarë kryesorë të rënies së investimeve janë:

Mungesa e garantimit të investimeve, tregu i kufizuar, jostabiliteti politik, mungesa e ligjeve, uji, dogana, mungesa jo e mjaftueshme me furnizim me rrymë elektrike. Sot çdo vend në botë është në garë për thithje të investimeve nga jashtë, sepse ato janë një shtyllë e fuqishme për uljen e papunësisë dhe çdo investim ka edhe anën tjetër që rritet besimi për investitorë të tjerë. Investimet e huaja kanë rënë dukshëm ndër vite dhe si pasojë e saj Kosova në vitet e ardhshme do të ketë vështirë t'i kthejë investitorët, sepse ata e kanë humbur besimin në tregun e Kosovës. Politika fiskale jo e favorshme për bizneset: Edhe me pakon e re fiskale barra i bie bizneseve vendore me tatime e taksa të llojllojshme, e që për ATK-në janë objektiva kryesore mbledhja e tyre, e, në fakt, objektivi i tyre duhet të ishte stimulimi i bizneseve nëpërmjet zvogëlimit ose heqjes së taksave, e jo ngarkimit me normë tatimore.

Çdo vit në Kosovë shuhen afro 2.500 biznese, kryesisht të vogla, për shume arsye, por më kryesorja tatimet janë tejet të mëdha, ligjet që ndryshojnë shpesh, taksa që ndryshojnë përqindjen e saj, e arsye të tjera të formës fiskale.

Pra, mund të konkludojmë se privatizimi ishte tejet jo funksional për të mirën e ekonomisë kosovare. Ai, në vend se të jetë shtyllë e zhvillimit ekonomik, u bë pengesë e saj, e aq më keq kur atë e shoqëron edhe korrupsioni tejet i lartë, si në institucionet shtetërore, po ashtu, edhe në ato private. Mungesa e investimeve të huaja direkte, e që çdo vjet është duke u zvogëluar në

mungesë të sigurisë ekonomike, e, po ashtu, mungesa e një politike të mirëfilltë fiskale, e ku në vend që t'u shërbejë bizneseve dhe punësimit, i shërben mbulimit të deficitit buxhetor.

Papunësia, përveç pasojave ekonomike, ka edhe pasoja indirekte në fushën sociale, ngase Kosova sot është duke humbur shumë shkaku i papunësisë në fushën sociale, ku problematika më e madhe që po shkakton papunësia është migrimi i shumë kuadrove të shkolluara dhe të cilët kanë kualifikime për deficite shkencore në Kosovë.

3. Qëllimi i punimit

Ky studim përpiqet t'i analizojë efektet e arsimit sa ata që arsimohen duhet të presin për të gjetur punë. Gjithashtu, bëhet analiza se te të rinjtë që arsimohen sa ndikon arsimimi i tyre në rritjen e nivelit të të ardhurave. Qëllim tjetër është identifikimi i politikave që po përdor qeveria për uljen e papunësisë dhe dhënien e rekomandimeve se cilat politika duhet bërë që të shtohet numri i të punësuarve.

Pyetjet kërkimore që shtrohen janë:

1. Cili është roli i arsimit në formimin e kapitalit njerëzor?
2. Cili është roli i arsimit në rritjen e të ardhurave të individëve?

4. Objektivat e kërkimit

Objektivi kryesor i këtij punimi është analizimi dhe studimi i efekteve të arsimit në rritjen e të ardhurave të individëve në Kosovë. Objektivat kryesore janë:

- a) Analizimi i rëndësisë që ka arsimi në Kosovë;
- b) Studimi dhe analiza e ndikimit të arsimit në rritjen e të ardhurave;
- c) Studimi i politikave publike në Kosovë dhe ndikimi i tyre në uljen e papunësisë.

5. Hipotezat e studimit

I theksojmë edhe hipotezat bazë të këtij punimi:

- a) Niveli arsimor ndikon pozitivisht në zvogëlimin e kohës së të qenit i papunë,
- b) Niveli i arsimit ndikon pozitivisht në rritjen e të ardhurave të individëve.

6. Debati aktual mbi papunësinë

Sot në Kosovë punësimi nuk është vetëm temë debati, por është një sfidë e cila tashmë ka prekur jetën e çdo e qytetari, duke pasur parasysh situatën në të cilën gjendemi, e cila tashmë ka filluar të duket e pashpresë.

Shumë të rinj e të reja kanë marrë rrugën e Perëndimit për një jetë më të mirë, si zgjidhje për të ardhmen e tyre, zgjidhje të cilën më nuk e shohin në Kosovë. Por, ata nuk janë vetëm të rinj të paarsimuar, ngase shumica e kanë të kryer arsimin universitar. Mirëpo, në Kosovë nuk shohin të ketë vend edhe për ta. Fatkeqësisht, edhe të rinjtë që s'kanë emigruar përballen me këtë problem, i cili besoj se është më shumë si paaftësi e qeverisë, dikastereve të saj, e, po ashtu, edhe i agjencive të "pavarura" shtetërore, nëse mund t'i quaj kështu. Kosova është vend i dalë nga lufta, e që pothuajse tërësisht ishte e shkatërruar, me shumë të vrarë e të zhdukur, por edhe me shumë invalidë lufte. Kishte dëme të konsiderueshme materiale, shtëpi të shkatërruara, të djegura deri në themel, ekonomia e saj ishte pothuajse jashtë funksionimit total. Mund të them se qershori i vitit 99 për Kosovën, përveçse ishte vit i lirisë, ishte viti zero i saj. Ishte viti zero në kuptimin se secili qytetar, por edhe Kosova si tërësi, është dashur të fillojnë nga zeroja. Vitet e para të pasluftës ishin me shumë shpresë dhe te secili qytetar vërehej një pasion, një energji e paparë në ndërtimin e Kosovës, kuptohet me ndihmën ndërkombëtare, sidomos të SHBA-ve.

Kështu, dalëngadalë, vendi filloi të ndërtohej, popullata të sigurojë, të paktën, kulm mbi kokë. Dhe, me kalimin e viteve sfidat sa vinin e shtoheshin. E, njëra ndër to, e që e ka mbërthyer Kosovën, është papunësia, e cila gjatë gjithë këtyre viteve e ka përcjellë me shifra alarmante, me një popullsi shumë të re në moshë (mosha mesatare afërsisht 26 vjeç), që e kanë lakmi shumë

vende të botës. Kosova nuk ka ditur ta shfrytëzojë këtë kapital të fuqishëm njerëzor dhe jo vetëm që nuk ka ditur ta shfrytëzojë, por ka lejuar që t'i bëhet barrë asaj, ani pse në vitet e para pas çlirimit të Kosovës shteti filloi t'i ndërtojë institucionet shtetërore, si, parlamentin, qeverinë e instancat e tjera. Raporte të ndryshme vlerësonin se në vitin 2002 papunësia në Kosovë ishte afër 45%, me treg të punës aktive 60%, pra diku vetëm afër 20% punësim.

Edhe pse vendi ishte në fazën e parë të tranzicionit, shifrat ishin alarmante, duke pasur parasysh popullatën e re, ku çdo vit hynin rreth 25.000 të rinj në tregun e punës, e, në anën tjetër, Kosova krijonte diku afër 7.000 vende pune, numër ky i pamjaftueshëm as për ta mbajtur në nivel punësimin. Gjatë viteve në vazhdim, pra 2003-2007, Kosova me anë të ndihmës ndërkombëtare filloi të rimëkëmbë ekonominë e saj, kryesisht nëpërmjet procesit të privatizimit, ku një numër i madh i ndërmarrjeve është privatizuar nga investues vendorë e të huaj. Por, ndërmarrjet janë privatizuar me shuma simbolike, në emër të asaj që të rivitalizohen e të rritet numri i të punësuarve. Mirëpo, përveç disa ndërmarrjeve, shumica kanë rënë në duar të zhatësve ekonomikë, e të cilat ndërmarrje kanë mbetur në pozitën vendnumëro.

Shkalla e lartë e papunësisë me norma të larta prej 40% assesi të zbutej, qeveria nuk kishte politikë konkrete strategjike për punësim. Politikat qeveritare edhe sot janë më shumë të natyrës makroekonomike, me projekte infrastrukturore apo edhe të privatizimit të ndërmarrjeve të mëdha, që të ulë papunësinë. Tutje, ekonomia e Kosovës gjatë viteve 2009-2011 karakterizohej, po ashtu, me normë të lartë të papunësisë, e cila ishte sfida kryesore për stabilitetin ekonomik dhe social të vendit. Norma e rritjes ekonomike nuk po arrinte të absorbonte punëtorë në vend, e cila vazhdimisht karakterizohej me rritje, si rezultat i strukturës së re të popullsisë, problem që vazhdon të jetë akoma. Gjatë vitit 2011 zyrtarisht shkalla e papunësisë ishte 45.1 për qind dhe rritja e fuqisë punëtore në Kosovë vjen si rezultat i strukturës së re të popullsisë.

Sipas të dhënave të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), numri i punëkërkuesve aktiv, të regjistruar në MPMS në fund të vitit 2011, ishte 325.261 punëkërkues, afër 3% më pak punëkërkues se në vitin 2010. Dhe, kjo jo që ishte meritë e qeverisë në punësimin e punëkërkuesve, por zhgënjimi i tyre për të kërkuar punë ka bërë që ky numër të jetë më i vogël se vitin paraprak.

Edhe viteve të fundit, pra, 2012-2015, Kosova ballafaqohet thuajse me norma të njëjta të papunësisë rreth 36%, mirëpo shkalla më e lartë është te të rinjtë me mbi 70%. Pakënaqësia dhe mosbesimi që të gjejnë punë ka ndikuar që shumë persona më as që kërkojnë punë, që do të thotë se nuk janë punëkërkuar aktiv, se, përndryshe, shifrat do të ishin shumë më të larta. Nga paaftësia e qeverisë për të krijuar vende të reja të punës rreth 100.000 qytetarë kanë marrë rrugën e Perëndimit në fund të vitit 2014, kuptohet për jetë më të mirë.

Edhe pse qeveria kishte premtuar me mijëra vende pune dhe zhvillim ekonomik, nëse marrim për bazë statistikën e këtyre viteve, punësimi sërish nuk është as sa gjysma e atyre që hyjnë në treg të punës. Shifrat tregojnë se gjatë këtij viti që po e lëmë pas, pra 2015, janë krijuar vetëm 4.000 vende të reja pune, kurse në treg të punës kanë hyrë rreth 20.000 persona të aftë për punë, shifra këto që jo vetëm se nuk arrijnë ta zbusin papunësinë, por, nëse nuk merren masa nga ana e shtetit, vendi shkon drejt një kolapsi, i cili mund të shpërthejë me protesta të dhunshme. Sipas statistikave, janë më shumë se 350.000 punëkërkuar të regjistruar, ndërsa ka edhe shumë të tjerë që s'kanë shprehur interesim për t'u regjistruar pasi që nuk besojnë se institucionet relevante mund t'u ofrojnë punë.

7. Metodologjia e hulumtimit

Metodologjia e punimit është bërë me metodën kuantitative (sasiore), siç bëhen shumica e punimeve. Kjo metodologji përfshin analiza statistikore-matematikore dhe numerike të të dhënave të mbledhura nëpërmjet anketimeve, pyetësorëve dhe anketave, duke përdorur teknika kompjuterike. Programi i përdorur për këto analiza është SPSS, që, njëherësh, është edhe programi më i përdorur për të bërë analiza statistikore në botë.

KAPITULLI I

RISHIKIMI I LITERATURËS

Hyrje

Kosova është në grupin e vendeve me papunësinë më të lartë në rajon. Mirëpo, pozita ku Kosova ka synim të arrijë, puna dhe kapitali njerëzor konsiderohet si aset më i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik. Kur themi kapital njerëzor kemi parasysh rolin e arsimit në ngritjen dhe formësimin e tij, duke ofruar, kështu, shkathtësitë kyçe që kërkohen në tregun e punës. Sa më i lartë që është niveli i arsimit aq më i lartë do të jetë niveli i të ardhurave. E gjithë kjo rezulton edhe me rritjen e probabilitetit për forcën punëtore të Kosovës për punësim jashtë vendit, që do të ndikonte në rritjen e remitencave për kokë banori në Kosovë. Shpenzimet në arsim duhet të shihen si investime, kthimet nga të cilat e përshpejtojnë rritjen ekonomike. E gjithë kjo shpie te konkludimi se qeveria e Kosovës do të duhej ta ketë prioritet ndërtimin dhe zhvillimin e sistemit arsimor në vend dhe, si rrjedhojë, kjo do të ndikojë edhe në zhvillimin ekonomik të vendit.

1. Teoritë bazë të rolit të punës dhe kapitalit njerëzor në rritjen ekonomike

1.1 Roli i faktorit punë në zhvillimin ekonomik

Zhvillimi ekonomik është një ndër shtyllat kryesore të mirëqenies së qytetarëve në vend. Nuk mjafton vetëm rritja ekonomike që po pretendohet nga liderët e vendeve të ndryshme nëse mungon efekti i shërbimeve sociale. Nëse shërbimet shëndetësore nuk japin rezultate, niveli i arsimit nuk i përshtatet vendit dhe integriteteve rajonale. Pabarazia është madhe mes shtresave, varfëria dhe papunësia zënë vend, fjalën kryesore e ka korrupsioni, ligji i diskriminon qytetarët, liria e fjalës mbetet në letër etj. Por, të gjitha këto duhet t'i japin formë jetës normale në vend. Nga i gjithë ky kompleks faktorësh, të cilët janë përbërës të zhvillimit ekonomik, ne do ta veçojmë kontributin e faktorit punë në zhvillimin ekonomik, më tutje në zhvillimin e vendit.

Faktori punë ka ndikim të madh si në aspektin mikroekonomik, po ashtu, edhe makroekonomik, ngase në bazë lidhet me faktorët e tjerë të prodhimit. Prandaj, në raport me këta faktorë shndërrohet si variabël i pavarur, p.sh., toka mund të jep rendimente nëse dimë ta

shfrytëzojmë, burimet nëntokësore mundë t'i shfrytëzojmë në mënyrë racionale nëse mendojmë për të ardhmen. Po ashtu, kapitalin kur e përdorim me efikasitet jep rezultate të mahnitshme, prandaj nga këndvështrimi i efikasitetit puna është ndikim i vazhdueshëm progresiv.

Se puna është pika referuese e suksesit në vend nuk ka dyshim, por çështja për diskutim mbetet te mënyra e bërjes së punës, motivi për të punuar, shpresa dhe vizioni për të ardhmen, reflektimi i punës. Shpeshherë dëgjojmë zëra të ndryshëm për konceptimin e punës, në instanca të ndryshme njeriu, edhe kur është duke fjetur, organizmi i tij shpenzon energji, ngase është duke funksionuar/punuar. Mirëpo, në ekonomi rezultatin e punës ekonomike do ta veçojmë nga puna jo progresive, ngase mënyra e të punuarit jep efekt në zhvillimin ekonomik.

Nëse analizojmë faktorin punë në raport me rritjen ekonomike, vërejmë se kjo do të ndikojë në zhvillimin ekonomik. Dihet se sasia e prodhimit është funksion i punës, kapitalit, tokës, teknologjisë, aftësive ndërmarrëse etj. Si në afat të shkurtër, po ashtu, edhe në afat të gjatë të politikave qeveritare, puna nuk mbetet konstante. Nëse e marrim shtetin tonë të sapoformuar, faktet historike dëshmojnë se rritja ekonomike e Kosovës ka qenë proporcionale me mundësinë e kosovarëve që të qeverisin vetveten, si dhe me çështjet të cilat janë shumë të ndërlidhura me stabilitetin politik (Riinvest, 2006).

Tregues i zhvillimit ekonomik është jetëgjatësia e qytetarëve, ngase sa më gjatë që njerëzit jetojnë aq më shumë shprehin përvojën e tyre, sidomos në aspektin shkencor dhe intelektual. Të dhënat flasin se pas moshës 55 vjeç menaxherët në kompani mund të jenë të suksesshëm si këshilltarë, përderisa pas moshës 65 kompanitë aziatike-lindore nuk heqin dorë nga dituria e menaxherit profesionist, prandaj i njohin si ambasador të llojit të vet, të cilët i përfaqësojnë kompanitë në tubime të ndryshme të promocionit (Ramosaj, B., 2002).

Proceset bazike të zhvillimit ekonomik nisin nëpërmjet programeve të punësimit, të iniciuara nga qeveria, ngase papunësia ndikon në uljen e PBV-së, uljen e buxhetit, rritjen e korrupsionit, nepotizmit, kriminalitetit etj. Dhe, të gjitha këto mund të reflektojnë pozitivisht nëpërmjet punësimit. Papunësia është fenomen dëmtues, pasojat e së cilës reflektohen çdo kund. I papuni është në stres të vazhdueshëm dhe gjasat janë të pritshme për veprime negative. Për shkak të mospërmbushjes së obligimeve familjare dominon pakënaqësia. Bizneset i humbin klientët e

tyre, ngase nuk kanë para për treg. Nëse bizneset nuk kanë shitje ato janë të pritura për t'i larguar punëtorët nga puna, shteti i humbë tatimet nga punëtorët dhe firmat, prandaj qeverisë i shtohet një barrë për financimin e të papunëve.

Duhet të krijohet një qasje e mirëfilltë për kontributin e të punësuarve. Përshtatja e vendit të punës për femra, ngase ekzistojnë shumë punë që janë stresuese për femrat, sidomos për nënat që i kanë fëmijët e tyre larg nga vetja, për këtë duhet të dizajnohet orar i veçantë me kushte të përshtatshme. Profesionistët duhet të punojnë në vende adekuate, duke shprehur aftësinë e tyre dhe të motivuar.

Bizneset duhet të stimulohen me një program të veçantë qeveritar. Të dhënat nga ndërmarrësit kosovarë flasin se për të ngritur një biznes prodhues në Maqedoni ofrohet toka falas, e, po ashtu, një politikë fiskale stimuluese me zero për qind tatim për pesë vite, andaj kjo ka tendencë të zhvillimit ekonomik. Infrastruktura ligjore për biznese duhet të jetë joshëse, siguria për investime, konkurrenca fer-play etj.

Zhvillimi ekonomik ndodh nëse kemi harmonizim të zhvillimit të sektorëve ekonomikë, me theks të veçantë në angazhimin e fuqisë punëtore në të gjitha fushat ekonomike, e sidomos ato me prioritet. Në vendet e rajonit përreth vërehet një grumbullim i fuqisë punëtore në mjedise urbane, ku ofrohen kushtet për një standard më të mirë të jetesës. Kurse, viset rurale mbesin pa investime dhe, si rrjedhojë e kësaj gjendje, kemi fenomenin e emigrimit. Kësaj shtate i ndihmojnë masat jo shtrënguese fiskale për eksporte, po ashtu, produktet e prodhuara gjenetikisht të modifikuara, e që nuk bartin pasoja vetëm ekonomike, por edhe shëndetësore.

Meqë bujqësia është degë tradicionale dhe parësore për zhvillimin e shumë degëve të tjera, ajo absorbon një numër të madh të punëtorëve. Në këtë sektor prodhohen produkte natyrale që reflektohen në ruajtjen e shëndetit të njerëzve, ku do të shërbejë si preventivë dhe do të zvogëlohen shpenzimet shëndetësore.

Në instancë të fundit mbetet puna ajo e cila do të jep rezultate, se, nëse rritet produktiviteti i punës, kemi rritje më të qëndrueshme të zhvillimit ekonomik. Produktiviteti është aftësia e punëtorit për të dhënë rezultate dhe për t'i shtuar ato, vazhdimisht. Duhet që të hulumtohen avantazhet e punëtorit në punë dhe të kultivohen ato. Punëtorët që e kanë dobësi ndonjë çështje paraqesin element destabilizimi në sistemin e punës, p.sh., për punët e obliguara që do t'i

kryejë punëtori vetëm se është pajtuar me kontratë pune. Mirëpo, ndodh që disa aktivitete të kryhen nga grupi në mënyrë vullnetare, e për ndonjë anëtar të grupit krijohet përshtypja se është punë obliguese.

Faktorët që ndikojnë te punëtori janë: faktori monetar (paga) dhe faktorët jo monetarë (motivi, tradita, siguria në punë, ambienti, menaxhmenti etj.). Nëse punëtorët marrin pagën sipas aftësive, arsimimit, përgjegjësisë etj., atëherë ato do të jenë të kënaqur me pagën e tyre. Po ashtu, benifitet janë një element shtytës në punë. Motivi është nxitja e brendshme nga do të rezultojnë sukseset në punë. Punëtorit nëse ia humbë shpresën për të ardhmen, ai e humbë motivin për punë, prandaj një ndërmarrje vepron si një makinë, pa sens kreativ. Edhe tradita ka rëndësi në marrëdhëniet e punës. Po ashtu, edhe siguria e motivon punëtorin. Ambienti dhe rrethi mund t'i sjellë komoditet dhe rahatit punëtorit. Menaxhmenti, i cili ofron bashkëpunim me punëtorët, i motivon punëtorët, duke ua bërë me dije se edhe ata janë vendimmarrës në proceset e suksesit.

Arritja dhe mbajtja e zhvillimit ekonomik kërkon punëtorë, të cilët janë të specializuar në fusha të ndryshme. Punëtorët, të cilët janë të specializuar në punë, japin rezultate më shumë, ngase edhe produktiviteti është më i lartë. Puna më e mirë është ta kapësh një aktivitet dhe sa më shumë ta përvetësosh deri në maksimum.

1.2 Roli i arsimit në formimin e kapitalit njerëzor

Arsimi është imperativi kryesor i të gjitha kohëve në zgjidhjen e problemeve. Kjo i jep vlerën e duhur çështjes sociale dhe ekonomike. Një shoqëri me arsimim të mirëfilltë e kupton se kapitali njerëzor është pararojë e ekonomisë. Nuk mund të paramendohet një shoqëri me ekonomi të zhvilluar dhe administratë funksionale pa arsimim. Nëse i analizojmë vendet në zhvillim, do të jepen afërsisht rezultatet e njëjta, për shembull, në vendin tonë janë bërë investime në shumë fusha, mirëpo institucionet arsimore kanë përjetuar zhvlerësim si në aspektin e plan-programeve, po ashtu, edhe të personelit dhe menaxhmentit arsimor, ngase të arsimuarit nga këto institucione kanë dhënë pak rezultate praktike, të cilat reflektohen në zhvillim ekonomik, politik, social, shëndetësor dhe të sigurisë.

Kapitali njerëzor është një koncept i gjerë dhe shumëdimensional që përfshin shumë lloje të ndryshme të investimeve në njerëz (De la Fuente, Angel. & Ciccone, Antonio., 2002). Kapitali njerëzor përfshin një konglomerat aftësish, sjelljesh, mënyra për të dhënë produktivitet në mirëqenien e përgjithshme të vendit. Ne do të fokusohemi në arsimimin, si një ndër komponentët e ngritjes së kapitalit njerëzor. Arsimimi krijon shpenzime, të cilat në vazhdim nuk do t'i konsiderojmë si të tilla, ngase shpenzimet shuhen, por do t'i referohemi si investime. Investimi në arsim është investim indirekt, ngase na kthehet pas një kohe të gjatë dhe, ndoshta, jo në para, por në shërbime të ndryshme, si në shëndetësi, siguri, drejtësi etj.

Ashtu si çdo tjetër, edhe investimi në kapitalin human nuk do të kishte kuptim të ndërmerrej në qoftë se individit nuk do t'i siguronte një përfitim të caktuar. Përfitimi që realizohet nga një investim në kapitalin human paraqitet në dy forma:

- Përfitimi monetar,
- Përfitimi jo monetar.

Përfitimet monetare kanë të bëjnë me rritjen e të ardhurave gjatë gjithë periudhës sa individit është në punë aktive. Kurse, përfitimet jo monetare kanë të bëjnë me përmirësimin e kushteve të punës, në të cilat do të punojë individit dhe pozitën të cilën do ta gëzojë individit i arsimuar në shoqëri.

Arsimimi dhe përgatitja nëpërmjet punës i rrisin të ardhurat e individit, sepse ai është i pajisur me njohuri tekniko-profesionale të vlefshme, të cilat ndikojnë në rritjen e produktivitetit të punës së tyre. Duke pasur parasysh se produktiviteti i punës është përcaktuesi kryesor i nivelit të pagës, atëherë del se sa ma i lartë të jetë produktiviteti i punës aq më e lartë do të jetë edhe paga.

Investimi në kapitalin human ka edhe një përfitim shoqëror, e kjo për faktin se sa më i lartë të jetë niveli arsimor dhe përgatitja tekniko-profesionale e anëtarëve të shoqërisë, aq më i madh do të jetë potenciali intelektual i shoqërisë në tërësi, pra aq më të mëdha janë mundësitë për përparim dhe zhvillim (Qirici, Stefan.,2005)

Se arsimimi luan rol të rëndësishëm në ngritjen e kapitalit njerëzor s'ka dyshim, mirëpo përpjekjet për një arsimim të mirëfilltë përherë kanë qenë në agjendë të diskutimeve. Niveli i

shkollimit duhet t'i përshtatet shoqërisë dhe tregut të punës, pa i anashkaluar proceset e globalizimit në këto dimensione. Përherë Ministria e Arsimit duhet të bashkëpunojë me Odën Ekonomike, me përfaqësuesit e ndryshëm të firmave, bashkë me përfaqësuesit e prindërve dhe shoqërinë civile, me qëllim të gjetjes së një alternative më të mirë për përgatitjen e gjeneratave të reja, të cilat do të jenë të gatshme të ballafaqohen me sfida në të ardhmen.

Plan-programet arsimore duhet të jenë sipas nevojave të tregut të punës dhe ngritjes së mirëqenies së përgjithshme, sidomos ato në shkollat profesionale. Po ashtu, literatura duhet të jetë në përputhje me nivelin e shoqërisë, të arriturat vendore dhe ndërkombëtare. Personeli arsimor të jetë me kualifikime të duhura profesionale dhe pedagogjike. Infrastruktura ligjore e adaptuar për ngritjen vetëdijes së nxënësit. Në vendin tonë, shpeshherë, vërehet ngarkesa në të mësuarit, p.sh., nxënësi obligohet që të mësojë për diçka që asnjëherë nuk do i shërbejë aplikimi i asaj njohurie apo do ta mësojë gabimisht dhe pa fakte shkencore.

Të dhënat flasin se në vendet e zhvilluara institucioni shkollor, së bashku me prindërit, e dikton drejtimin e fëmijëve në nivel të mëtejshëm të arsimimit, kurse në vendin tonë kjo përgjegjësi, në shumicën e rasteve, u lihet vetë fëmijëve. Por, kjo nuk ndodh edhe te familjet e arsimuara, ku përcaktues janë prindërit me fëmijët e tyre, të cilët, me rastin marrjes së vendimeve, i analizojnë faktorët e ndryshëm: socialë, politikë, materialë, kohorë, profesionalë, kapacitetin e fëmijës etj.

Shoqëria ka përgjegjësi të madhe në sjelljen e individit, p.sh, nxënësi mund të bëjë një gabim në publik dhe askush nuk e këshillon, apo nxënësi vazhdimisht i frekuenton disko-klubet. Po ashtu, vozitësi i autobusit e ngritë zërin e muzikës sipas dëshirës së të rinjve, duke dalë nga esenca e transportit publik. Po ashtu, të ndikuar nga proceset e teknologjisë globale, nxënësit i shfrytëzojnë rrjetet sociale të internetit pa arsye, pothuajse çdo nxënës e përdor celularin e tij pa arsye, duke mbajtur në të imazhe devijimi. Prandaj, krejt këto dhe faktorët e tjerë, e bëjnë shumë më atraktiv ambientin e jashtëm sesa atë shkollor dhe familjar.

1.3 Teoritë bazë mbi tregun e punës dhe pagat

Tregu i punës është vendi ku takohet oferta dhe kërkesa për punë. Ofertat dhe kërkesat i kanë veçoritë e tyre dhe janë në kundërveprim me njëra-tjetrën deri në momentin e ekuilibrit. Interesi i punëtorit, pos të tjerash, është që të arrijë një pagë të lartë, me të cilën do i plotësojë ambiciet e veta, kurse firmat përherë kanë tendencë për paga të ulëta, me qëllim të uljes së kostos në prodhim. Mirëpo, në këtë strukturë ekziston edhe interesi i shtetit, i cili i orienton politikat e veta drejt stabilizimit të punësimit dhe arritjes së mirëqenies ekonomike nëpërmjet ekuilibrit të tregut të punës. Oferta e punës përfshin aftësitë fizike dhe intelektuale që i ofron individit për një kohë të caktuar dhe me një pagë të caktuar, kurse kërkesa përfshin firmat dhe institucionet e tjera, të cilat kërkojnë punë me një pagë të caktuar për t'i realizuar aktivitetet e tyre.

Tregu i punës e cakton çmimin e fuqisë punëtore - pagën. Të dhënat teorike flasin se ekzistojnë tri forca të mëdha, të cilat ndikojnë në procesin e tregut të punës, rrjedhimisht pagës, siç janë:

Forca e tregut, e cila përbëhet nga oferta dhe kërkesa për punë, e që ka ndikim të rëndësishëm në ndryshimin e pagës (Qirici, Stefan., 2005). Në këtë kontest pagat janë fenomene makroekonomike dhe, si të tilla, nuk mund të ndryshohen nga individët, pos që individët t'i përshtaten tregut të fuqisë punëtore. Nëse themi se punëtorët e ndërtimtarisë paguhet me dy euro për orë pune, kurse mjeshtri i ndërtimtarisë paguhet me katër euro për orë pune në nivel vendi, atëherë çdo individ, i cili e ka profesionin e caktuar, do të paraqitet në tregun e punës me pagë të diktuar nga tregu i punës.

Forca institucionale, e cila përfshin sindikatat, qeverinë dhe korporatat, të cilat japin efekt në nivelin e pagave (Qirici, Stefan., 2005). Punëtorët, të cilët janë anëtarë të sindikatës, në raste të caktuara, shprehin pakënaqësi për nivelin e pagave të ulëta, prandaj i shfrytëzojnë sindikatat, të cilat në mënyrë institucionale bëjnë presion për ngritjen e nivelit të pagave, ndonëse qeveria, në raste të recesionit ekonomik, ka tendencë që, të paktën, t'i zvogëlojë benefitet e punëtorëve, apo ta ulë shkallën tatimore, me qëllim që të rritet fuqia blerëse e qytetarëve. Korporatat i rrisin pagat atëherë kur rritet produktiviteti i punës, e tutje vazhdojnë edhe me bonuse të punëtorëve.

Forca sociologjike që e përbëjnë grupet, klasat shoqërore, prejardhja familjare, kultura, zakonet, tradita, diskriminimi etj., të cilat kanë ndikimin e tyre mbi nivelin e pagave (Qirici, Stefan., 2005). Paga e fuqisë punëtore është derivat i ekuilibrit të tregut të punës, ndonëse ekzistojnë faktorë ndikues nëpërmjet ofertës dhe kërkesës së punës, ku firmat kanë tendencë të rritjes së pagave, me qëllim të ruajtjes së fuqisë punëtore, sidomos të specialistëve, ngase firmat u kanë ofruar përvojë disavjeçare dhe trajnime të ndryshme. Mirëpo, nga ana tjetër, firmat kanë tendencë që t'i ulin pagat e punëtorëve, me qëllim të uljes së kostove apo faktorëve të tjerë. Përballë është oferta e punës, ku individët, duke parë se kanë investuar shumë në nivele të ndryshme të arsimimit, kërkojnë vende pune me paga më të larta, me kushte më të mira dhe kontrata afatgjate. Ndërkaq, ulja e pagave, në çfarëdo shtate për individët, nuk është e mirëseardhur.

Në vendin tonë niveli i pagave është i lartë, sidomos në sektorin publik. Por, në tregun e punës fuqia punëtore është e pakënaqur, sepse paga është i vetmi element shpresëdhënës për ekzistencë, kurse të gjithë faktorët tjerë për një zhvillim ekonomik mbasin të ulët, të pandryshuar. P.sh., shpesh ndodh që në televizion shohim fotografi të njerëzve me sëmundje të ndryshme dhe me numër xhirollogarie për të shkuar jashtë vendit për shërim. Në njëfarë mënyre kemi para për produkte të importuara dhe jo kualitativë, por pagat janë të kufizuara për shërbime cilësore. Pra, krijohet një shtatë ku ai që e ka pagën më të lartë ka para më shumë dhe si rrjedhojë i ka dyert e hapura çdo kund.

Dhe, kur paga bëhet faktor i sjelljes së individit, atëherë forcat institucionale (në Kosovë grupet e interesit) i zhvillojnë politikat e tyre dominuese-rivale ndaj qytetarëve.

Ndryshimi i pagave varet prej disa faktorëve, siç janë: arsimimi, përvoja, përgjegjësia, rrezikshmëria etj.

Të dhënat flasin se punëtorët të cilët kanë arsimim të lartë, kanë paga më të larta, ngase punojnë në nivele më të larta institucionale. Ndërkaq, individët të cilët kanë arsimim më të ulët, i kanë pagat e ulëta. Kjo lidhet me faktin se të arsimuarit përshtaten më lehtë në punë, shumë shpejt i marrin përgjegjësitë, janë më të suksesshëm në vendosje, janë bashkëpunëtorë, zhvillojnë aktivitete me gabime sa më minimale. Individët që kanë përgjegjësi më të madhe, kanë paga më të larta përkundër punëtorëve të cilët kanë përgjegjësi më të vogël, ngase vendimet e mara nga niveli më i lartë i përgjegjësisë janë më gjithëpërfshirëse.

Po ashtu, të dhënat që vijnë nga analizat e punës tregojnë se individët të cilët kanë përvojë më të madhe japin produktivitet më të lartë, prandaj edhe niveli i pagave për ta është më i madh. Nuk është njëjtë të jetë përgjegjës individi vetëm për punët e veta apo të jetë përgjegjës edhe për punët e të tjerëve.

Rrezikshmëria në punë ka trajtim të veçantë, si në ndërtimtari, në miniera, në mbrojtje dhe sigurinë e vendit, apo orët e natës në krahasim me ato të ditës etj. Prandaj, si të tilla paguhen me një pagë më të lartë.

1.3.1 Teoria Neokejnsiane

Një teori alternative e ngjashme me modelin e ekuilibrit është teoria e kontraktimit, që është e lidhur me makroekonomiksin neokejnsian. Teoria e kontraktimit fillon, gjithashtu, nga tregu i punës dhe modeli neoklasik, por kjo teori pohon se paga fiksohet nga kontrata në fillim të një periudhe, ndërsa çmimet e të mirave mund të ndryshohen brenda një periudhe. Pohimi është se ndërmarrja dhe punëtorët vendosin pagën në nivelin që ata presin të vendoset ekuilibri në tregun e punës. Teoria neokejnsiane i ngre efektet e përkohshme të një ndryshimi në ofertën monetare mbi idenë se kontrata parapërcakton pagat. Si rrjedhojë, kur pagat rriten në mënyrë të paparashikuar, kurse kontratat e pagave janë të bllokuara, mund të ndodhë një ekspansion real, të paktën për pak.

Kosova, si pjesë e sistemit ish-socialist jugosllav, pas përfundimit të luftës kishte trashëguar një ekonomi kryesisht socialiste, ku pjesa dërmuese e kapaciteteve ekonomike ishte në pronësi shoqërore.

Pas përfundimit të luftës në Kosovë filluan reformat ekonomike dhe shoqërore, ku edhe filloi transformimi i ekonomisë së vendit: nga një ekonomi socialiste në ekonomi të bazuar në ekonominë e tregut të lirë.

Reformat të cilat u ndoqën në Kosovë, kryesisht, ishin të konceptit neoliberal, ku u privatizuan pjesa dërmuese e kapaciteteve industriale me një ritëm të shpejtë dhe të pamenduar, ku këto politika, në mase të madhe, e deindustrializuan ekonominë edhe ashtu të prapambetur në këtë aspekt.

Shteti i Kosovës ndoqi një politikë liberale në marrëdhëniet ekonomike me jashtë pa kurrfarë masa mbrojtëse për prodhuesit vendorë dhe pa asnjë mbështetje për zhvillimin e tyre. Duke pasur parasysh nivelin tejet të ulët të zhvillimit të prodhuesve vendorë, ekonomia vendore nuk ishte në gjendje të konkurrojë me biznesin e huaj dhe kjo çoi te një deficit tejet të madh tregtar dhe rrjedhimisht pamundësinë për akumulimin e kapitalit me pasoja tepër të mëdha për zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Pra, politikat ekonomike të Kosovës ishin neoliberales, që, në fakt, nuk treguan suksese në zhvillimin e Kosovës, ku shteti hoqi dorë nga ekonomia. Politikat neokejnsianiste nuk ishin të pranishme në politikëbërjen e Kosovës.

Sot çdo ekonomi, pak a shumë, është e hapur dhe kjo varet nga shkalla e saj e zhvillimit ekonomik, madhësia e atij vendi dhe tradita. Ekonomitë e vogla, patjetër, duhet të jenë të hapura. Kur analizohet gjendja e ekonomisë së hapur, duhet marrë komponentët e eksportit (E) dhe importit (I). Pra, duke i marrë në konsideratë këto dy variabla, kemi edhe funksionin e të ardhurës si më poshtë:

$$Y = C + I + G + E - Im$$

Mirëpo, kur është fjala për Kosovën, mund të themi se raporti ndërmjet importit dhe eksportit është i disfavorshëm dhe shumë dis-harmonik dhe i pafavorshëm, aq sa nuk duket asnjë dritë e bardhë se ky raport do të ndryshojë për një kohë përderisa ndiqen politika të njëjta ekonomike, siç janë ndjekur që gjashtëmbëdhjetë vjet me radhë. Andaj, përvojat e këtyre gjashtëmbëdhjetë viteve të modelit të të bërit ekonomi dhe të qeverisjes në Kosovë nuk kanë dhënë asnjë sinjal të harmonizimit dhe zhvillimit të kapaciteteve zhvillimore, shkaku i ndjekjes së politikave joadekuata dhe pa plan, e të bëra në mënyrën ad hoc. Prandaj, asnjë qeveri e deritanishme në Kosovë nuk ka arritur as për së afërmi t'i realizojë objektivat e parashtruara për arsye edhe të mandateve të kufizuara kohore, por edhe të mundësive të limituara të përkushtimit, profesionalizmit, e ndonjëherë edhe guximit dhe gatishmërisë për t'u përballur me problemet.

Andaj, pason edhe pyetja: A janë ndjekur politikat ekonomike të përshtatshme në Kosovën e pasluftës?

Dhe, duke pasur parasysh historikun e zhvillimit ekonomik të Kosovës nga periudha komuniste e më pas, jemi të vetëdijshëm edhe për nivelin e zhvillimit ekonomik dhe periudhën e tranzicionit të stërzgatur dhe të mundimshëm që po kalon sot ekonomia e Kosovës. Mirëpo, a ka pasur mundësi që kjo gjendje aktuale e zhvillimit ekonomik të jetë më ndryshe, pa dyshim, po. Ajo që na bën të mendojmë lidhur me aplikimin e politikave ekonomike është guximi, vullneti dhe gatishmëria për t'u përballur me problemin, gjë që ka munguar nga politikëbërësit dhe njohësit e ekonomisë.

Që në fillim të periudhës së pasluftës së vitit 1999, qeverisjen dhe administrimin e mori UNMIK-u. Stafi i tij, i vendosur në Kosovë, ka ardhur nga anë të ndryshme të botës dhe si i tillë shumë pak është preokupuar me gjendjen ekonomike dhe marrjen seriozisht me problemet ekonomike zhvillimore. Dhe, si i tillë, ky staf apo kjo administratë nuk tregoi ndonjë interesim në këtë drejtim dhe themeloi një agjenci të ashtuquajtur të mirëbesimit, e cila kurrë nuk diti çfarë të bëjë me pronat publike, sepse, lëre që nuk mundi t'i menaxhojë dhe t'i ruajë, të paktën, vlerën e atyre që ishin, por edhe i humbi e asgjësoi një pjesë të tyre, duke u bërë vatër e korrupsionit dhe keq menaxhimit. Prandaj, këtu edhe mendoj se është ajo pika nga e cila gjërat e kanë marrë të keqen dhe sot jemi këtu ku jemi... Pra, kur flitet për aplikimin e politikave ekonomike të mirëfillta, së pari, duhet të kemi ekspertë të vullnetshëm, të guximshëm dhe të përgjegjshëm. Sepse, guximi dhe gatishmëria bëjnë që të mos hiqet dorë nga përgjegjësia e marrë.

Andaj, kur flitet për aplikimin e politikës ekonomike neokejnsiane, duhet guxim dhe të mos lihet ekonomia e vendit në dorë të fatit, e sidomos kur kemi një shoqëri të dalë pas një periudhe okupuese dhe socialiste.

Sot thuajse çdo ditë bëhen anketa dhe sondazhe me qytetarë për probleme të adresuara nga ana e ekspertëve, nga të cilat dalin shumë shqetësime dhe për të cilat duhet të shërbejnë si një sinjal i qartë për klasën politike që synojnë qeverisjen e vendit në mënyrë serioze, e jo që të shfrytëzohen për promovime gjatë fushatave dhe të lihen në harresë pas ardhjes në qeveri.

Problemet e adresuara nga ana e qytetarëve dhe ekspertëve kërkojnë një menaxhim të mirë dhe vënie si prioritet për qeverinë, e cila duhet të fillojë të hartojë dhe menaxhojë, së pari, me resurset njerëzore e materiale në dispozicion, duke i harmonizuar me buxhetin shtetëror, në

mënyrë që t'i jepej një kah i dëshiruar zhvillimit shoqëror dhe ekonomik në bazë të prioriteteve të qëndrueshme zhvillimore.

Tranzicioni në Kosovë ka zgjat më shumë se në vendet tjera dhe kjo po reflektohet ndjeshëm në jetën e përditshme të qytetarëve. Politika joadekuate dhe e tej zgjatur e privatizimit, e cila nuk ka qenë në funksion të zhvillimit të shpejtuar ekonomik, ka treguar efekte negative në jetën e përditshme ekonomike të qytetarëve të Kosovës. Kosova ka mungesë të theksuar të aktivitetit ekonomik, sepse shumica e kapaciteteve ekonomike, e që dikur ishte aktive, tash ndodhet jashtë funksionit, në kërkim të titullarëve dhe investuesve të rinj.

Me një ekonomi të paqëndrueshme, Kosova ballafaqohet me një bilanc tregtar të pavolitshëm me botën. Shumëçka blen në botën e jashtme e pak shet. E njëjta ndodh edhe me bilancin e pagesave, i cili shënon një deficit mbi 1.7 miliardë euro. Deficiti kaq i lartë i pagesave i ekonomisë kosovare, ka bërë që Kosova të stagnojë në zhvillimin ekonomik, sepse ajo kishte mungesë të parasë për investime zhvillimore. Kur shikojmë strukturën e importit, vërejmë se shteti i Kosovës shumicën e atyre prodhimeve do të mund t'i prodhonte vetë, po të kishte pasur një politikë ekonomike më largpamëse dhe më aktive.

Papunësia më e larta në rajon është një nga sfidat më të mëdha të ekonomisë kosovare, për zgjidhjen e të cilës ekonomia kosovare nuk ka ndonjë vizion, as mundësi zgjidhjeje afatmesme. Duke iu referuar trendeve të deritashme të punësimit dhe kontigjentëve të të rinjve të aftë për punë çdo vit, ky problem do ta përcjellë shoqërinë kosovare edhe në dekadën e ardhshme. Papunësia e lartë ka ndikuar që të shtohet presioni mbi fondet sociale, që paraqet barrë për zhvillimin ekonomik të Kosovës në shumë aspekte. Kjo shkallë e lartë e papunësisë ka pasur ndikim negativ mbi rritjen e konsumit. Konsumi i ulët ka ndikuar që edhe prodhimi vendor të jetë i ulët, që në një të ardhme të afërt pamundëson zgjerimin e kapaciteteve ekonomike, pos nëse atë prodhim do të mund ta plasonte në tregun e jashtëm. Kjo dhe shumë faktorë të tjerë determinues, kanë ndikuar që Kosova edhe më tutje të mbetet pas vendeve të rajonit për shumë parametra. Me këtë rast, do u referoheshim prodhimin për kokë banori si dhe GDP që në Kosovë janë më të ulëtat në rajon.

Përparësitë komporative që disponon shteti i Kosovës, në mungesë të politikave të mirëfillta ekonomike dhe të investimeve të mjaftueshme, nuk ka arritur t'i materializojë me trende të

larta zhvillimi. Kosova ka mungesë të kapitalit financiar për investime të reja për ngjalljen e aktivitetit ekonomik. Kjo mungesë parash për investime rrjedh nga deficiti i lartë i pagesave të ekonomisë kosovare, sepse Kosova është e detyruar të eksportojë para për të blerë mallra në tregun ndërkombëtar. Në Kosovë veprojnë shumë banka të jashtme, por ato nuk disponojnë me kapital të madh. Në Kosovë aplikojnë politika kreditore jo të favorshme për ekonominë. Kjo politikë e pafavorshme kreditore mund të shihet në kamatat e larta që përfitojnë ato nga kreditë e tyre dhënë biznesit kosovar, krahasuar me kamatat që aplikojnë në vendet nga ato vijnë. Kjo është logjikë e ekonomisë së tregut, që ka përqafuar Kosova, logjikë e ofertës e kërkesës për mjete monetare, si kudo në botë. Shumica e bankave në Kosovë janë me kapital themelues të jashtëm, por ato operojnë me depozitat e shumta të qytetarëve të Kosovës, duke paguar kamata të ulëta për depozita dhe duke inkasuar të hyra të majme nga kamatat në kredidhënie. Por, deri më tani ka munguar intervenimi i Bankës Qendrore për të zbritur normën e lartë të kamatës për bankat komerciale, në mënyrë që ato të kenë leverdi t'i kreditojnë bizneset kosovare me norma më të arsyeshme dhe më të përballueshme për bizneset.

Paradoks i veçantë i tregut financiar kosovar është edhe fakti se rreth një miliard të shtetit të Kosovës janë të deponuara në tregun ndërkombëtar të kapitalit, për kthimin e të cilit në Kosovë deri më tani nuk ka pasur ndonjë vullnet politik. Investimi i këtij kapitali domethënës në tregun bankar të Kosovës me kamata të ulëta, do të kishte efekte multidisiplinare në zhvillimin ekonomik të Kosovës, mundësi kjo që nuk u shfrytëzua nga asnjë qeveri deri më tash.

Mungesa e kapitalit financiar të mjaftueshëm, qoftë nga burimet e vendit e qoftë nga burimet e jashtme për investime në ekonomi dhe krijimin e vendeve të reja të punës, imponon nevojën e hartimit të strategjisë së zhvillimit ekonomik, e cila strategji do të mbështetej në prioritetet zhvillimore të qëndrueshme.

Në mungesë të kapitalit financiar, shteti i Kosovës orientimin strategjik duhet ta ketë në zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla e të mesme, ku krijimi i një vendi pune ka kosto më të ulët. Në këtë drejtim përparësi do të duhej dhënë zhvillimit të përparuar të bujqësisë e blegtorisë dhe përpunimit industrial të prodhimeve bujqësore e blegtorale. Me këtë shteti i Kosovës do të mund t'i realizonte disa caqe strategjike. Njëkohësisht, do të mund të zvogëlonte shkallën e papunësisë së kontigjentit të aftë për punë; do të mund të rriste bazën e taksapaguesve dhe të të hyrave të veta; do të mund të bënte zëvendësimin e importeve me prodhime vendore dhe

mbetjen e qindra miliona eurove në tregun vendor, që do të mund të shërbenin për projekte të tjerë zhvillimor; si dhe do të mund të rriste eksportin në tregun rajonal e ndërkombëtar, e që me këtë do bëhej edhe zbutja e debalancit tregtar të pagesave.

Qeveria duhet të shikojë dhe të mësojë edhe nga përvojat e të tjerëve. Të mos harrojmë se në sajë të zhvillimit të bujqësisë intensive, disa shtete të Evropës Perëndimore, si, bie fjala, Holanda, kanë arritur kulmin e zhvillimit dhe të mirëqenies. Ajo që duhet të dijë qeveria është se nuk ka ekonomi pa prodhim dhe nuk ka prodhim nëse shteti me politika ekonomike aktive nuk e stimulon biznesin, për të shtuar aktivitetin ekonomik. Dhe, nuk mund të ketë prodhim pa ngjalljen e kapaciteteve ekonomike që tash e 10 vjet mrizojnë dhe çdo ditë asetet humbin vlerën, sepse gjithnjë e më shumë amortizohen e bëhen jofunksionale dhe jo atraktive për çdo blerës apo investitorë të mundshëm.

Kosova mbetet edhe më tutje vend me përparësi e mundësi të shumta, por ende pa strategji të zhvillimit ekonomik. Ajo që duhet t'i frikohet shteti i Kosovës është teza e shpikur nga ana e maniakëve të ekonomisë se gjërat do të bëhen mirë vetvetiu, sepse bazohen në parimet e ekonomisë së tregut dhe të globalizimit. Kjo tezë është pohim jo i qëndrueshëm në shtetet e përgjegjshme, sepse praktika ekonomike e shumicës së shteteve bazohet në partneritetin e shtetit me biznesin, ku shteti ndihmon me politikat ekonomike e fiskale bizneset në arritjen e objektivave zhvillimore të tyre. Me këtë ndihmë shteti përfiton në mënyrë të shumëfishtë qoftë në mënyrë direkte apo indirekte.

Gjithmonë ekzistojnë segmente të caktuara ku shteti duhet të ndërvejojë me politika ekonomike e fiskale për të ndihmuar biznesin, e që deri më tani nuk janë aplikuar sa duhet nga ana e shtetit të Kosovës. Përvoja e Kosovës, si edhe e shumë vendeve të tjera në botë, dëshmoi se liberalizmi i tepruar në ekonomi i parapriu gjithherë anarkisë. Madje, edhe shtetet më të zhvilluara në botë kanë elemente proteksioniste në politikat e tyre ekonomike.

Politikat ekonomike e fiskale shtetërore kanë të bëjnë me stimulimin e zhvillimit ekonomik dhe mbrojtjen e prodhimit vendor. Këto politika janë: politikat kreditore ndaj biznesit, politikat fiskale, politikat e privatizimit të kapaciteteve ekonomike, politikat e stimulimit të investimit të kapitalit të jashtëm me krijimin e mjedisit të shëndoshë për investime, politikat e subvencionit të prodhimit vendor, politikat e kufizimeve të importeve për produktet bujqësore sezonale,

politikat e mbrojtjes së prodhimit vendor nga çmimet damping dhe nga konkurrenca jo e ndershme e huaj, politikat e luftimit të informalitetit në ekonomi, politikat e luftimit të korrupsionit etj. Këto janë sfera ku shteti mund të intervenojë dhe duhet të intervenojë, për t'i ndihmuar bizneset dhe zhvillimin e vet ekonomik. Një ekonomi e zhvilluar do të thotë më pak papunësi, më pak fonde sociale nga ana e shtetit për kategoritë e rrezikuara shoqërore dhe më shumë buxhet shtetëror nga taksat, e që do të përfitonte shteti nga biznesi i zhvilluar. Kosova është, ndoshta, i vetmi vend në botë që nuk ka strategji të zhvillimit ekonomik. Kosovës i nevojitet strategjia e zhvillimit ekonomik. Kosova në hartimin e strategjisë duhet t'i shikojë modelet e shteteve të tjera të zhvilluara, por ajo duhet ta ketë modelin e vet të zhvillimit ekonomik, që do të duhej të bazohej në përparësitë komparative që ajo disponon. Kosova ka shumë përparësi komparative ekonomike në krahasim me shtetet e rajonit. Ajo ka nëntokën e saj të pasur me lëndë të parë dhe minerale, që ia kanë lakmi shumë shtete. Ajo, për momentin, ka kapacitete ekonomike jashtë funksionit, që me investime të pakta do të mund të funksionalizoheshin, ka popullsinë relativisht të re e të shkolluar, ka tokën e saj të pëlleshme, ka infrastrukturë të rrugëve dhe të telekomunikacionit relativisht të zhvilluar, ka klimën e saj që favorizon prodhimin bujqësor e blegtoral, përparësi këto që shumë shtete nuk i kanë.

Përparësi komparative zhvillimore e ekonomisë kosovare është edhe fakti se prodhimet kosovare janë të favorizuara nga Bashkimi Evropian dhe SHBA-ja, të cilat në shenjë solidariteti me shtetin e Kosovës kanë abroguar të gjitha barrierat tregtare për prodhimet kosovare. Janë këto përparësi që do të duhej marrë parasysh dhe valorizuar në hartimin e çdo strategjie të zhvillimit ekonomik. Por, ajo që do të duhej të merrej parasysh nga qeveria gjatë hartimit të çfarëdo strategjie, pa dyshim, është mungesa e prodhimit vendor. Së këndejmi, opinioni ynë është se pa funksionalizimin e ekonomisë kosovare, pa hartimin e politikave aktive për rritjen e prodhimit me ngjalljen e aktiviteteve të prodhimit dhe në hapjen e aktiviteteve të reja prodhuese, është i pamundur një zhvillim i shpejtuar. Pra, për të kompensuar ngecjen shumëvjeçare në zhvillimin ekonomik, shtetit të Kosovës i nevojitet hartimi i një strategjie të zhvillimit ekonomik, e cila do të garantonte norma të larta vjetore të zhvillimit ekonomik. Ajo strategji duhet të jetë e hartuar nga Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës dhe ekspertët e ekonomisë.

Hartimi i strategjisë duhet t'i identifikojë prioritetet zhvillimore nacionale, burimet e financimit, resorët ku parashikohet të bëhen investimet, koha kur do të investohet, shuma e atyre investimeve, si dhe rezultatet e pritshme direkte dhe indirekte. Rezultatet e implementimit të strategjisë duhet të jenë të prekshme për shtresat e gjëra të popullsisë, në një të ardhme jo të largët. Nëse implementimi i strategjisë kërkon mjete ekstra, që nuk mund t'i përballojë ekonomia e Kosovës, atëherë duhet orientuar në investitorët e jashtëm dhe në tregun ndërkombëtar të kapitalit financiar, ku shteti mund të ketë qasje, sepse ai tashmë është shtet i njohur ndërkombëtarisht. Shtetin e Kosovës e njohën shumica e shteteve të botës, e që disponojnë me këtë kapital. Hyrja borxh në tregun e kapitalit, për të arritur objektivat zhvillimore strategjike, është praktikë e njohur e shteteve demokratike, që shpesh ka dhënë rezultate inkurajuese në shumë shtete, që sot janë të zhvilluara. Zhvillimi ekonomik pa strategji afatmesme dhe afatgjatë i ngjan lundrimin të marinarit pa busollë, i cili lundron në oqean duke qenë i ndikuar nga dallgët. E, dallgët ndodh, nganjëherë, e qojnë në vendin ku edhe është nisur. Andaj, theksojmë me këtë rast thënien e një ekonomisti të njohur amerikan, i cili thotë: “Ai i cili nuk e di se kah është duke shkuar, nuk do të arrijë kurrë në vendin që do të dëshironte”.

Në fund, mund të themi se marrja e përgjegjësisë nga ana e shtetit, sa i përket politikave zhvillimore, do të jetë një mundësi e mirë drejt një rritje ekonomike të qëndrueshme, e cila do mundësonte edhe uljen e papunësisë, dukuri kjo që e ka ngulfatur shoqërinë kosovare.

1.4. RISHIKIMI I LITERATURËS

1.4.1 Rëndësia e arsimit për të papunët

Papunësia mund të ketë një ndikim shkatërrues, si në një familje ashtu dhe në ekonominë e përgjithshme. Humbja e të ardhurave ka një efekt të menjëhershëm në uljen e shpenzimeve të konsumatorëve. Megjithatë, rritja e pasigurisë për familje mund të ketë një efekt shumëzues në uljen e shpenzimeve të konsumatorëve. Një familje që vazhdon të ketë papunësi ka gjasa për t'i shkurtuar ndjeshëm shpenzimet shkaku i pasigurisë dhe rifillimi i shpenzimeve mund të bëhet pas kthimit të të ardhurave. Ndikimi psikologjik i papunësisë në një familje mund të ketë një ndikim të rëndësishëm në ekonominë më të gjerë. (Zimmer, T., 2000)

Për këtë arsye, ekonomistët kanë kërkuar prej kohësh informacion më të mirë mbi ndikimet dinamike të tregut të ripunësimit. Është në interesin e shoqërisë që të papunët të “lundrojnë” shpejt në tregun e ripunësimit, ashtu që të sjellin rezultatin më të mirë të mundshëm të pagave. (Zimmer, T., 2000)

Tregu i punës e mban anën pozitive të pagave në favor të aftësive dhe rritjes së kapitalit human. Është një numër i madh i literaturës që tregon lidhjen ndërmjet pagave dhe viteve të shkollimit të rishikuar. (Card, 1999)

Gjithashtu, është argumentuar nga dinamika perspektive se pabarazia në paga duhet të ulet me rritjen e niveleve të shkollimit (Tilak, 1989). Në terma të shkurtër, pagat më të larta kërkojnë më shumë aftësi. Meqë më shumë njerëz synojnë pozitë më të lartë edhe niveli i shkollimit rritet, e me këtë edhe oferta e punëtorëve më të aftë rritet. Rritja e ofertës së punëtorëve më të aftë, po ashtu, mund t'i ulë edhe pagat. Në të njëjtën kohë, sa më pak njerëz që i ndjekin punët që kërkojnë më pak aftësi, atëherë paga rritet. Nga kjo perspektivë, edukimi do të shkaktojë takim ndërmjet këtyre niveleve të pagave. Ky konkludim ka dalë pas shikimit empirik të të dhënave që nga 1970, ndërmjet punëtorëve me kravata të bardha dhe të kaltra. (Goldin & Margo, 1992)

Teulings (1995, 2005) tentoi që të ngushtojë urën lidhëse ndërmjet trendeve dinamike afatshkurta dhe afatgjata, duke shpjeguar se njerëzit më të shkolluar janë më të aftë në punët

më komplekse dhe në këtë mënyrë kërkojnë paga më të larta. Në terma afatgjatë, rritja e ofertës së njerëzve më të shkolluar vendos presion në paga të punëve më komplekse ose i shtyn njerëzit më të shkolluar drejt pagave më të ulëta që kërkojnë më pak aftësi.

Studiues të tjerë nuk pajtohen me nocionin afatgjatë të lidhjes së pagave dhe uljes së pabarazisë së pagave. Acemoglu (2002) argumenton se pakësimi i të ardhurave në shkollim më shumë nuk ekziston. Rritja e nivelit të edukimit të kapitali human do të rrisë edhe nivelet e investimeve në teknologji, e që, në këtë mënyrë, do të promovohet edhe zhvillimi-inovacioni. Inovacioni është eksternalitet që derivon nga edukimi, e që edhe e ulë potencialin e uljes së pagave, edhe pse rritet niveli i edukimit. Ky argument mbështet në kërkimet që kanë përdor të dhënat pas vitit 1970, e që tregojnë rritje të pabarazisë së pagave në tregun e punës, si pasojë e diferencave në kërkesat për punë me aftësi të ndryshme (Blackburn, 1990; Bound & Johnson, 1992; Karoly, 1992; Katz & Murphy, 1992; Kosters, 1991).

Një tjetër shpjegim i mundshëm nga observimi i rritjes së pabarazisë në të ardhura pas vitit 1997 është puna mikse. Thurow (1987) dhe Revenga (1992) sugjerojnë se krijimi i punëve me paga të larta është në ulje, ndërsa krijimi i punëve me paga të ulëta është në rritje. Ky ndryshim në përzierjen e punëve shtyp pagat e atyre me aftësi më të ulëta dhe mban pabarazinë e atyre me paga më të larta. Ky argument i krijimit të punëve dhe rritjes së pagave nuk është i pranuar unanimisht (Dickens & Lang, 1985, 1987).

1.4.2 Ndikimi i nivelit të arsimit dhe i gjinisë në punë

Marrëdhënia ndërmjet teorisë së kërimit të punës dhe teorisë së kapitalit njerëzor në literaturën e kaluar paraqitet në dy mënyra: (1) duke treguar lidhjen ndërmjet kohëzgjatjes së kërimit të punës dhe arsimit; (2) duke treguar lidhjen ndërmjet arsimit dhe papunësisë. Literatura tregon se largimi nga puna, kërkitimi i punës dhe ndërrimi i punës dallon për femrat, duke u bazuar në modele të ndryshme të sjelljes gjinore. Për shembull, Ketunen (1997) ka ekzaminuar lidhjen ndërmjet gjatësisë së papunësisë dhe edukimit, duke përdor të dhëna finlandeze. Ai përdori vitet e shkollimit, si një variabël shpjeguese për kohëzgjatjen e papunësisë dhe deklaroi se njerëzit me arsim të lartë kanë një vështirësi më të madhe në gjetjen e një pune të re sesa moshatarët e tyre me një nivel më të ulët të arsimit. Ai, gjithashtu, tregoi

se njerëzit që kanë të kryer masterin ose doktoraturën dhe njerëzit me më pak se nëntë vjet arsimim, janë grupi me mundësinë më të ulët për të gjetur një punë të re. (Elcin,T., Sefilib,S. Kursat, A 2000)

Përderisa Ashenfelter dhe Ham (1979) konkluduan se edukimi nuk ka ndikim në papunësinë, Kiefer (1985) dhe Nickell (1979) gjetën një lidhje negative ndërmjet dy variablave. Si rezultat, duke konsideruar nivelin e edukimit si faktor bazë për ngritjen e funksionit, probabiliteti i kërkimit të punës është funksion që, së pari, ngrihet dhe pastaj zbret në pikën kritike. Nickell (1979) studioi ndikimin e shkollës dhe kualifikimet në probabilitetin e të qenit i papunë dhe gjatësisë së të qenit i papunë në Britaninë e Madhe. Ai, gjithashtu, vuri bazat teorike për të pritur një lidhje të fortë ndërmjet nivelit të edukimit dhe mundësisë për të qenë i papunë, por ka edhe studime të tjera më të dobëta që lidhin edukimin me kohëzgjatjen e papunësisë. Nickell gjeti një lidhje të fortë ndërmjet shkollimit dhe incidencës së papunësisë deri në 12 vjet të shkollimit.

Theodossiou dhe Zangelidis (2009) theksojnë se mobiliteti i punës dhe sjellja punë-kërkim ndryshojnë në bazë të gjinisë, pasi ekzaminoi diferencat e gjinive në ndryshimin e punës dhe sjelljen e punës në nivele të ndryshme të edukimit në 6 vende të ndryshme evropiane. Studimi i tyre përdori të ardhurat, shëndetin, edukimin, strehimin, demografinë dhe variablat e punësimit nga “The European Community Household Panel Survey”, që u zhvillua në vitet 1994 deri më 2001. Theodossiou dhe Zangelidis (2009) argumentuan se normat e qarkullimit të femrat ishin relativisht të ulëta dhe arsyet e largimit nga puna janë, kryesisht, çështje e punëve bazë (familjare ose arsye personale). Në anën tjetër, ata gjetën se meshkujt i lëshojnë punët e tyre për arsye të problemeve me punëdhënësin. Hersch dhe Stratton (1997), gjithashtu, gjetën evidencë të njëjtë, duke bërë të qartë se femrat, zakonisht, e lëshojnë punën e tyre shkaku i përgjegjësiave personale, si, bie fjala, kujdesi për fëmijët.

Biagi dhe Lucifora (2005) hetuan efektet edukative dhe demografike të papunësisë në 10 vendet evropiane në vitet 1975 dhe 2002, me anë të një analize të të dhënave. Sipas rezultateve, ndryshimet drastike në arsim dhe karakteristikat demografike janë të varur nga mosha dhe niveli i arsimit.

Abdel-Mowla (2011) ka hetuar ndryshimet në punë-kërkimin dhe sjelljen e grave në Egjipt në vitet 1998 dhe 2006. Ai ka studiuar efektet e ndryshimeve strukturore brenda tregut të punës në vendimet e kërkimit të vendeve të punës së grave, duke marrë në konsideratë faktorë të ndryshëm, si: arsimi, rajoni dhe statusi martesor. Ai konstatoi se arsimi ka një efekt pozitiv.

Becker (2005) përfshin gjendjen aktuale të edukimit gjatë periudhës së ofrimit të punës. Ai ekzaminoi vetëm një rast të thjeshtë, ku kuptoi se një personi që i ofrohet një punë gjatë studimeve është i prirë ta lë shkollën pa e marrë diplomën, shkaku se ai preferon të fillojë me biznes.

Jayaweera (1997) studio lidhjen ndërmjet edukimit dhe punësimit, por gjeti se nuk ka lidhje signifikante ndërmjet dy variablave. I ekzaminoi 23 vende aziatike në dy grupe: Vendet e pazhvilluara dhe vendet me industri në zhvillim. Kështu, investigoi një strukturë që është e ndryshme nga sistemi evropian që jep rezultate të ndryshme.

Bratberg dhe Nielsen (1998) hetuan kohën e kërkimit të punës pas diplomimit. Rezultatet e studimit tregojnë se paga rritet sipas nivelit të edukimit. E, kjo ka efekt negativ në kohën e kërkimit të punës.

Niveli mesatar arsimor i moshës, i fuqisë punëtore 25 vjeç dhe më të vjetër, është rritur gjatë viteve dhe shkalla e papunësisë ka trende rënie gjatë dy dekadave të fundit. Ky vëzhgim është në përputhje me literaturën me lidhjen ndërmjet nivelit arsimor dhe papunësisë. Për shembull, Phelps dhe Zoega (1997, 1998) gjejnë se përmirësimi i arsimit ka një efekt ulje në normën e papunësisë.

Francescon, Orszag, Phelps dhe Zoega (2000), nga ana tjetër, në efektet e përbërjes arsimore të fuqisë punëtore në këmbëngulje të papunësisë, tregojnë se niveli i papunësisë brenda një klasifikimi të caktuar arsimor nuk ndryshon në mënyrë të konsiderueshme, pasi përbërja e arsimit e fuqia punëtore zhvillohet.

Ata krijojnë një model teorik të normës natyrore të papunësisë ndërmjet dy grupe që dallojnë nga arsimi. Duke përdorur këtë model, ata analizojnë ndryshimin në raportet e pagave-zëvendësim (d.m.th., marrëdhëniet ndërmjet pagave ekzistuese dhe pagave që pritet dhe që mund të fitohen me punë alternative), shpenzimet e trajnimit, reagimet e diferencave të pagave

brenda grupeve dhe faktorë të tjerë të rëndësishëm, si dhe për të gjetur se kthimet në arsim janë të rëndësishme në përcaktimin e raportit të zëvendësimit të pagave brenda grupe të ndryshme. Sidoqoftë, ata nuk gjejnë diferenca ndërmjet papunësisë brenda grupeve të edukimit sa i përket diferencave në paga. Diferencat në paga brenda grupeve u atribuohen diferencave të kthimit në nivelet e edukimit dhe gjetjet e tyre mbështesin efektet e diferencave të pagave, siç është bërë e qartë nga Salop (1979) dhe Moen (1999), e që argumentojnë se punëtorët për konkurrencë në punë zgjedhin të ngritin nivelin e edukimit, në mënyrë që të rrisin renditjen e tyre. Kështu, një rritje në nivelin e edukimit mendohet se është e lidhur me gjasat më të mëdha për të ulur papunësinë (Nickell, 1979; Moen, 1999).

Becker (1964) sugjeroi se është optimale për punëtorët që të bëjnë investime në kapitalin human nëpërmjet edukimit. Meqë edukimi në SHBA është i subvencionuar nëpërmjet programeve qeveritare, lotarive dhe bursave, lëvizja e lartë e nivelit të edukimit të fuqisë punëtore është e kuptueshme. Moen (1999) sugjeroi se punëtorët, në fakt, mund ta tejkalojnë nivelin e edukimit nga ajo që konsiderohet optimale.

1.4.3 Investimi në edukimin e të rinjve

Rëndësia e arsimit dhe formimi i kapitalit njerëzor në nxitjen e rritjes ekonomike dhe zhvillimin e vendeve më pak të zhvilluara nuk mund të nënçmohet. Ai ka treguar se arsimi dhe ngritja e aftësive ka efekte pozitive në rritjen ekonomike dhe zhvillim (Dickens, Sawhil & Tebbs, 2006, Schultz, 1961).

Prandaj, investimi në edukimin e fëmijëve është rrugë kryesore për zhvillimin e burimeve njerëzore dhe i akumulimit të kapitalit të nevojshëm për ndërtimin e kapaciteteve afatgjatë produktiv të një vendi. Është e domosdoshme që një vend të sigurojë mjedis të përsosur për qasje të papenguar në njohuritë dhe aftësitë që do të rrisë rritjen e ardhshme ekonomike të fëmijëve. Sipas Schultz (1961), Strauss dhe Thomas (1995), prosperiteti ekonomik dhe funksionimi i një kombi varet nga kapitali fizik dhe njerëzor i kombit.

Korniza teorike ka përforcuar se është teoria e kapitalit njerëzor, e cila mbështetet në supozimin se arsimi është bazë për formimin e kapitalit njerëzor (Psacharopoulos & Woodhall, 1997; Sakamota & Powers, 1995, Schultz, 1971). Sipas Abdullahi (2008), teoria e kapitalit

njerëzor siguron një justifikim bazë për shpenzime të mëdha publike për arsimin, si në shtetet në zhvillim dhe në ato të zhvilluara. Babatude dhe Adafabi (2005), Lucas (1988), Rebelo (1991), Grossman dhe Helpman (1991) dhe Romer (1990), shohin kapitalin njerëzor si një motor alternativ për të stimuluar rritjen ekonomike. Kontribut i madh për çështjen në marrëdhëniet ndërmjet arsimit dhe zhvillimit ekonomik është bërë për herë të parë nga Adam Smith, ndjekur nga Marshall, Schultz, Bowman dhe të tjerët (Tilak, 2002).

Megjithatë, për të rritur kapitalin njerëzor, një vend ka për të investuar më shumë në arsim. Sipas Dahlin (2005), një investim në arsim është shumë më i dobishëm për shoqërinë, si në mikro dhe makro. Arsimi konsiderohet si katalizator kryesor për zhvillimin kombëtar. Stimulimi në rritjen ekonomike, përgjithësisht, supozohet që të shpjegohet, kryesisht, nga rezervat e punës, kapitalit fizik dhe kapitalit njerëzor (në cilësinë e forcës së punës) (Lucas, 1988).

Teknologjia është supozuar të jetë pjesë e ekuacionit të rritjes. Dhe, shkalla e ndryshimit teknologjik është e lidhur me disponueshmërinë e punonjësve me arsim të lartë. Hanushek & Wößmann (2007) dhe Barro (2001), duke përdorur një regresion kryq, kanë gjetur se për çdo vit të shkollimit nxitet rritja ekonomike me 0.58 dhe 0.44 pikë respektivisht. Ndër të tjerash, për të përfunduar në këtë marrëdhënie ndërmjet arsimit dhe rritjes ekonomike, Rebelo (1991) ka prezantuar kapitalin fizik, si një kontribut shtesë në funksion të akumulimit të kapitalit njerëzor. Megjithatë, modeli i zhvillimit të brendshëm nga Romer (1990), supozon se krijimi i ideve të reja është një funksion i drejtpërdrejtë i kapitalit njerëzor, i cili manifestohet në formën e njohurive. Si një investim në kapitalin njerëzor, çon në rritje kapitalin fizik, i cili, nga ana tjetër, çon në rritje të zhvillimit ekonomik.

Studime të tjera kanë mbështetur akumulimin e kapitalit njerëzor, si një burim i rritjes ekonomike (Benhabib dhe Spiegel (1994), Barro dhe Lee (1993) dhe Romer (1990). Haouas dhe Yagoubi (2005) shqyrtuan hapjen dhe kapitalin njerëzor si burime të rritjes ekonomike për Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut (MENA). Ata zbuluan se kapitali njerëzor ndikon në mënyrë të konsiderueshme në rritjen ekonomike, por ajo nuk ka efekt themelor në rritjen ekonomike. Park (2006) ka vërejtur implikimin e rritjes së dispersionit të shpërndarjes së popullsisë në drejtim të niveleve të arritjeve arsimore. Bazuar në një interval 5-vjeçar kohë-seri të të dhënave të grumbulluara, në grup prej 94 vendeve të zhvilluara dhe në zhvillim, ndërmjet

viteve 1960 dhe 1965, studimi zbuloi se indeksi i shpërndarjes, si dhe indeksi mesatar i kapitalit njerëzor ndikon pozitivisht në rritjen ekonomike. Ai konkludon se politika e arsimit që krijon më shumë shpërndarje në kapitalin njerëzor do të promovojë rritjen ekonomike.

Në mënyrë të ngjashme, por në një mënyrë pak më ndryshe, Loening (2002) ka hetuar ndikimin e kapitalit njerëzor në rritjen ekonomike në Guatemalë, nëpërmjet aplikimit të një metodologjie error correction. Ai shqyrtoi dy kanale të ndryshme, me të cilat kapitali njerëzor pritet të ndikojë në rritjen ekonomike. Rezultati nga studimi i tij zbuloi se një forcë punëtore më e mirë e arsimuar duket të ketë një ndikim pozitiv më të rëndësishëm në rritjen ekonomike, si nëpërmjet akumulimit të faktorëve dhe në zhvillimin e rritjes ekonomike si faktor i përgjithshëm.

Veprat e studiuesve Glewee et. al. (2001) dhe Lucas (1988) për arsimin, arritën në përfundimin se arsimi, gjithashtu, kontribuon në rritjen e zhvillimit ekonomik, duke përmirësuar shëndetin, reduktimin e infertilitetit dhe, ndoshta, duke kontribuar në stabilitetin politik. Edhe pse lidhja ndërmjet arsimit dhe zhvillimit ekonomik të punës nuk është plotësisht e qartë, njohuritë dhe të mësuarit e fituar në shkollë, supozohet se i kanë bërë punëtorët më fleksibël, të aftë për të përvetësuar aftësi të reja dhe përshtatjen me mjedise të reja të punës. Rëndësia e arsimit dhe kapitalit njerëzor është sjell në shumë studime të rritjes ekonomike dhe zhvillimit.

Barro (2001) ka zhvilluar një model të kapitalit njerëzor, i cili tregon se edukimi dhe krijimi i kapitalit njerëzor ishin përgjegjës për të dy dallimet në rritjen ekonomike të punës dhe dallimet në nivelet e përgjithshme të teknologjisë në botë. Më shumë se çdo gjë tjetër, ajo është rritja spektakulare në Azinë Lindore që i ka dhënë arsimit dhe kapitalit human popullaritetin e tyre aktual në fushën e rritjes dhe zhvillimit ekonomik (McMahon, 1998). Vendet, si: Hong Kongu, Koreja, Singapori, Tajvani, i kanë arritur normat e papara të rritjes ekonomike, duke bërë investime të mëdha në arsim (Banka Botërore, 2002). Olaniyan & Okemakinde (2008) dhe McMahon (1998) kanë gjetur se përmirësimi në arsim është një variabël shumë e rëndësishme shpjegues për rritjen ekonomike të Azisë Lindore.

Sipas Justi dhe Driel (2006), ka disa mënyra të modelimit se zgjerimi i madh i arsimit përshpejton rritjen ekonomike dhe zhvillimin. Një pikëpamje ndryshe për rolin e arsimit në suksesin ekonomik është se arsimi ka eksternalitete pozitive (Psacharopoulos & Patrinos,

2004). Ideja se arsimit gjeneron eksternalitete të jashtme pozitive nuk është aspak e re. Shumë nga ekonomistët klasikë argumentojnë fuqishëm mbështetjen aktive të arsimit në bazë të eksternaliteteve pozitive që shoqëria do të fitojë nga një forcë dhe popullatë më e edukuar punëtore (Van et al., 2006). Smith (1976) pasqyroi një mendim të tillë progresiv bashkëkohor, kur ai shkroi se duke edukuar popullin, një shoqëri sjell avantazh të konsiderueshëm nga udhëzimet e tyre. Përveç kësaj, njerëzit inteligjentë janë gjithmonë më të mirë se të paditurit.

Një tjetër mënyrë e modelimit për rolin e arsimit në procesin e rritjes dhe zhvillimit është për të parë kapitalin njerëzor, si një kontribut kritik për aktivitetet e inovacionit, hulumtimit dhe zhvillimit (Barro et al., 1995). Nga ky këndvështrim, arsimit është parë si një përpjekje e qëllimshme për të rritur burimet e nevojshme për krijimin e ideve të reja dhe, në këtë mënyrë, çdo rritje në arsimin e drejtpërdrejtë do të përshpejtojë progresin teknologjik. Kjo qasje e modelimit, zakonisht, miraton (1961) supozimet e Rain dhe Fei të tregjeve joperfekte konkurruese të produkteve dhe risitë konkurruese, të cilat lejojnë procesin e gjenerimit të progresit teknologjik. Arsimit është parë si një input në përpjekjet e qëllimshme dhe sipërmarrëse për të krijuar teknologji të reja dhe produkte të reja (Barro, 1991). Përkrahësit e kësaj pikëpamjeje të arsimit nxjerrin në pah lidhjen e ngushtë ndërmjet zhvillimit të produkteve të reja dhe nivelet e arsimit (Barro dhe Lee, 2000). Vendet që janë në ballë të teknologjisë do e kenë popullsinë më të arsimuar (Van et al., 2006).

Gupta dhe Chakraborty (2004) kanë zhvilluar një model endogjen të rritjes prej një ekonomie të dyfishtë, ku akumulimi i kapitalit njerëzor është burimi i rritjes ekonomike. Ata argumentuan se dualiteti ndërmjet individëve ekziston në mekanizmin e akumulimit të kapitalit njerëzor. Individët e pasur jo vetëm që e ndajnë kohën e punës për veten dhe prodhimin e njohurive të veta, por edhe për të trajnuar individë të tjerë të varfër. Në një dimension tjetër, Lucas (1998) ka vlerësuar një model të rritjes ekonomike dhe të akumulimit të kapitalit njerëzor të bazuar në një mostër të vendeve në një fazë tjetër të zhvillimit. Rezultati tregoi se rritja në nivelin fillor dhe të mesëm të arsimit kontribuon në rritjen e zhvillimit ekonomik. Ata parashtrajnë se normat e akumulimit të kapitalit njerëzor janë të prekura nga variablat demografike. Për shembull, ata krijuan se një rritje të jetëgjatësisë në lindje sjell një rritje në arsimin e mesëm dhe të lartë, ndërsa një rënie në normën e varësisë ndikon negativisht në arsimin e mesëm.

Megjithatë, Ayara (2002) në studimin e tij mbi paradoksin e arsimit dhe zhvillimit ekonomik në Nigeri, raporton se arsimi nuk ka pasur ndikimin pozitiv në rritjen ekonomike në Nigeri. Për këtë arsye, ai i propozon tri mundësi që mund të japin rezultate të tilla, e të cilat janë që kapitali edukativ ka shkuar në aktivitete private fitimprurëse, por shoqërisht joproductive; ose ka pasur rritje të ngadaltë të kërkesës për punë të arsimuar; ose sistemi arsimor ka dështuar, të tilla që shkollimi jep pak (ose aspak) aftësi.

1.4.4 Tregu në Greqi, hallka më e dobët

Nga teoria ekonomike mund të nxirret se në shumicën e vendeve të zhvilluara ekziston një marrëdhënie e anasjelltë ndërmjet arsimimit dhe papunësisë. Për shembull, Filer et al. (1996) vëren se: "... stabiliteti i punësimit rritet kur punëtorët bëhen më të arsimuar. Ky fakt reflekton kostot e larta fikse që çojnë në një shkallë shumë më të ulët të hyrjeve në papunësi në mesin e punëtorëve më të kualifikuar" (p. 321). Sipas dëshmive, është fakt se individët me arsim të lartë kanë një nivel të ulët të papunësisë në shumë qarqe të zhvilluara (OECD, 2000, ILO, 1996). Përveç kësaj, një numër i studimeve empirike (Nickel, 1979, Mincer, 1991, Woolbers, 2000), tregojnë se si niveli i rritjes së arsimit ul probabilitetin e papunësinë.

Megjithatë, edhe pse arsimimi i lartë, në përgjithësi, është lidhur me performancë më të mirë në tregun e punës, ka raste kur furnizimi është rritur më shumë sesa kërkesa. Në raste të tilla gjendja e tregut të punës e të diplomuarve është prekur. Në Mbretërinë e Bashkuar, për shembull, papunësia e të diplomuarve është rritur gjatë viteve të fundit (Moreau dhe Leathwood, 2006). Shembull tjetër është Tajvani, ku kohëzgjatja mesatare e papunësisë për të diplomuarit në kolegji ka qenë më e lartë sesa për individët me nivele të ulëta të arsimit (Ghuang, 1999).

"Megjithatë, edhe pse ka literaturë të gjerë që tregojnë dëshmi të arsimit dhe problemeve në tregun e punës së të diplomuarve, disa komentues (Magoúla dhe Psacharopoulos, 1999), sugjerojnë se frika e zgjerimit të arsimit të lartë në Greqi është mjaft e ekzagjeruar, pasi kërkesa për arsimin e lartë është zgjeruar së bashku me ofertën. Megjithatë, teza e Magoúla dhe Psacharopoulos (1997) i referohet nivelit të përgjithshëm të arsimimit se ajo nuk shqyrton variacione nga fusha e studimit.

Qëllimi i këtij studimi është nëse i ashtuquajtimi zgjerimi i arsimit të lartë ka ndodhur në mënyrë racionale dhe pasqyron nevojat e tregut të punës në lidhje me disiplina të veçanta, ose ajo, në fakt, ka krijuar mospërputhje të caktuara në tregun e punës së të diplomuarve.

Kërkesa e madhe për arsimin e lartë në Greqi ka qenë shkak i çmimit të ulët të shkollimit (Lambropoulos dhe Psacharopoulos, 1992). Siç sugjeron Psacharopoulos (2003b), problemi i numrit të lartë të diplomuarve është shkaktuar, kryesisht, nga fakti se kostot e drejtpërdrejta të arsimit janë zero (arsimi i lartë në Greqi është i lirë), në mënyrë që individët t'i zgjedhin studimet e tyre në bazë të statusit të tyre social dhe jo domosdoshmërisht perspektivat e tyre të punësimit. Përveç kësaj, studentët nuk do të përballen me frikën e braktisjes për shkak të performancës së dobët, pasi ata mund të mbetën studentë për aq vite sa dëshirojnë. Kështu, individët mund të zgjedhin për të studiuar drejtësinë a mjekësinë dhe kualifikimet e tilla janë konsideruar të jenë prestigjioze, edhe pse ata mund ta dinë se perspektiva e tyre në të ardhmen për punësim mund të jetë e varfër.

Është sugjeruar se një nga arsyet kryesore për nivelet e larta të papunësisë në mesin e të diplomuarve është lidhja e dobët ndërmjet sistemit të arsimit të lartë dhe tregut të punës. Mungesa e ndjeshmërisë së sistemit arsimor me nevojat e tregut të punës është theksuar nga Komisioni Evropian (KE) pothuajse çdo herë që shqyrton tregun grek të punës. Në një nga raportet e fundit të KE-së sugjerohet se arsimi grek sistematikisht këmbëngul për të mos marrë parasysh nevojat e tregut të punës dhe mban duke prodhuar "njerëz që mbajnë kualifikime që nuk janë relevante për nevojat e tregut të punës, duke kontribuar kështu në nivelin e lartë të papunësisë" (Komisioni Evropian, 2003; shih, gjithashtu, Komisioni Evropian 1996).

KEPE (2003) në përpjekjen për t'i vlerësuar arsyet që përbëjnë nivelet e larta të papunësisë të të diplomuarit, sugjeron se problemi qëndron, kryesisht, në orientimin e sistemit arsimor ndaj sektorit publik. Në thelb, sistemi arsimor përgatit kuadro për t'u punësuar në punë në sektorin publik, siç janë: mësuesit, nëpunësit e bankave publike, administratorët publikë etj. Megjithatë, sektori publik është, në të vërtetë, duke u pakësuar, pasi ai është duke u munduar t'i zvogëlojë nivelet e personelit, e sidomos ato në administratën publike. Si pasojë, furnizimi i të diplomuarve të tillë e ka tejkaluar kërkesën, duke rezultuar me nivel të larta të papunësisë (KEPE, 2003)

1.4.5. Efektet e arsimit në papunësinë në Evropë

Në dekadat e fundit shumica e ekonomive evropiane kanë përjetuar një numër të ndryshimeve demografike, të cilat kanë ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme strukturën e moshës së popullsisë dhe e kanë ndryshuar pozicionin relativ të ri, kundrejt punëtorëve të moshës së rritur në tregun e punës. Gjatë periudhës 1970-2000 raporti i popullsisë së re në popullsi të rritur është rritur në shumicën e vendeve gjatë viteve 1970 dhe 1980 dhe pastaj ra në dekadat në vijim.

Norma mesatare e papunësisë për të rinjtë është rritur ndjeshëm, deri në fund të viteve 1980, pastaj kishte rënie të lehtë në dekadat në vijim, ndërkohë që papunësia e të rriturve ndryshonte vetëm pak. Gjithashtu, normat e papunësisë, sipas niveleve arsimore, tregojnë ndryshim të rëndësishëm: punëtorët më të arsimuar kanë dy deri në tri herë më pak gjasa të jenë të papunë në krahasim me homologët e tyre të arsimuar më pak dhe gjatë ciklit të biznesit normat e tyre relative priren të ndryshojnë.

Pothuajse të gjitha vendet evropiane kanë eksperimentuar edhe një rritje në nivelet arsimore gjatë dekadave të fundit: në këtë skenar vendet me nivele tradicionalisht të ulëta të arsimimit (në fillim të periudhës), janë duke e zënë hapin me numrin e njerëzve të kualifikuar, që paraqet rritje në vlera absolute dhe relative. Këto modele janë të shumë politikave relevante dhe kanë tërhequr interesin e ekonomistëve dhe politikëbërësit stimulues në kërkime të gjera, si dhe një debat i ashpër mbi efektet ekonomike të rritjes së pjesëmarrjes së të rinjve të popullsisë, por edhe marrëdhëniet me rritjen dhe vazhdimësinë e (të rinjve) papunësisë.

Në mënyrë të ngjashme, një tjetër fillësë e letërsisë, është përpjekur për të hetuar efektet e ofertës ("education boom") dhe të goditjeve të kërkesës (aftësi e njëanshme e progresit teknologjik), si në papunësi ashtu dhe në të ardhurat (EU-IRS, 2000; Bertola et al, 2002a; Brunello et al., 2000; Flinn, 1993).

Edhe pse këto modele kanë disa baza të përbashkëta në shumicën e vendeve evropiane, duhet theksuar se dëshmia agregate fsheh anën e heterogjenitetit - si në të gjitha vendet, si dhe në mes të grupeve të ndryshme të individëve brenda secilit vend - na kufizon në mënyrë të konsiderueshme aftësinë tonë për të kuptuar cilët faktorë na hyjnë në punë në skenarin e

mësipërm. Së bashku me ndërrimet demografike dhe ndryshimet në kërkesën (relative) për arsimin, faktorët tjerë relevantë - dy prej natyrës ciklike dhe strukturore - kanë kontribuar edhe për fatin e të rinjve në tregun e punës, për shembull, luhatjet e ciklit të biznesit, ndryshimet në tri normat e pjesëmarrjes sipas gjinisë dhe moshës, ndryshimet në modelet e tranzicionit të shkollimit, ndryshimet teknologjike, si dhe roli i institucioneve të tregut të punës.

Numri i madh i studimeve empirike që kanë hetuar efektet ekonomike në të ardhurat e të rinjve dhe papunësisë, janë shpesh të vështira për t'u krahasuar shkaku i të dhënave dhe dallimeve metodologjike. Madje, kur një shqyrtim i plotë i studimeve konsiderohet i krahasueshëm, ai trajtohet me kujdes, shkaku i heterogjenitetit të lartë nga vendi dhe koha që duhet për ta karakterizuar përvojën e vendeve evropiane (Zimmerman, 1991, Korenman dhe Newmark, 2000, Jimeno dhe Rodriguez-Palenzuela, 2002)

Shumica e hulumtimeve ekzistuese mbi efektet e goditjeve demografike mbi papunësinë, janë fokusuar, kryesisht, në faktorë agregate ose grupe të veçanta (Shimer, 2001; Jimeno et al, 2002.). Në rastin e parë, supozimi i nënkuptuar është se individët që i përkasin grupmoshave të ndryshme (të rinj apo të rritur), janë zëvendësues të përsosur në prodhim dhe e vetmja gjë që ka rëndësi është furnizimi i përgjithshëm i punëtorëve dhe efekti i prodhuar në normën e papunësisë totale. Nga ana tjetër, në rastin e fundit, kur fokusi është në efektet relative në grup dhe normat relative të papunësisë (d.m.th., të rinj-të rritur), disa shtesa janë bërë për faktin se punëtorët e moshave të ndryshme mund të jenë zëvendësues të papërsosur në prodhim dhe normat relative të punësimit do të jenë, në një farë mënyre, proporcionale me tronditjen (relative) demografike dhe me aftësinë e pagave (relative) për t'u rregulluar.

Një problem me qasjen e mësipërme është se ajo plotësisht neglizhon rolin që aftësitë dhe arsimit kanë në prodhim, ose, që është e njëjtë, ajo supozon se punëtorët me aftësi të ndryshme dhe arsimim janë zëvendësues të përsosur në prodhim. Kjo, siç u përmend tashmë, është shumë e çuditshme, duke pasur parasysh faktin se shpjegimet e bazuara në ndryshimet teknologjike kanë marrë parasysh një gamë të gjerë të fakteve ekonomike që kanë ndodhur në vendet e zhvilluara në dekadat e fundit, të tilla, si: rritja e pabarazisë në zhvillimin e normave të papunësisë te personat e kualifikuar-pakualifikuar (Nickell dhe Bell, 1996;. Acemoglu et al, 2001; Acemoglu, 2003).

Në studime të tjera, madhësia në grupe është përcaktuar si proporcion të një grupmoshe në popullsinë e përgjithshme me të njëjtin nivel arsimor. Në këtë rast, megjithatë, supozimi i nënkuptuar është se tregu i punës është i segmentuar me edukimin dhe se zëvendësimi i të gjitha grupeve edukative është shumë i vështirë (Welch 1979). Me fjalë të tjera, në bazë të këtij përkufizimi të madhësisë kohore, ndryshimet në numrin e individëve të rinj me një nivel të caktuar të arsimit duhet të mos kenë asnjë efekt mbi mundësitë e punësimit të personave të rinj dhe të vjetër që kanë një nivel të ndryshëm arsimor. Kjo e bën të vështirë të veçohen efektet e demografike dhe goditjet arsimore në normën e papunësisë. Zgjedhja e nivelit të duhur e grumbullimit është vendimtare.

1.4.6. Mosha, tregu i punës dhe papunësia

Lazear (1976) ndan efektet e plakjes dhe përvojën e punës. Ai konstaton se kapitali njerëzor, i fituar nëpërmjet përvojës së punës, është shumë i rëndësishëm në moshat e reja, por plakja llogaritet për një pjesë të konsiderueshme të rritjes së pagave.

Gjithashtu, Klevmarken dhe Quigley (1976) gjejnë nevojën për dallimin ndërmjet përvojës dhe moshës në analizat e investimit në kapitalin njerëzor dhe gjetjet e tyre janë në përputhje me interpretimin që anëtarët e rinj të së njëjtit grup-përvojë janë më të efektshme në prodhimin e kapitalit njerëzor. Schwab dhe Heneman (1977) kanë gjetur nivele ekuivalente të performancës për punëtorët më të vjetër dhe të rinj që nuk mund të jenë për shkak të përvojës së përgjithshme më të madhe që kanë punonjësit më të vjetër. Ata gjejnë këtë shumë kurajuese, pasi mosha kronologjike ka pak theks në vendimet e punësimit. Përveç kësaj, Ben-Porath (1988) ka studiuar efektet e madhësisë kohore në shkallën e papunësisë së të rinjve. Studimet e tij empirike konfirmojnë se një rritje në madhësinë kohore rrit papunësinë. Disa regresione tregojnë se papunësia e të rinjve është rritur më shumë në terma absolutë dhe më pak në terma relativë sesa shkalla e papunësisë së pleqve.

KAPITULLI II

KARAKTERISTIKAT E TREGUT TË PUNËS

Hyrje

Tregu i punës është një tërësi marrëdhëniesh që lindin ndërmjet punëdhënësve të përfaqësuar nga shteti ose privat dhe punëmarrësve, sipas legjislacionit të punës në fuqi dhe konventave ndërkombëtare. Në një ekonomi, tregu përfaqëson tërësinë e masave që lejojnë ose lehtësojnë shkëmbimin ndërmjet blerësve dhe shitësve, pra të gjithë faktorët e prodhimit lëvrohen në treg. Tregu i punës zë një peshë jashtëzakonisht të madhe. Dhe, ç'përfaqëson tregu i punës? Ashtu si dhe për çdo treg tjetër, normalisht, edhe tregu i punës presupozon ballafaqimin e kërkesës dhe ofertës për punë dhe arritjen e ekuilibrave në treguesit kryesorë të ekonomisë. Derisa hidhet në treg puna është mall. Çdo mall i ka vlerat dhe dobitë e tij. Secili prej tyre mund të përdoret në drejtime të ndryshme. Shpeshherë ky përdorim nuk varet nga vetë vlerat e tij dhe aq më tej nuk përdoret për vlerën dhe cilësinë më të mirë. Shembuj në këtë drejtim mund të jepen shumë, por ne po përqendrohemi te puna e gjallë (duke lënë jashtë punën e materializuar). Puna e gjallë kryhet nga njeriu, i cili mund të ketë aftësi për t'i kryer disa lloj punësh. Natyrisht, siç nënvizon një filozof i Greqisë së lashtë, ai nuk mund t'i kryejë të gjitha punët mirë. Për njërin i ka cilësitë më të mira dhe për të tjerat jo. Zotërues i kësaj, i këtyre aftësive të ndryshme, do të dëshironte të vinte në përdorim (dhe për rrjedhojë të nxirrte në treg dhe të shiste) aftësinë më të mirë. Dhe, kjo është e kuptueshme pasi në këtë rast ai do të jepte efektivitetin më të lartë dhe do të siguronte (në kushte normale) të ardhura më të larta. Mirëpo, jo në të gjitha rastet mund të sigurohet plotësimi i kësaj kërkesë të tij. Madje, në të shumtën e rasteve, ndodh tërësisht e kundërta. Kështu, për shembull, një intelektual me gjithë dëshirën për t'u marrë me punën e tij intelektuale, në mjaft raste (dhe të tillë takohen sot me mijëra, ku truri përdoret, rëndom, duke bërë punë të rëndomta brenda dhe jashtë vendit), privohet nga një e drejtë e tillë dhe ai detyrohet ta braktisë profesionin e tij, duke punuar në një tjetër punë, me të cilën jep më pak efektivitet dhe siguron më pak të ardhura.

2. Tregu i punës dhe faktorët përcaktues të ekuilibrit të tij


Kërkimet mbi tregun e punës dhe faktorët përcaktues të ekuilibrit janë çështje mjaft të rëndësishme në trajtimin e problemeve ekonomiko-sociale. Punësimi përbën një aspekt jetik për dinamikën dhe stabilitetin e parametrave të tjerë ekonomiko-socialë në një vend a popullsi. Në kuptimin e ngushtë ai paraqet një marrëdhënie të qëndrueshme ose të përkohshme ekonomiko-sociale, një situatë ku burimet e punës vihen në shfrytëzim për prodhimin e të mirave dhe shkëmbimin e tyre. Punësimi qëndron në mes dhe i lidhë kategoritë e rëndësishme të fuqisë punëtore, kapitalin, prodhimin, duke funksionuar si një tregues mjaft i rëndësishëm në një shoqëri. (Instituti Riinvest,2003)

Si marrëdhënie ekonomike, punësimi shfaqet dhe realizohet në treg.

2.1. Ekuilibri i tregut të punës

Kërkesa dhe oferta për punë, si dhe arritja e ekuilibrit, e paraqitur nëpërmjet lakores për numrin e të punësuarve, të cilët kanë arritur të sigurojnë një vend pune në raport me kërkesën për punë nga ana e punëdhënësve. Oferta për punë përkufizohet si sasia e orëve të punës që individët janë të gatshëm dhe në gjendje të ofrojnë në tregun e punës përkundrejt pagës së ofruar nga punëdhënësit gjatë një periudhe të caktuar kohore.


Grafiku 1. Ekuilibri i tregut të punës



Burimi: Autori

Në fig. 1. shihet se në Kosovë, sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në vitin 2015 janë të punësuar 296.940 persona, kurse paga mesatare neto për këtë periudhë është 300-400€, pra **ekuilibri** është arritur në pikën **E**, e cila paraqet edhe bashkëveprimin ndërmjet kërkesës dhe ofertës për punë në tregun e punës për këtë periudhë. Mirëpo, në Kosovë, për momentin, gjendja qëndron pak më e komplikuar, sepse kemi një numër të madh të personave të papunë, ku persona aktivë në tregun e punës llogaritet të jenë 733.432, ndër ta 296.940 të punësuar dhe rreth 145.776 të papunë. Këtë gjendje e paraqesim në figurën në vazhdim...

Grafiku 2. Oferta dhe kërkesa për punë



Burimi: Autori

Në këtë figurë lakorja vertikale **S** paraqet numrin e përgjithshëm të personave ekonomikisht aktivë në tregun e punës, e që është 733.432. Siç shihet në figurë, ekuilibri ndërmjet ofertës dhe kërkesës për punë është arritur në pikën **E**, ku kemi 296.940 persona të punësuar me rrogë mesatare neto rreth 300-400 euro, kurse pjesa tjetër, pra prej 145.776 personave, e paraqitur në lakore me shkronjën **P**, paraqet numrin e të papunëve ekonomikisht aktiv. Pra, ata janë persona që janë të papunë, mirëpo në periudhën referuese kanë qenë në kërkim të një vendi pune. Sipas

ASK-së, në vitin 2015, nga popullsia e përgjithshme 1.757.843, pothuajse dy të tretat e këtij numri janë në moshë pune (15-64) vjeç. Nga kjo shifër, rreth 62.4% nuk janë ekonomikisht aktiv, që do të thotë se ata nuk kanë qenë të punësuar dhe nuk kanë qenë aktiv në kërkim të punësimit gjatë katër javëve të kaluara ose nuk janë të gatshëm të fillojnë punën brenda dy javësh. Personat ekonomikisht joaktiv përfshijnë studentët, amviset, punonjësit e dekurajuar dhe personat e tjerë, të cilët nuk ishin aktiv në kërkim të një vendi pune.

Zhdukja apo zvogëlimi i hendekut, pra i diferencës P, të paraqitur në fig. 2, paraqet sfidën më të madhe për momentin të shtetit të Kosovës. Nëse i shtojmë këtij numri edhe pjesën tjetër të popullsisë së Kosovës që është e papunë, por nuk kërkon punë shkaku se mendon se nuk do të gjejë punë, pra është e dekurajuar, vërtet, kemi një gjendje shumë shqetësuese.

Për uljen e kësaj papunësie nevojitet hartimi dhe zbatimi i strategjive në nivel nacional, mirëpo një ndër elementet qenësore të zbutjes së kësaj gjendje është arsimimi cilësor në bazë të nevojave të tregut, në mënyrë që të mundësojë një konkurrencë të fortë të firmave vendore në tregun global, pasi që konkurrenca dhe mbijetesa në tregun global është e vetmja mundësi për zhvillim ekonomik dhe zbutjen e papunësisë në kohën në të cilën jetojmë, e, pa dyshim, edhe tregu i Kosovës i nënshtrohet konkurrencës globale.

Sipas strategjisë kombëtare për zhvillim 2016-2021, një prej arsyeve përse kompanitë nga vendet e zhvilluara i zhvendosin aktivitetet e tyre në shtetet në zhvillim si Kosova, apo kur një kompani kosovare ka përparësi ndaj një kompanie të një vendi të zhvilluar, është fakti se në këto shtete kostoja e prodhimit është më e ulët shkaku i fuqisë punëtore më të lirë. Një biznes do të jetë i favorizuar nëse do i duhet të shpenzojë më pak para për ta nxjerrë një produkt në treg. Por, në mënyrë që ky investim të ketë kuptim, punëtorët në Kosovë duhet të jenë po aq produktiv dhe të shkathtët si ata në vendet e zhvilluara. Një investitor mund të sjellë makinerinë më moderne në Kosovë, por shtrohet pyetja: A do të mund të gjejë ai fuqi punëtore që i ka shkathtësitë dhe kualifikimet e duhura për të punuar me pajisje të tilla dhe për të prodhuar produkte të cilësisë së kërkuar me ato pajisje?

Kapitali njerëzor u referohet shkathtësive të fuqisë punëtore për të përdorur në mënyrë efektive kapitalin fizik, siç janë makinat. Disa punëtorëve u duhet më pak kohë se të tjerëve për ta prodhuar të njëjtën gjë. Disa e bëjnë punën më mirë se të tjerët. Kapitali njerëzor, gjithashtu, ka të bëjë me aftësinë e njerëzve për të qenë inovativ dhe për të zhvilluar teknologji, procese apo prodhime të reja. Këto gjëra përcaktojnë suksesin e një kompanie në një treg ndërkombëtar

konkurrues. Si të tilla, ato e përcaktojnë nëse një shtet do të zhvillohet ose jo. Sa më të përparuara që të jenë shkathtësitë e fuqisë punëtore, aq më të larta do të jenë të ardhurat e punëtorëve dhe të ekonomisë, në përgjithësi. Kur flitet për shkathtësitë, nuk flitet vetëm për shkathtësitë teknike, si, për shembull, prerja dhe formësimi i një produkti, por edhe për shkathtësitë kognitive, si logjika dhe arsyetimi, apo shkathtësitë e buta, si marrëdhënia me kolegët apo etika e punës. Krijimi i këtyre shkathtësive varet, kryesisht, nga cilësia e sistemit të arsimit, ndërlidhja e tij me tregun e punës, kushtet në të cilat njerëzit punojnë në tregun e punës, por edhe mundësitë për fitimin e aftësive nëpërmjet migrimit, apo kthimit të trurit nga diaspora. Angazhimi konkret i ekspertëve dhe studentëve të diasporës do të mundësojë transferimin e aftësive të fituara nga mërgata jonë dhe forcimin e lidhjeve të tyre me atdheun. Do të thotë, një ekspert i teknologjisë mund të mbështetet financiarisht për ta zhvilluar një projekt në institucionet e Kosovës apo në kompani private, i cili mund të prodhojë diçka afatgjatë.

2.2. Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies në arsimin parauniversitar

Suksesi i nxënësve kosovarë në nivelin e arsimit fillor, sipas projekteve të testit të standardizuar PISA, është më i ulëti në rajon. Pamundësia për të fituar njohuri dhe shkathtësi në nivelet më të ulëta të arsimit ndikon shumë në aftësinë e këtyre nxënësve për të treguar sukses në nivelet më të larta.

CILAT JANË SHKAQET?

Studimet tregojnë se cilësia e mësimdhënies është faktori më i rëndësishëm për përmirësimin e rezultateve të nxënësve në shkollë. Në këtë drejtim, Kosova përballlet me sfida të mëdha. Rreth gjysma e mësimdhënësve, të cilët momentalisht janë në shërbim, nuk i plotësojnë kualifikimet minimale dhe as kërkesat normative për të qenë mësimdhënës, sepse nuk i kanë përfunduar studimet e nivelit baçelor. Rritja e pagave nuk është shoqëruar me rritje të cilësinë së mësimdhënies, ndërkohë që vetëm rreth 10% të shkollave e zbatojnë kurrikulën e re. Shumica e shkollave e ndërtojnë punën mbi libra që nuk janë azhurnuar.

2.3 Ndërlidhja më e mirë ndërmjet sistemit arsimor dhe tregut të punës

Mospërputhja e nevojave të tregut të punës me njohuritë e fituara në arsimin e lartë dhe profesional është identifikuar si një prej pengesave kryesore për rritjen e punësimit dhe zhvillimin ekonomik në vend. Rreth 25% e firmave në Kosovë ende ankohen se fuqia punëtore ka shkathtësi të mangëta dhe të papërputhshme me nevojat e tyre. Në anën tjetër, më shumë se 85% e investitorëve e nënvizojnë cilësinë e fuqisë punëtore si faktor kryesor kur marrin vendime për investime.

CILAT JANË SHKAQET?

Në Kosovë nuk ka sistem për parashikimin e shkathtësive të kërkuara në tregun e punës. Procesi i hartimit të standardeve profesionale të kualifikimit është i ngadalshëm, ashtu sikurse edhe zbatimi i Kornizës kurrikulare. Niveli i shpenzimeve publike për arsim dhe aftësim profesional është shumë i ulët, ndërkohë që, të paktën, çereku i shkollave profesionale nuk ofrojnë mundësi të punës praktike në shkollë apo jashtë saj. Ndërmarrjet nuk kanë stimuj për të marrë në punë praktikantë. Shkollat nuk ofrojnë orientim në karrierë e as mundësi për ndërlidhje me ndërmarrjet nëpërmjet hulumtimeve dhe zhvillimeve të produkteve (R&D).

CILAT JANË ZGJIDHJET?

SKZH synon të forcojë ndërlidhjen ndërmjet programeve arsimore dhe nevojave të tregut të punës nëpërmjet përcaktimit të standardeve profesionale dhe fushave prioritare, si dhe të zbatimit të kurrikulave bërthamë dhe trajnimeve për mësimdhënës. Sistemi i arsimit profesional do të bëhet sa më praktik duke përfshirë ndjekje të mësimin në ndërmarrje. Rol qenësor do të luajë edhe krijimi i një sistemi për parashikimin e nevojave për shkathtësi, si dhe ndërlidhja e punës hulumtuese në universitete me industrinë, me anë të specializimeve të ndryshme

- Aktivitetet konkrete të masës:

1) Përshpejtimi i procesit të zhvillimit të standardeve profesionale, në përputhje me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve (KEK) dhe Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), si dhe me Sistemin e rishikuar Kombëtar për Klasifikimin e Profesioneve.

2) Përcaktimi i fushave me prioritet më të lartë në AAP, duke u konsultuar me politikat zhvillimore të Kosovës dhe sektorët prioritarë. Zhvillimi dhe zbatimi i kurrikulave bërthamë në një format modular, sipas fushave prioritare të AAP-së, si dhe realizimi i programit për trajnimin e mësimeve të AAP-së për ata sektorë, bazuar në standardet e profesionit.

3) Zbatimi i sistemit pilot i kombinuar i AAP-së me elemente të mësimin të dyfishtë (kombinimi i të mësuarit në shkollë dhe në ndërmarrje), duke filluar me fushat prioritare në AAP dhe ndjekur kurrikulën bërthamë.

Do të koordinohet sistemi i subvencionimit të pagave me fushat prioritare, në mënyrë që të mundësohet integrimi më i mirë i të diplomuarve të AAP-së në tregun e punës.

4) Zhvillimi dhe zbatimi i Sistemit Kombëtar i parashikimit të nevojave për shkathtësi. Kjo do të bëhet duke e siguruar ndërlidhjen me sistemin e orientimit në karrierë brenda shkollave dhe shërbimet e punësimit/të mësuarit gjatë gjithë jetës. Do të krijohen kushtet për shërbime dhe studime përcjellëse për të gjurmuar përparimin në karrierë.

5) Ndërlidhja e punës hulumtuese në universitete me industrinë nëpërmjet qasjes së specializimeve të mençura në përputhje me strategjinë Evropa 2020. Kjo nënkupton investime publike dhe private për hulumtim dhe zhvillim (R&D) në një numër të caktuar sektorësh industrialë.

2.4. Angazhimi afatshkurtër i ekspertëve dhe studentëve nga diaspora

Gjatë dekadave të fundit, në vende të ndryshme të botës, diaspora kosovare ka fituar njohuri dhe shkathtësi, të cilat do të ishin të dobishme për t'u transferuar në ekonominë e Kosovës. Studimet tregojnë se të kthyerit nga diaspora, të cilët posedojnë shkathtësi, kanë arritur të gjejnë punë në Kosovë shumë më lehtë sesa të kthyerit që nuk posedojnë shkathtësi, gjë që tregon se ata janë një kapital njerëzor shumë i vlefshëm. Sidoqoftë, deri më tani, i ashtuquajti "procesi i kthimit të trurit", është zhvilluar në mënyrë sporadike dhe pa mbështetje institucionale. Krijimi i mekanizmave që do të lehtësonin angazhimin e diasporës do të mundësonte jo vetëm

transferimin e shkathtësive, por edhe potencialisht do të ndihmonte në kthimin e përhershëm të një numri të caktuar të pjesëtarëve të diasporës me shkathtësi.

Shkalla e papunësisë ishte më e larta për personat e pashkolluar (73.9% e këtij grupi ishin të papunë) dhe më e ulëta për personat që kishin përfunduar arsimin terciar (19%). Shkollimi i ka përmirësuar perspektivat në tregun e punës, në veçanti për meshkujt pasi 79.7% e meshkujve të pashkolluar ishin të papunë, në krahasim me 13.7% të atyre që kishin përfunduar arsimin terciar.

2.5. Intervistimi i firmave

Një prej potencialeve që ka Kosova sot dhe ndër më të rëndësishmit është numri i madh i të rinjve, e që një pjesë e madhe është e papunë dhe, ndoshta, e pashpresë për një të ardhme të ndritur. Një numër aq i madh i të papunëve, medoemos, do të thotë fuqi e lirë punëtore, pra punëtorë me paga të ulëta, që do të prodhonin produkte konkurruese në treg me kosto më të ulët në krahasim me vendet perëndimore, ku paga është deri në dhjetëra herë më e lartë. Është interesant fakti pse një fuqi punëtore kaq e re dhe e lirë rri e pashfrytëzuar, rri kot!

Ku është problemi?

Nëse e hulumtojmë këtë çështje dhe nëse përcjellim publikime të ndryshme për këtë çështje, mund të konkludojmë se njëra prej arsyeve kryesore për këtë gjendje është arsimimi jo adekuat, apo jo i ndërlidhur mirë me nevojat e tregut të punës në Kosovë. Dihet se në Kosovë niveli i arsimit nuk është në gjendje të dëshiruar, mirëpo shkaqet për një gjendje të tillë vijnë nga shumë faktorë: një nga ta është se Kosova ende është shtet i ri dhe jo shumë kohë më parë ka dalë nga lufta. Para lufte Kosova bënte pjesë në Jugosllavi, pra në një bashkësi apo shtet me sistem të kontrolluar të tregut nga shteti. Ishte një shtet-federatë komunist, ku, medoemos, ka lënë pasojë në mentalitetin e popullsisë së shtetit tonë. Në krahasim me vendet e rajonit dhe të botes, Universiteti i Prishtinës, si universiteti i parë i shqiptarëve të Kosovës, është themeluar shumë vonë. Pra, është një kohë shumë e shkurtër që kemi universitet në krahasim me vendet e tjera. Mirëpo, pavarësisht këtyre rrethanave, mendojmë se gjendja ka pasur mundësi të jetë shumë më ndryshe, pra shumë më e avancuar.

Cilësia e kuadrove të dala nga universitetet e Kosovës, qoftë ato publike apo private, lë shumë për të dëshiruar, gjendje kjo e deklaruar nga shumica absolute e firmave të intervistuar, të marra si mostër për kërkesat e tyre për punë dhe ofertën aktuale në treg. Punëtorët e rinj, doemos, në

çdo firmë duhet të kalojnë një fazë provuese fillestare, në të cilën fazë llogariten praktikantë, e që paguhet, zakonisht, me paga më të ulëta. Periudha e praktikës ndryshon nga firma në firmë dhe nga profesioni në profesion.

Punëtorët e rinj të diplomuar kanë njohuri të përgjithshme për profesionin e tyre, disa më shumë e disa më pak, por nga konkurrenca e madhe që ekziston në treg, punëdhënësit, në të shumtën e rasteve, kanë mundësi të mëdha të zgjedhjes. Kriteret e zgjedhjes së punëtorëve, zakonisht, përqendrohen, veç njohurive të fituara në universitet, edhe në kurset e ndryshme që kandidatët kanë ndjekur për t'u aftësuar. Në profesionet si, bie fjala, inxhinierë të ndryshëm, shembull, në fabrikat e ngjyrave të cilat operojnë në Kosovë, firmave i nevojitet t'i aftësojnë punëtorët e rinj për një kohë relativisht të gjatë, madje duke filluar nga gjërat elementare praktike. Kjo bëhet shkak i mungesës së praktikës dhe i lidhjes apo bashkëpunimit ndërmjet firmave dhe universiteteve për punë praktike të studentëve.

Profesionet e tjera të ndryshme, si: menaxherët e firmave, bankierë, financierë, në të shumtën e rasteve, vendimin përfundimtar për ta pranuar apo jo një punëtor në punë, firma e merr pas një periudhe provuese, e cila zgjat më shumë se një muaj. Pra, pas një aftësimi praktik të cilin e merr kandidati në atë firmë dhe të asaj se a arrin t'i kënaqë kërkesat e asaj firme.

Për kontabilist çdo firmë kërkon që kandidati të jetë i certifikuar në kontabilitet, sepse, në të kundërtën, vetëm me aftësitë e fituara nga universiteti është pothuajse e pamundur kryerja e një pune të tillë.

Profesionet e tjera, si: kreator apo dizajner, në firmat e përpunimit të drurit, janë profesione të kërkuara në masë të madhe, nga të cilat profesione është duke u varur shumë suksesi i këtyre firmave. Krijimi i dizajneve të reja dhe të pëlqyera e mban firmën në treg dhe i siguron shitjen e produktit, duke i siguruar kështu një sukses të garantuar firmës.

Firmat që merren me shitjen e teknologjisë, e që duhet të merren edhe me servisimin e produkteve që i shesin, kanë kërkesë për punëtorë për servisimin e kësaj teknike, ku ka raste që një serviser paguhet nga firmat deri në 1200 euro në muaj. Dhe, zakonisht, këta serviserë vijnë nga shkollat profesionale apo ka raste kur këtë zanat e kanë marrë duke punuar vetëm punë praktike, pa e ndërlidhur fare me teori. Është interesant fakti se shumë të diplomuar me bachelor dhe master nuk arrijnë ta kryejnë këtë punë, edhe pse janë të diplomuar në fushë të tillë.

Një numër i madh i të punësuarve punojnë si shitës dhe pjesa dërmuese e tyre nuk janë të diplomuar në ndonjë fushë të caktuar. Në vendin tonë mungon një shkollë e tillë për këtë lëmi, e

që do të ishte ndihmesë e madhe për firmat në vendin tonë, kur dihet se shitja është njëri ndër elementët më të rëndësishëm të suksesit të firmave.

Një numër i madh i të punësuarve është në markete të ndryshme, ku menaxherët dhe pronarët e këtyre marketeve deklarojnë se punëtorët e rinj, pas një praktike të shkurtër, arrijnë ta kryejnë punën pa problem, meqenëse një punë e tillë nuk kërkon aftësi shumë speciale.

Në hoteleri shumica e firmave si problem paraqesin profesionin e kuzhinierit kryesor, ku, sipas tyre, ka kërkesë të vazhdueshme për ta dhe paga e tyre arrin dyfishin, madje në shumë raste edhe trefishin e pagës mesatare neto në Kosovë.

Në pyetjen që u kemi bërë firmave prodhuese, pra atyre të cilat merren me prodhimin e produkteve për treg, se cilat kushte u nevojiten për rritjen e biznesit të tyre dhe që të jenë konkurrent në tregun ndërkombëtar, përgjigjja nga firmat përpunuese të drurit, firmat e prodhimit të ngjyrave dhe fasadave të ndryshme, firmat përpunuese të llamarinës, firmat e prodhimit të dyerve dhe dritareve dhe firma të tjera më të vogla në industrinë ushqimore, del se një nga problemet e tyre është rritja e kapaciteteve në aftësinë e fuqisë punëtore për përdorimin e makinerisë së re, e që nevojitet për prodhimin e produkteve në treg. Mirëpo, arsyet e tjera, e që përmenden nga ta janë vështirësitë për t'i plotësuar standardet e kërkuara nga tregu evropian, e që për arritjen e tyre kërkohet investim shumë i madh, qoftë në makineri e edhe në stafin punues. Sipas tyre, për të sjellë makineri të re në Kosovë, medoemos, duhet të sjellim në Kosovë edhe ekspertë për përdorimin e atyre makinerive, e që firma duhet t'u paguajë paga të majme ekspertëve për një kohë relativisht të gjatë, derisa të aftësohet stafi vendor për përdorimin e atyre makinerive. Firmat e lartcekura shumicën e punëtorëve i marrin nga shkollat profesionale. Në fillim të vitit 2015 kanë pasur probleme jashtëzakonisht të mëdha, ku një numër i madh i punëtorëve të tyre kanë shkuar emigrantë në shtetet evropiane, e edhe më larg, kryesisht shkaku i pagave të ulëta në firmat ku ishin, e që paga, kryesisht në ato firma, nuk arrin as 300 euro në muaj.

Vetëm një numër i vogël nga ato firma, prej afër 10%, ka deklaruar se do bashkëpunonin me universitete dhe shkolla profesionale për punë praktike të studentëve. Pjesa tjetër konsideron se një gjë e tillë do të shkaktonte probleme në ato firma.

2.6. Bizneset më të mëdha në Kosovë sipas pasurisë dhe të ardhurave

Tabela 1. Bizneset më të mëdha në Kosovë sipas pasurisë dhe të ardhurave

Emri i kompanisë	Pasuria totale	Të ardhurat bruto	Numri i punëtorëve	Pagesa për paga
1. ELKOS	159.704.805	250.155.000	3200	11.610.000
2. DUKAGJINI	73.250.000	57.150.000	1200	3.430.000
3. DEVOLLI	66.580.000	49.500.000	610	2.600.000
4. SHARR CE	55.275.855	39.960.000	650	3.628.000
5. HIB PETROL	51.403.274	116.500.000	670	2.425.000

Burimi: Autori

Sipas raporteve të Auditorit të Pavarur, këto janë bizneset më të mëdha në Kosovë. Siç shihet edhe nga tabela, ELKOS i prinë kësaj liste si për nga pasuria ashtu edhe për nga të ardhurat, por, gjithashtu, edhe me numrin më të madh të të punësuarve.


Kompanitë nga vendi i dytë e deri te i pesti, kanë dallime të vogla ndërmjet veti. Vërehet se SHARR CEM është njëra ndër kompanitë që tregon kujdesin më të madh për punëtorët, si për paga ashtu edhe në sigurinë në punë dhe trajnimin apo aftësimin e tyre. SHARR CEM organizon programe të veçanta për trajnimin dhe aftësimin e punëtorëve të tyre, si në shëndet e siguri, pastaj kurse të anglishtes: menaxhment, shkathtësi teknike dhe mjedis mesatarisht 40 orë trajnimi për çdo punëtor.

Por, një gjë të tillë nuk mund ta themi edhe për kompanitë e tjera, pasi ato nuk kanë programe të veçanta aftësimi apo trajnim të punëtorëve të tyre. Sistemimin e punëtorëve, kryesisht, e bëjnë duke u dhënë kohë që të krijojnë provojë pune në fushat e caktuara. Sidoqoftë, bizneset e mëdha, duke parë gjendjen në tregun e punës dhe papunësinë e madhe në vend, kanë luksin që t'i marrin punëtorët më të përgatitur, kryesisht prej bizneseve më të vogla, të cilët paraprakisht i kanë trajnuar apo përgatitur nga punëmarrësit në lëmi të ndryshme.

Siç cekëm edhe më lart, në bazë të hulumtimeve del se bizneset e mëdha janë më pak të prira për t'i aftësuar apo trajnuar punëtorët e tyre. Përkatësisht, vetëm 28% e tyre kanë deklaruar se kanë programe trajnime. Për dallim nga bizneset e vogla dhe të mesme, të cilët kanë një përqindje solide, bizneset e vogla - 55%, përkatësisht 45% për bizneset e mesme.

2.7 Raporti ndërmjet zhvillimit ekonomik të rajoneve dhe fuqisë punë

Në një kohë tranzicioni në të cilin po kalon Kosova, e sidomos gjatë një procesi privatizimi, kur



Burimi: Evropa juglindore, Raporti i zhvillimeve Ekonomike

18 dhjetor 2012

asetet shtetërore (fabrikat, tokat) u privatizuan në një kohë shumë të shpejtë dhe pa ndonjë plan konkret mbi ecurinë e punës pas privatizimit, sot është mjaft vështirë të bëhet një matje adekuate e zhvillimit kur shumë prej këtyre aseteve nuk kanë filluar fare me punë apo kanë ndryshuar destinimin e punës. Shembull, nga një fabrikë prodhimi janë shendërruar në markete tregtare apo restorante, të cilat Kosovën e bënë të varur, kryesisht, nga taksat doganore, sepse importi karshi eksportit është

shumëfish më i lartë. Në mungesë të ndonjë plani qeverisës e zhvillimor konkret për t'i zëvendësuar produktet e eksportit me ato vendore, e në disa nuanca duke i dëmtuar ato edhe nëpërmjet politikave fiskale, të cilat nuk e favorizojnë produktin vendor, do të kalojë edhe shumë kohë pa ndonjë stabilitet ekonomik, i cili do të garantonte rritje të prodhimit, e ku me prodhim do të rritej punësimi dhe Kosova nuk do të ishte një vend ku paratë kalojnë vetëm tranzit për vendet e tjera, e që përfituesit më të mëdhenj të kësaj mungese të prodhimi janë shtetet fqinje, si, Serbia dhe Maqedonia. Pra, në mungesë të një raporti mbi rajonin në këto vitet e fundit, duhet të bazohemi në raportin e Bankës Botërore të vitit 2012, e cila merret me zhvillimet ekonomike të Evropës Juglindore dhe analizat e ndryshme, të cilat parashohin ndryshime në vitet në vazhdim. (Raporti Final,2012)

RRITJA EKONOMIKE NË EJL6—NJË RECESION I DYFISHTË

Pas një rritje mesatare vjetore prej vetëm 2 për qind në vitin 2010 e 2011, por edhe duke reflektuar zhvillimet e Eurozonës, vendet e EJT-se hynë përsëri në recesion në gjysmën e parë të vitit 2012. Aktiviteti ekonomik rajonal, i udhëhequr nga Serbia, e cila përbën pothuajse gjysmën e PBB të EJT6, u dobësua pjesërisht shkaku i dimrit të ashpër, por edhe shkaku i zvogëlimit të ndjeshëm të kërkesës së jashtme dhe të brendshme (tabela 2).

Tabela 2 . Evropa Juglindore Gjashtë: Rritja reale ekonomike, 2009-2012

	2009	2010	2011	2012 Gj1	2012 Gj2 (proj)	2012 (proj)
ALB	3.3	3.5	3.0	1.0	0.6	0.8
BIH	-2.9	0.7	1.3	-0.2	0.2	0.0
KOS	2.9	3.9	5.0	3.6	3.6	3.6
MKD	-0.9	2.9	2.8	-1.1	1.0	0.0
MZI	-5.7	2.5	2.5	-0.9	1.0	0.2
SRB	-3.5	1.0	1.6	-1.6	-2.3	-2.0
EJT6	-1.8	1.8	2.2	-0.6	-0.5	-0.6
BE10	...	2.0	3.1	1.3	..	0.9

Burimi: Zyrtar kombëtare të statistikave të vendeve të EJT6 dhe stafi i Bankës Botërore. Mesataret janë të ponderuara me PBB.

Pavarësisht recesionit të rajonit, rritja ekonomike në vendet individuale të EJT6 kishte ndryshime të mëdha. Serbia dhe IRJ e Maqedonisë kishin rënien më të madhe ekonomike me rreth 1.6 dhe 1 për qind, respektivisht në gjysmën e parë të vitit 2012. Kosova përbën një përjashtim, prodhimi i së cilës vazhdon të nxitët nga investimet e larta publike në autostrada dhe ekonomia e Shqipërisë u rrit me 1 për qind, e mbështetur në kërkesën e brendshme. Këto zhvillime u diktuan nga ulja e eksporteve dhe investimeve; papunësia e lartë nuk lejoi rritjen e konsumit. Me gjithë rimëkëmbjen graduale të pritur në gjysmën e dytë të vitit, EJT6, si grup, do të mbetet në recesion për vitin 2012. Papunësia – niveli më i lartë i papunësisë rajonale në Evropë, mesatarisht me rreth 25 për qind (duke përjashtuar Kosovën, papunësia e së cilës kalon 40 për qind, pjesërisht e zbutur prej punësimit informal) – do të vazhdojë të rritet. (Zyra e statistikave e EJT, 2009-2012).

Rimëkëmbja është ngadalësuar nga performanca e dobët industriale. Në gjithë rajonin prodhimi industrial ka qenë në rënie të vazhdueshme në tre tremujorë rresht, nga T4 2011 deri në T2 2012. Rënia ishte më e madhe në gjysmën e parë 2012, kur shumë fabrika duhet të mbylleshin për disa javë shkaku i dimrit jashtëzakonisht të ftohtë; thatësirës në dimër dhe mungesës së fuqisë hidrike

si rezultat i saj; si dhe rënia në kërkesën për eksportet industriale. Si rezultat, rritja mesatare e ponderuar e prodhimit industrial në tremujorin e parë ishte -10.1 për qind. Rënia më e ndjeshme ishte në Shqipëri (-20.3 për qind), e ndjekur nga Mali i Zi (-14.7 për qind), (tabela 3).

Tabela 3. ETL6: Rritja reale e prodhimit industrial sipas tremujorëve (në % vit më vit)


Vendi ²	2011				2012	
	T1	T2	T3	T4	T1	T2
Shqipëria	11.1	-5.4	5.6	-9.7	-20.3	6.4
Bosnja dhe Hercegovina	11.1	6.2	6.0	2.9	-9.4	-4.1
Kosova	13.8	5.3	1.4	-4.7	-8.5	-5.6
Maqedonia, FYR	-10.2	-21.0	3.6	-11.6	-14.7	1.9
Serbia	5.7	3.8	-1.8	0.4	-6.4	-3.1
<i>Mesataret</i>						
E thjeshtë	6.3	-2.2	3.0	-4.6	-11.8	-0.9
E ponderuar me PBB	7.8	1.6	1.8	-2.1	-10.1	-1.7

Burimi: Zyrat kombëtare të statistikave dhe përlogaritjet e stafit të Bankës Botërore

Përveç problemeve të industrisë, të korrat jashtëzakonisht të këqija në gjithë Ballkanin, kufizuan prodhimin bujqësor, duke kontribuar në recesionin e përgjithshëm, si dhe në presionet mbiçmimet e ushqimeve vendase (tabela 3).

Prodhimi bujqësor në gjithë rajonin pësoi gjatë gjithë vitit nga moti ekstrem. Së pari, temperaturat e dimrit arritën në nivel të ultë rekord, shoqëruar me thatësi. Pastaj, në verë rajoni, si edhe shumë pjesë të tjera të botës, u përball me thatësi të rëndë. Si rezultat, prodhimi

Figura 4: ETL6: Inflacioni-IÇK dhe Ushqimet (Përqindje)



Burimi: Zyrat kombëtare të statistikave të ETL6

bujqësor u zvogëlua shumë. Rezultatet për tremujorin e tretë mund të jenë, veçanërisht, të këqija për vendet që kanë përqendruar aktivitetet e tyre bujqësore në prodhimin e drithërave dhe të frutave. Serbia dhe deri diku Bosnja e Hercegovina u goditën më rëndë. Në gjysmën e parë të vitit Serbia pat rënie të vlerës së shtuar bujqësore me 18 për qind. Si rezultat, inflacioni i ushqimeve dhe i IÇK në SEE6 ndërpreu prirjen rënëse që kishte filluar në mars 2012 (figura 4).

2.7.1 Tregjet e punës


Në kushtet e recesionit të dyfishtë, papunësia në EUL6 vazhdon të rritet. Tre vjet pasi që kriza globale goditi rajonin, tregjet e punës, në shumicën e ekonomive të saj, vazhdojnë ende të përkeqësohen.

Papunësia në Serbi dhe Bosnjë e Hercegovinë në vitin 2012 është shumë më e lartë se në vitin 2008 (figura 5). Niveli i papunësisë në Serbi u rrit me 11 pikë përqindjeje-një humbje e pashembullt e vendeve të punës (kutia 2) - ndërsa në Bosnjë e Hercegovinë niveli u rrit me gati 5 pikë përqindje.

Nga të gjitha vendet në zhvillim të Evropës dhe Azisë Qendrore, vetëm tre shtetet baltike kanë shënuar një rritje të nivelit të papunësisë deri në 11-12 pikë përqindjeje gjatë krizës globale, por në vitin 2011 të tre vendet arritën të ulin nivelet e papunësisë me 2.5-4.5 pikë përqindjeje. Për më tepër, humbja e vendeve të punës në vendet baltike erdhi si rezultat i recesionit të fortë ekonomik dhe rënies dyshifrore në prodhim. Në të kundërtën, tkurrja e prodhimit në Serbi dhe Bosnjë e Hercegovinë ka qenë shumë më e butë, por përkeqësimi i tregut të punës ka qenë shumë më i zgjatur.

Niveli i papunësisë në Mal të Zi është edhe më i lartë se në periudhën para krizës, edhe pse ndikimi ka qenë më pak i zymtë. Shqipëria, ndoshta, bën pjesë në të njëjtin grup, me kthimin e disa emigrantëve nga Greqia që shtojnë papunësinë, por të dhëna nga anketat e fuqisë punëtore nuk disponohen. Maqedonia dhe Kosova kanë pasur performancë më të mirë, pasi rritja e këtyre ekonomive në vitet e fundit ka qenë e moderuar.


Figura 5. Ndryshimet në nivelet e papunësisë në EJT6, 2008 dhe 2012 në (%)



Burimi: Anketimet e fuqisë punëtore (AFP) të zyrave kombëtare të statistikave

*Të dhënat më të fundit e AFP e vitit 2011 nuk janë të disponueshme për Kosovën dhe Shqipërinë.

Figura 6. Nivelet e papunësisë, EJT6 dhe BE10




Burimi: Anketimet e Fuqisë Punëtore (LFS) të Zyrave Kombëtare të Statistikave

Shënim: Të dhënat për Kosovën për vitin 2010 nuk janë të disponueshme; të dhënat për Shqipërinë nga burime administrative. BE10 përfshin Bullgarinë, Republikën Çeke, Estoninë, Hungarinë, Letoninë, Poloninë, Rumaninë, Republikën Sllovake, dhe Slloveninë. BE11 përfshin gjithashtu Kroacinë.

Papunësia e lartë mbetet ende një sfidë e madhe ekonomike dhe sociale për rajonin (figura 6). Kosova me nivel të papunësisë 45 për qind, Maqedonia 32 për qind, Bosnja e Hercegovina dhe Serbia me rreth 28 për qind, bëjnë përjashtim jo vetëm për Evropën në tërësi, por edhe në rang global. Sipas treguesve të zhvillimit botëror të Bankës Botërore, vetëm pak vende në botë kanë nivel papunësie më të lartë se 25 për qind. Siç është përmendur në botimet e mëparshme të këtij raporti, papunësia e moshave të reja dhe ajo afatgjatë janë probleme, veçanërisht, shqetësuese për rajonin. Një rënie e tej zgjatur ekonomike do të rriste problemin tashmë kronik të papunësisë afatgjatë.


Të dhënat nga burimet administrative mbi numrin e regjistruar të të papunëve mbështesin analizën e mësipërme dhe lejojnë monitorimin e prirjeve për vitin 2012 në të gjitha vendet EJT6 (figura 7). Të dhënat nga burimet administrative për personat e regjistruar si të papunë (zakonisht zyrat e punësimit), janë më pak të besueshme se të dhënat AFP dhe nuk janë të krahasueshme brenda rajonit. Megjithatë, këto të dhëna tregojnë një divergjencë në performancë të ngjashme me ato të AFP. Numri i të papunëve të regjistruar në vitin 2012 në Bosnjë e Hercegovinë dhe Shqipëri është më i lartë se në vitin 2011. Megjithatë, numri i të papunëve të regjistruar në Maqedoni, Mal të Zi dhe Kosovë ka pësuar ulje në vitin 2012, megjithëse një pjesë e ndryshimit mund të shpjegohet pjesërisht prej ndryshimeve në rregulloren e punës në Maqedoni dhe Kosovë.

Figura 7. Numri i të papunëve të regjistruar gjatë vitit 2011(Janar 2011=100



Burimi: Zyrtat Kombëtare të Statistikave

Figura 8. Nivelet e punësimit në EJM6(2011-2012) në (%)



Burimi: Anketimet e Fuqisë Punëtore të Zyrave Kombëtare të Statistikave

Në përgjithësi, norma e pjesëmarrjes në tregun e punës në vendet EJM6 ka qenë më e ulët se në vendet e BE-së, duke filluar nga 44 për qind në Bosnjë dhe Hercegovinë në 56 për qind në Maqedoni⁴. Norma e pjesëmarrjes mbeti relativisht e pandryshuar ndërmjet viteve 2011 dhe 2012. Ndryshimi më i madh u vu re në Mali të Zi: një rritje prej 0.5 pikë përqindjeje, e pasqyruar nga rritja e nivelit të punësimit. Nga ana tjetër, Serbia ka pasur rritje të pjesëmarrjes në tregun e punës gjatë tre viteve të fundit. Kjo tërheqje e fuqisë punëtore tregon për një "papunësi të fshehur" përtej shifrave zyrtare. Të dhënat e punësimit të AFP, të disponueshme për vitin 2012, japin një panoramë të përzier në rastin më të mirë (figura 8). Në nivel rajonal nivelet e punësimit janë më të larta në Mali të Zi dhe më të ulëta në Bosnjë dhe Hercegovinë. Punësimi vazhdon të rrëshqasë në Serbi dhe në Bosnjë e Hercegovinë. Serbia ka humbur rreth 680.000 vende pune që nga viti 2008, që përbën 30 për qind të punësimit të përgjithshëm në vitin 2012. Këto humbje duket se janë të përqendruara në sektorët e bujqësisë, financës dhe ndërtimit, të cilët janë goditur veçanërisht rëndë nga faktorë ciklikë dhe strukturorë. Nga ana tjetër, pas humbjes së vendeve të punës gjatë tremujorit të parë të vitit 2012, Mali i Zi ka pasur rikuperimin më të madh në punësim gjatë tremujorit të dytë, megjithëse kjo vjen pjesërisht nga përgatitja për sezonin turistik dhe të dhënat vjetore tregojnë luhajtje të vazhdueshme.

Sfida e krijimit të vendeve të punës kërkon që qeveritë të shkojnë përtej reformave të institucioneve të tregut të punës dhe politikave aktive të tregut të punës. Siç trajtohet edhe në raportin e Bankës Botërore "Vendet e punës në Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore" dhe "Raporti i Zhvillimeve Botërore 2013 për vendet e punës", tregu i dobët i punës dhe nivelet e ulëta të përfshirjes sociale janë rrjedhojë e faktorëve të shumtë, të ndërlidhur si struktura e

kërkesës për fuqi punëtore, mospërputhja e aftësive, pengesat në lëvizshmërinë e fuqisë punëtore, efektiviteti i kufizuar i mekanizmave ndërmjetësues të tregut të punës, fokusimi i dobët i arsimit të lartë.

Kriza ekonomike, me të cilën po përballen shumica e vendeve, vazhdon t'i rëndojë problemet strukturore që ekzistojnë më parë, me rënien e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore dhe me rritjen e papunësisë dhe varfërisë. Për më tepër, me plakjen e popullsisë, në shumicën e vendeve të rajonit, numri i pensionistëve në krahasim me popullsinë në moshë pune po rritet me shpejtësi, duke shtuar presionin mbi tregjet e punës dhe ndaj gjithë modelit shoqëror. Në mungesë të politikave imediate, situata ka gjasa të përkeqësohet. Zgjidhja e këtyre problemeve mund të çojë në rritjen e standardeve të jetesës, produktivitetit dhe kohezionit social, me ndërmarrjen e një sërë masash për nxitjen e rritjes ekonomike, konkurrencës dhe krijimin e vendeve të punës. Ato mund ta forcojnë dhe kohezionin social në rastet kur mundësitë ekonomike u jepen të gjitha grupeve socio-ekonomike dhe demografike.

2.8.1 Ligji mbi pagat

Ligji Nr. 03/L-147, i hyrë në fuqi në qershor të vitit 2010, posedon 30 nene. Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i sistemit dhe i strukturës së pagave, shtesave dhe kompensimeve të tjera për nëpunësit civilë, sipas përkufizimit të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Po i marrim shembuj disa nga nenet:

Neni 3

1. E drejta e nëpunësve civilë për pagë të drejtë dhe të rregullt është e garantuar në bazë të kushteve të përcaktuara me këtë ligj dhe me Ligjin e Shërbimit Civil.
2. Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë.
3. E drejta për marrjen e pagës së rregullt mund të pezullohet vetëm në përputhje me kushtet e përcaktuara në Ligjin e Shërbimit Civil.
4. Nëpunësit civilë kanë të drejtë në pagën e garantuar, në përputhje me dispozitat e përgjithshme të punës. (Ligji Nr. 03/L-147, 2011)

Neni 5. Paga bazë

1. Paga bazë, sipas këtij ligji, është rezultat i çmimit të punës, përkatësisht vlerës për punën e thjeshtë dhe koeficientet e caktuar për çdo grup e nëngrup, si dhe shumat e rritura të përvojës së punës, për çdo vit të plotë, në përqindje të caktuar.

2. Paga bazë, sipas këtij ligji, është rezultat i angazhimit dhe përkushtimit të nëpunësit civil në pozitën e tij të punës, në raport me tërësinë e pozitave të tjera të punës, të përcaktuar me akt nënligjor nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Neni 6. Klasifikimi i pozitave të gradave të pagës në shërbimin civil

1. Me qëllim të përcaktimit të pagës bazë, pozitat në shërbimin civil ndahen në katër kategori funksionale dhe klasifikohen në njërën nga katërmbëdhjetë (14) gradat e pagës. Raporti ndërmjet pagës minimale dhe maksimale të nëpunësve civilë, sipas këtij ligji, është në proporcion një (1) me pesë (5).

2. Katër kategoritë funksionale janë:

2.1. nëpunës civilë të nivelit të lartë drejtues;

2.2. nëpunës civilë të nivelit drejtues;

2.3. nëpunës civilë të nivelit profesional;

2.4. nëpunës civilë të nivelit tekniko-administrativ.

3. Nëpunës civilë të nivelit të lartë drejtues konsiderohen këto pozicione:

3.1. drejtues i lartë tre (3) - grada e pagës një (1);

3.2. drejtues i lartë dy (2) - grada e pagës dy (2);

3.3. drejtues i lartë një (1) - grada e pagës tre (3).

4. Nëpunës civilë të nivelit drejtues konsiderohen këto pozicione:

4.1. drejtues katër (4) - grada e pagës katër (4);

4.2. drejtues tre (3) - grada e pagës pesë (5);

4.3. drejtues dy (2) - grada e pagës gjashtë (6);

4.4. drejtues një (1) - grada e pagës shtatë (7).

5. Nëpunës civilë të nivelit ekzekutues dhe profesional konsiderohen këto pozicione:

- 5.1. ekzekutues dhe profesional tre (3) - grada e pagës tetë (8);
- 5.2. ekzekutues dhe profesional dy (2) - grada e pagës nëntë (9);
- 5.3. ekzekutues dhe profesional një (1) - grada e pagës dhjetë (10);

6. Nëpunës civilë të nivelit administrativ konsiderohen këto pozicione:

- 6.1. administrativ katër (4) - grada e pagës njëmbëdhjetë (11);
- 6.2. administrativ tre (3) - grada e pagës dymbëdhjetë (12);
- 6.3. administrativ dy (2) - grada e pagës trembëdhjetë (13);
- 6.4. administrativ një (1) - grada e pagës katërmëdhjetë (14).

7. Gradat e pagës një (1), dy (2), tre (3) dhe katërmëdhjetë (14) kanë nga pesë (5) hapa të pagës, ndërsa gradat e pagës nga katër (4) deri në trembëdhjetë (13) kanë nga dymbëdhjetë (12) hapa të pagës.

8. Klasifikimi i gradës së pagës bëhet varësisht nga:

- 8.1. përgjegjësia;
- 8.2. ndërlikueshmëria;
- 8.3. aftësitë komunikuese ndërpersonale;
- 8.4. kualifikimet disponuese;
- 8.5. kushtet në punë.

9. Për klasifikimin e pozitës në gradën përkatëse, përshkrimi i detyrave për atë pozitë krahasohet me një përkufizim të gradave, të cilat përcaktojnë, për secilën gradë, shkallën e përgjegjësisë, kompleksitetin, aftësitë ndërpersonale, si dhe kualifikimet dhe përvojën e nevojshme për atë gradë.

10. Klasifikimi i përgjithshëm i pozicioneve të punës në Shërbimin Civil, standardet dhe procedurat për klasifikimin e secilës pozitë në gradën përkatëse, në bazë të përshkrimit të punës, si dhe përcaktimi i hapave të pagës, përcaktohen nga Qeveria me akte nënligjore, pas propozimit të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financa.

KREU IV: KOMPENSIMI I PAGËS DHE PAGESAT E TJERA

Neni 20. Kompensimi i pagës

1. Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin kompensim të pagës në këto raste:
 - 1.1. kompensim për punë jashtë orarit të rregullt gjatë ditëve të punës;
 - 1.2. kompensim për punë jashtë orarit gjatë fundjavës;
 - 1.3. kompensim për punë jashtë orarit gjatë festave zyrtare;
 - 1.4. kompensim për pushim vjetor;
 - 1.5. kompensim për kohën e paaftësisë së vërtetuar të përkohshme për shkak të sëmundjes;
 - 1.6. kompensim gjatë shtatzënisë dhe lehonisë;
 - 1.7. kompensim në rast të shfrytëzimit të pushimit të veçantë me pagesë;
 - 1.8. kompensim në rast të perfeksionimit profesional të specializuar për nevojat e organit ose të shtetit.
2. Nëpunësit civilë kanë të drejtë në kompensimin e shpenzimeve të kryera gjatë ushtrimit të detyrës, si vijon:
 - 2.1. shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit gjatë një udhëtimi apo vizite zyrtare brenda ose jashtë Kosovës;
 - 2.2. shpenzimet e shkaktuara me rastin e shfrytëzimit të automjetit personal për punë zyrtare;
 - 2.3. shpenzimet e shkaktuara gjatë punës në terren;
 - 2.4. shpenzimet e shkaktuara me rastin e zhvendosjes së përkohshme ose të përhershme në një vend tjetër pune.
3. Kushtet dhe metoda për llogaritjen e kompensimeve të shpenzimeve për rastet e caktuara përcaktohen me akt nënligjor, të nxjerrë nga Qeveria, pas propozimit të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financa.

Neni 21. Kompensimi për punën jashtë orarit

1. Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin kompensim me pagesë për punën jashtë orarit ose kohë të lirë kur institucioni punëdhënës kërkon nga ta që të punojnë jashtë orarit, në rrethanat e përcaktuara me Ligjin e Shërbimit Civil.

2. Nëpunësit civilë, për punë jashtë orarit, kanë të drejtë të marrin kompensim me pagesë ose kohë të lirë nëse:

2.1. mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ka autorizuar paraprakisht me shkrim numrin e orëve të punës jashtë orarit;

2.2. mëditje për udhëtim jashtë vendit;

2.3. pas plotësimit të këtyre orëve, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i vërteton me shkrim orët faktike të plotësuara.

3. Pagesa për punën jashtë orarit llogaritet për çdo orë të plotë pune, duke i shtuar edhe vlerën si vijon:

3.1. 30% shtesë të pagës bazë për orë të plotë për punën jashtë orarit të rregullt gjatë ditëve të punës;

3.2. 50% shtesë të pagës bazë për orë të plotë për punën gjatë fundjavës.

3.3. 100% shtesë të pagës bazë për orë të plotë për punën jashtë orarit gjatë festave zyrtare.

4. Koha e lirë për çdo orë pune jashtë orarit llogaritet sipas kriterëve të përcaktuara me paragrafin 3 të këtij neni.

5. Kompensimi për punë jashtë orarit bëhet me pagesë.

6. Nëpunësi civil për punën jashtë orarit, në vend të kompensimit me pagesë, ka të drejtë të kërkojë kompensim me kohë të lirë.

Një ndër problemet kryesore të ligjit në fjalë është mungesa e trajtimit të mirë të punëmarrësve në sektorin privat, ku nevoja për mbrojtjen e kësaj shkalle të të punësuarve është e domosdoshme.

Në vitin 2012 ligjit në fjalë iu shtuan edhe dy akte nën-ligjore me ndryshimet, të cilat janë të përcaktuara me:

Rregullorja nr. 33/2012 për shtesat në pagë dhe kompensime të tjera të nëpunësve civilë, si dhe Rregullorja nr. 05/2012 për klasifikimin e vendeve të punës në shërbimin civil.

Paga minimale në Kosovë, sipas ligjeve në fuqi, është 170€. Ndër problemet kryesore që përballen të punësuarit në Kosovë janë politikat fiskale dhe mbrojtja e tyre në mënyrë të drejtë.

Buxheti i Kosovës mbushet nga taksat e klasës së mesme dhe të varfër dhe është e domosdoshme të ndryshohen politikat fiskale. Tatimi në të ardhurat personale për momentin janë:

- të hyrat nga 0€ deri në 80€=0% tatim

- të hyrat nga 170€ deri në 250= 4% tatim
- të hyrat nga 250€ deri në 450€=8% tatim
- të hyrat mbi 450€=10% tatim.

Pra, edhe në bazë të këtij ilustrimi shihet se kemi nevojë për ndryshime, ku duhet të ruhet më shumë klasa e varfër dhe e mesme, sepse efekti 4 apo 8% për pagat deri në 170€, respektivisht 450€, është më i madh karshi një page 1000€, e cila ka tatim 10%.

Në rast se të hyrat deri 250€ euro do të liroheshin nga tatimet, e kjo pjesë në buxhetin e shtetit do të rimburshej duke e rritur tatimin në të hyrat mbi 450€ nga 10% në 20%, do të rritet buxheti, që të mbrohet klasa mesatare dhe e varfër, e cila është dominante për nga përqindja në Kosovë. Në të njëjtën kohë do të rritej mesatarja e mirëqenies për kokë banori.

2.8.2 Sindikatat

Para se të fillojmë me analizat mbi gjendjen dhe veprimtarinë e sindikatave në Kosovë, parashtrohet pyetja: Ç'është sindikata?

Sindikata është një grup i vetorganizuar individësh, kompanish, korporatash apo entitetesh të tjera, që kanë qëllim ndjekjen e një interesi të përbashkët. Më shpesh interesi është rritja e fitimeve të anëtarëve që bëjnë pjesë në sindikatë.

Në Kosovë organizata kryesore sindikaliste është BSPK-ja (Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës).

2.8.2.1 Historiku i BSPK-së

Sindikatat e Pavarura të Kosovës, më vonë Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (shkurt BSPK), si asociacion jopartiak, u themelua në periudhën e vlimeve të mëdha politike, në kohën kur bëhej fjalë për rrënimin e autonomisë së Kosovës dhe kërcënimet serioze të qenies shqiptare në trevat etnike brenda kufijve të shtetit jugosllav. Në atë periudhë kohore zhvillimet politike ishin të atilla sa që të drejtat e punëtorëve ishin vetëm një segment i të drejtave që po i humbiste populli shqiptar i Kosovës, prandaj, në radhë të parë, nevojë imediate e kohës ishte mbrojtja e qenies kombëtare. Konform këtyre zhvillimeve, misioni i këtij subjekti sindikal ishte mbrojtja e identitetit kombëtar në kuadër të së cilës do të bëhej mbrojtja e së drejtës për punë.

Pra, mbështetur në këto që thamë, mund të thuhet se BSPK-ja asokohe kishte ngjyime politike, për çfarë e dokumenton edhe motoja e përhershme e kësaj sindikate me sloganin: "Pa liri kombëtare nuk ka as liri sindikale". Edhe pse tubimi i parë i veprimtarisë sindikale u mbajt në objektin e Institutit Albanologjik të Prishtinës, ku edhe u zgjodh Këshilli Nismëtar, BSPK-ja, si subjekt sindikal, u formësua në Kongresin e Parë, i cili u mbajt në Pallatin e Kulturës në Gjakovë, duke filluar me punime më 30.6.1990 deri më 1.7.1990, me pjesëmarrjen e rreth 600 delegatëve. Në atë kongres sindikal, Hajrullah Gorani u zgjodh kryetar. Pra, kryetari i parë i sindikatave të Kosovës.

Sipas vendimeve të Kongresit, po ashtu, me aklamacion u zgjodh trupi punues me emërtimin "Këshilli koordinues", që, në fakt, e përbënin anëtarë nga lista e Këshillit nismëtar dhe për detyrë kishin themelimin e degëve sindikale. Ky këshill luajti rolin e Kryesisë së BSPK-së deri në Kuvendin e Parë zgjedhor. BSPK-ja, si asociacion sindikal, me aktivitetet e veta do t'u prijë të gjitha zhvillimeve politike që ndodhën në atë periudhë, siç ishte: shpallja e Deklaratës Kushtetuese më 2 korrik 1990, greva e përgjithshme e punëtorëve më 3 shtator 1990, miratimi i Kushtetutës së Republikës së Kosovës në Kaçanik nga delegatët e Kuvendit të Kosovës më 7 shtator 1990.

Pos kësaj, BSPK-ja do të ketë një rol të rëndësishëm edhe në zhvillimet e tjera politike. Veprimtarët sindikalë dhanë kontribut të çmuar edhe në luftën për çlirimin e Kosovës, duke u inkuadruar në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, e që ndër të parët u radhit Hamzë Jashari, i cili më herët ishte edhe anëtar i Kryesisë së Sindikatës së Pavarur të Metalistëve të Kosovës.

BSPK-ja edhe pas çlirimit do të luajë një rol të fuqishëm, veçanërisht në rindërtimin dhe zhvillimin e të gjitha segmenteve për formësimin e shtetit të Kosovës.

2.8.2.2 Legjislacioni për organizimin sindikal

Në Kosovë puna e organizimit sindikal është e rregulluar edhe me ligj, pra në bazë të ligjit Nr. 04/ L-011. Brenda këtij ligji janë 33 nene, të cilat e rregullojnë punën e themelit, formimit apo bërjes së organizimit të organizatave sindikale. Për të pasur më shumë informacione lidhur me këtë ligj, marrim shembuj disa nene:

Neni 3. E drejta për bashkim

1. Të punësuarit kanë të drejtë, sipas vullnetit të tyre, të themelojnë organizata sindikale dhe të anëtarësohen dhe bashkohen në to sipas këtij ligji, statutit sindikal dhe standardeve ndërkombëtare sindikale dhe konventave ndërkombëtare të ONP-së;
2. Të punësuarit kanë të drejtë, sipas vullnetit të tyre, të formojnë organizata sindikale dhe të bashkohen në federata dhe konfederata, sipas kushteve dhe parimeve të përcaktuara në aktet e organizatës sindikale;
3. Organizatat sindikale, sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, mund të themelohen pa kurrfarë pëlqimi nga autoritetet qeveritare dhe punëdhënësit.

Neni 4. E drejta për anëtarësim në organizatë sindikale

1. I punësuari vendos lirisht për anëtarësim në organizatë sindikale;
2. Askush nuk duhet të jetë i diskriminuar, apo t'i cenohet e drejta e të punësuarit për shkak të anëtarësimit a mos anëtarësimit në organizatë sindikale, për aktivitet sindikal në organizatën sindikale;
3. Autoritetet qeveritare nuk mund të ndërhyjnë në kufizimin e të drejtave dhe lirive sindikale ndaj të punësuarve apo të pengojnë ushtrimin e lirshëm të aktiviteteve në sindikata.

Neni 7. Krijimi i kushteve për veprim sindikal nga punëdhënësi

1. Punëdhënësi duhet të krijojë kushte e lehtësi të nevojshme për përfaqësuesit e zgjedhur të organizatave, për veprimin sindikal të të punësuarve apo punëmarrësve.

Për krijimin e kushteve të volitshme për veprim sindikal, punëdhënësi duhet të bëjë:

- 1.1 lejimin e qarkullimit në mjediset e ambientit të punës;
- 1.2 lejimin e shpërndarjes së njoftimeve, broshurave, publikimeve dhe dokumenteve të tjera të organizatës sindikale për aktivitete sindikale;
- 1.3 sigurimin e kohës së nevojshme për aktivitetet sindikal brenda dhe jashtë vendit;
- 1.4 krijimin dhe ofrimin e lehtësive për grumbullimin e mjeteve të koutizmit, si dhe krijimin e kushteve optimale për funksionimin e sindikatës, duke përfshirë organizmin e mbledhjeve dhe takimeve të ndryshme sindikale.

Neni 12. Kushtet dhe kriteret për regjistrimin e sindikatave

1. Organizatat e punëtorëve (shoqata, federata dhe konfederata sindikale) për zyrtarizimin e fushëveprimit të tyre, duhet të aplikojnë për regjistrim në organin përgjegjës të ministrisë përkatëse për Punë dhe Mirëqenie Sociale.
2. Shoqata sindikale, si njësi themelore organizative, mund të regjistrohet në MPMS nëse ka së paku dhjetë (10) anëtarë sindikalë.
3. Federata sindikale mund të regjistrohet në MPMS nëse në kuadër të saj ka, së paku, dy (2) shoqata sindikale të veprimtarive të njëjta ose të ngjashme, anëtarësia e të cilave është, së paku, 10% e të punësuarve në nivel të sektorit përkatës.
4. Konfederata sindikale mund të regjistrohet në MPMS nëse në kuadër të saj veprojnë, së paku, dy (2) federata sindikale të veprimtarive të ndryshme, anëtarësia e të cilave është, së paku, 10% e të punësuarve në nivel të vendit.
5. Sindikatat mund ta fillojnë dhe zhvillojnë aktivitetin e vet vetëm pasi të jenë regjistruar në MPMS.

2.8.2.3 Sindikatat dhe gjendja momentale

Në Kosovë sindikatat nuk janë duke funksionuar në mënyrën e duhur, ato janë politizuar dhe në kontroll të politikës. Ato nuk po e luajnë rolin kryesor në përmirësimin e gjendjes apo mirëqenies së të punësuarve, por më shumë po merren me organizimin e evenimenteve, ekskursioneve, shëtitjeve, ahengjeve, të cilat më shumë sjellin përfitime për organizatorët sesa për punëtorët, e që vetëm sistemi i shitjeve apo privatizimi i aseteve publike në Kosovë la mijëra punëtorë pa punë e shumë familje pa mirëqenie. Mënyra e privatizimit ishte shkaku kryesor që shumë familje, në mënyra të ndryshme, u larguan nga Kosova, duke e shitur edhe pasurinë e tyre. Pra, ky proces vrau shpresën e shumë qytetarëve.

Andaj, po ta analizojmë rolin e BSPK-së, shihet qartë se nuk bëri asgjë në këtë drejtim, pra në të mirë të punëtorëve apo bëri shumë pak...

Në Kosovë kemi një gjendje jo të mirë të respektimit të punëmarrësve nga punëdhënësit, sidomos të atyre në sektorin privat. Kemi një mos barazi në paga dhe kemi politika fiskale të cilat e dëmtojnë rëndë jetën e klasës së mesme dhe të varfër. Kemi shumë raste dhe lëndë të

problemeve të natyrës së mosrespektimit të kontratave të punës apo shkeljeve të drejtave të punëtorit, e që zvarritën me vite në gjykata e shumë rrallë gjendet zgjidhje apo vihet drejtësia në kohë.

Andaj, këto probleme, por edhe shumë të tjera, si, bie fjala, mos regjistrimi i të punësuarve në organet tatimore nga punëdhënësit për t'i ikur pagesës së tatimit dhe pensionit, do të ishte e domosdoshme që BSPK-ja të ishte më funksionale, e që sot nuk është apo ndihet gjallë vetëm në ndonjë kërkesë për rritje pagash të ndonjë sektori publik, si, për shembull, puna e arsimit. Por, për një punëmarrës apo për një punëtor paga nuk është gjithçka, sepse shëndeti është mbi të gjitha. Kështu, po qe se BSPK-ja do e shtonte përpjekjen apo, në njëfarë mënyre, rezistencën mbi kërkesën e sigurimeve shëndetësore, kjo gjë do të vlente shumë.

2.9 Roli i qeverisë në përcaktimin e pagës minimale

Para se të fillojmë mbi diskutimet për rolin e qeverisë, ligjin e punës dhe krahasimet mbi pagën minimale në Kosovë dhe vendet e tjera, duhet të dimë se ç'është paga minimale. Paga minimale është paga më e ulët orare, ditore apo mujore që punëdhënësit mund t'u japin të punësuarve për t'i pasur ata në marrëdhënie pune ligjore. Thënë shkurt, paga minimale është paga më e vogël e mundshme, me të cilën punëtorët mund/lejohen ligjërisht ta shesin punën. Marrëdhëniet ndërmjet punëmarrësit dhe punëdhënësit rregullohen me ligjin e punës **Nr.03/L 212**. Njëri ndër nenet, i cili tregon se si rregullohet paga minimale, është:

Neni 57. Paga minimale

1. Qeveria e Kosovës në fund të çdo viti kalendarik përcakton pagën minimale sipas propozimit të Këshillit ekonomiko-social.
2. Gjatë përcaktimit të pagës minimale duhet të merren parasysh këta faktorë:
 - 2.1. kostoja e shpenzimeve jetësore;
 - 2.2. përqindja e shkallës së papunësisë;
 - 2.3. gjendja e përgjithshme në tregun e punës;
 - 2.4. shkalla e konkurrencës dhe produktivitetit në vend.
3. Paga minimale përcaktohet në bazë të orëve të punës për periudhën njëvjeçare, e cila

publikohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. (Kuvendi i Kosoves,2011)

4. Paga minimale mund të përcaktohet me marrëveshje në nivel kombëtar, në nivel dege dhe në nivel të ndërmarrjes, por që nuk duhet të jetë më e ulët se paga minimale e paraparë në paragrafin 1. të këtij neni.


Vendimi i parafundit me të cilin vendim është përcaktuar paga minimale në Kosovë është vendimi i datës 29.4.2011, e që pas një mbledhje të jashtëzakonshme të Këshillit ekonomiko-social është përcaktuar paga minimale 170€.

Por, pas kërkesave nga FMN-ja, është ndryshuar përcaktimi i pagës minimale, duke bërë një ndarje në pagën minimale në bazë të moshës së njeriut. Pra, tash, nën moshën 35 vjeç paga minimale është 130 euro/muaj, ndërsa për moshën 35-65 vjeç paga minimale është 170 euro/muaj.

Megjithatë, për një jetë më të mirë nuk është shumë e rëndësishme paga minimale, por çka mund të blesh me atë shumë parash. Në Kosovë kosto e jetës, për dallim nga paga minimale dhe ajo mesatare, është shumë e lartë dhe e papërballueshme për një jetë të mirë. Kosova edhe ashtu konsumin e saj e përcakton rreth 80% nga importi, shumë nga artikujt bazë për jetë janë me çmime më të larta se në shumicën e vendeve të Bashkimit Evropian, ku atje paga minimale është rreth 750€. (Eurostat, 2015)

Për ilustrim marrim disa shembuj të pagës minimale të shteteve të ndryshme.

Grafiku 9. Pagat minimale në shtetet ballkanike




Burimi: Eurostat

Tabela 4. Pagat minimale në Ballkan

Vendi	Paga minimale në euro/muaj	Data e fundit e përditësimit të të dhënave
Greqia	684€	01.01.2014
Kosova	130€	17.08.2011
Kroacia	405€	01.01.2014
Mali i Zi	193€	01.05.2013
Maqedonia	178€	01.01.2013
Serbia	188€	01.07.2013
Shqipëria	156€	01.07.2013
Turqia	425€	01.01.2014

Burimi: Burimi: Eurostat, Instituti i statistikave të vendeve përkatëse

Grafiku 10: Paga minimale në vende të Evropës



Burimi: Eurostat, Instituti i statistikave të vendeve përkatëse

Vendi	Paga minimale në euro/muaj	Data e fundit e përditësimit të të dhënave
Belgjika	1502€	01.01.2014
Britania e Madhe	1217€	01.01.2014
Bullgaria	174€	01.01.2014
Estonia	355€	01.01.2014
Franca	1445€	01.01.2014
Gjermania	1344€	01.01.2013
Greqia	684€	01.01.2014
Holanda	1485€	01.01.2014

Hungaria	344€	01.01.2014
Irlanda	1462€	01.01.2014
Kosova	130€	17.08.2011
Kroacia	405€	01.01.2014
Luksemburgu	1921€	01.01.2014
Mali i Zi	193€	01.05.2013
Maqedonia	178€	01.01.2013
Polonia	387€	01.01.2014
Portugalia	566€	01.01.2014
Republika Çeke	328€	01.01.2014
Rumania	191€	01.01.2014
Serbia	188€	01.07.2013
Shqipëria	156€	01.07.2013
Sllovakia	352€	01.01.2014
Sllovenia	789€	01.01.2014
Spanja	753€	01.01.2014
Turqia	425€	01.01.2014

Për krahasim, paga minimale në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në janar të vitit 2015 ishte 1.035 euro. Në Turqi paga minimale për gjashtë muajt e parë të këtij viti është 1.202 lira turke, përkatësisht 434 euro, ndërsa për pjesën tjetër të vitit 1.274 lira ose 460 euro.

KAPITULLI III

PAPUNËSIA NË KOSOVË DHE MIGRIMI

Hyrje

Papunësia ka të bëjë me numrin e fuqisë punëtore të një shteti. Siç cekëm edhe më lart, rritja ekonomike është prioritet i politikëbërësve të çdo vendi të botës, andaj edhe shfrytëzimi optimal i faktorëve të prodhimit duhet të jetë prioritet gjatë ndërtimit të politikave ekonomike. Njëri ndër faktorët e prodhimit më me rëndësi të një shteti për rritje ekonomike është kapitali njerëzor, mosshfrytëzimi optimal i të cilit nuk siguron perspektivë ekonomike të një vendi. Trendët e papunësisë dhe Bruto-produkti vendor (GDP) i vendeve tregojnë një lidhje të ngushtë. Dihet se në periudhat e uljes së papunësisë GDP-ja shënon rritje. E, në periudhat e rritjes së papunësisë produkti bie në shkallë dramatike. Lidhshmëria ndërmjet papunësisë dhe inflacionit janë fakt evident në ekonomitë e të gjitha vendeve. Kjo d.m.th., në periudhat e rritjes së inflacionit papunësia bie ndjeshëm dhe e kundërta - në periudhat e uljes së inflacionit papunësia rritet. Prandaj, duke marrë parasysh faktet e diskutuara më lart, në seksion e ardhshëm do të diskutojmë për nivelin dhe gjendjen e të papunëve në Kosovë, duke u bazuar në disa karakteristika, si dhe në disa faktorë e kushte të cilat janë specifike për papunësinë.

3. Dinamika e papunësisë në Kosovë (politikat e punësimit dhe korniza e nevojshme makroekonomike)

Rezultatet e këtij hulumtimi dhe të analizave të tjera tregojnë se shkalla e lartë e papunësisë dhe struktura e saj pasqyrojnë problemin kryesor social, e cila duhet të drejtohet nga ana e hartuesve të politikave dhe e Ministrisë së Punës e Mirëqenies Sociale. Meqë papunësia në Kosovë është, kryesisht, pasojë e shkallës së trashëgimisë së zhvillimit ekonomik, problemi kryesor është krijimi i një politike të shëndoshë makroekonomike, që do të mund të sigurojë një kornizë dhe kushte për funksionimin e tregut të punës në vend, i cili është në gjendje t'i mbajë vendet ekzistuese të punës dhe, posaçërisht, të krijimit të vendeve të reja të punës. Politika e tregut të punës nuk mund të zhvillohet me sukses nëse nuk merret parasysh situata e punësisë/papunësisë.

Politikat e krijimit të vendeve të punës, që nënkupton rritjen e mundësisë së kosovarëve për punë produktive, duhet të jenë si objektivi i strategjisë së zhvillimit ekonomik social. Kjo strategji ende nuk është zhvilluar dhe është pengesë serioze për ndërtimin më logjik të lidhjeve reciproke ndërmjet politikës ekonomike, politikës së punësimit dhe politikës sociale. Kjo mund të çojë në një ambient miqësor të punësimit, si dhe rritje të trendeve në punësim.

Politika e tregut të punës ka për qëllim rritjen e mundësive individuale për punësim dhe të zgjerojë kërkesën për fuqi punëtore. Integrimi dhe koordinimi i aktiviteteve të akterëve të ndryshëm dhe përmasat politike, janë çështje kryesore për t'u diskutuar dhe për t'u ndërtuar, posaçërisht nga Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale, si dhe agjencitë e ndryshme qeveritare.

Republika e Kosovës gjendet në mes të Evropës Juglindore (EJ), e cila ka sipërfaqe tokësore 10.908 km² dhe 1.739.825 banorë (Regjistrimi i popullsisë, 2011) rezidentë, pa i përfshirë tri komunat në veri të vendit. Kryeqyteti i Kosovës është Prishtina, me popullsi rreth 200 mijë banorë. Sipas të dhënave makroekonomike, Kosova, në krahasim me shumë vende të Evropës, ka pësuar më pak nga kriza ekonomike. Kosova dhe Shqipëria janë të vetmet vende në EJ që kanë shënuar rritje të GDP-së për banor gjatë vitit 2009. Megjithatë, Kosova mbetet ekonomia më e varfër në rajon dhe përballet me nivele të larta të varfërisë, papunësi masive (që në mesatare llogaritet të jetë 45%, për dallim, për shembull, nga Maqedonia me 37% dhe Shqipëria me 14%), varësia e rëndë nga importet dhe me sektorë shumë të vogël të eksportit, si dhe me mungesë të energjisë elektrike. Bruto të hyrat kombëtare (GDP) për kokë banori llogariten në 3.520\$. Andaj, Kosova radhitet në vendin 93 në botë, prapa Maqedonisë, Shqipërisë, Serbisë dhe Bosnjë e Hercegovinës. Numri i përgjithshëm i të papunësuarve në fund të vitit 2013 ishte 268.104.

Për shkak të përmasave të mëdha të ekonomisë informale, shifra e papunësisë së regjistruar mund të mos pasqyrojë plotësisht situatën e punësimit në sektorin privat. Sektori financiar në Kosovë mbetet në gjendje të mirë, përkundër krizës globale financiare. Aktualisht, në Kosovë funksionojnë shtatë banka komerciale, nëntë kompani sigurimi dhe dy fonde pensionale. Përdorimi i euros, si valutë zyrtare, kontribuon në stabilitetin e ekonomisë së Kosovës dhe mban inflacionin në normë të pranueshme, duke siguruar, kështu, një bazë të shëndoshë për politikën monetare.

Kosova ka rezultate të dobët të punësimit, ku shkalla e papunësisë ka arritur në 45 për qind dhe shkalla e punësimit është jashtëzakonisht e ulët - 26 për qind.

Varfëria në Kosovë mbetet mjaft aktuale. Rreth 29 për qind e popullsisë jetojnë në varfëri të përgjithshme dhe 8 për qind e popullsisë jetojnë në varfëri ekstreme (Banka Botërore). Krijimi i vendeve të punës është edhe më i rëndësishëm për faktin se popullsia e Kosovës është e re, po ta krahasojmë me vendet e tjera në rajon. Afërsisht gjysma e popullsisë së Kosovës është nën moshën 24 vjeç dhe vetëm 6 për qind e popullatës është mbi moshën 65 vjeç .

Papunësia paraqet përqindjen e të papunësuarve nga tërë kapaciteti i fuqisë punëtore në një territor të caktuar brenda një vendi apo në tërë vendin. Pra, ky indikator ekonomik tregon nivelin e fuqisë punëtore të pashfrytëzuar në proceset ekonomike në një territor gjeografik. Sipas klasifikimit të Bashkimit Evropian, të papunësuar janë ata pjesëtarë të fuqisë punëtore, të cilët nuk kanë pasur punë gjatë javës kur është bërë studimi, aktivisht kanë kërkuar punë gjatë asaj jave dhe janë të gatshëm të nisin një punë gjatë dy javëve të ardhshme. Shkalla e papunësisë është një tregues i mirëqenies ekonomike, në përgjithësi. Një shkallë e ulët është tregues i një ekonomie të fortë, ku ata që kërkojnë punë mund ta gjejnë atë shpejt, ndërsa një shkallë e lartë mund të tregojë një ekonomi më të dobët. Nga ana tjetër, punëdhënësit mund të gjejnë më lehtë punonjës kur shkalla e papunësisë është e lartë.

Pra, një ndër problemet shqetësuese në shoqërinë e sotme është papunësia. Përcaktimi për nocionin papunësi mbështetet në përkufizimin e dhënë nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (ONP - ang. ILO): "Të papunë konsiderohen të gjithë personat në moshë pune të bazuar në matjen e popullsisë ekonomikisht aktive, të cilët gjatë periudhës referuese i plotësojnë kërkesat: janë pa punë, të gatshëm për punë dhe kërkojnë punë". (Instituti Riinvest,2003)

3.1 Ç'është papunësia?

Përgjigjja e kësaj pyetje mund të duket evidente: një person i papunë është personi që nuk ka një vend pune. Por, ne, si ekonomistë, duhet të jemi të përpiktë dhe të kujdesshëm në përkufizimet tona të kategorive ekonomike. Në qoftë se ju jeni në arsim me kohë të plotë, për shembull, ju nuk keni një vend pune me kohë të plotë në kuptimin e zakonshëm të fjalës. Domethënë, nuk jeni në një punësim të paguar për kohë të plotë. Dhe, ekziston një arsye e mirë: ju po studioni. Që këtë del se ju nuk jeni në dispozicion për punë. E, në qoftë se nuk do ishit student e vuani nga ndonjë

sëmundje afatgjatë, do të thotë se jeni i papërshtatshëm për punë. Por, megjithëse nuk keni një vend pune, nuk do thoshim se ju do të ishit i papunë shkaku se jeni jo i gatshëm për punë. Nga këta dy shembuj duket qartë se duhet të kualifikojmë përkufizimin tonë fillestar të një personi të papunë nga “dikush që nuk ka një vend pune” në “dikush që nuk ka një vend pune dhe është i gatshëm për punë”.

Por, duhet të jemi të qartë se çfarë kuptojmë me “të gatshëm për punë”. Supozojmë se nuk do të ishit i punësuar me kohë të plotë dhe po kërkon një vend pune si asistent studimesh për 50 euro në ditë. A do ta zgjidhnit atë?

Në qoftë se nuk e përfillni për një çast ndërlikimin që studimet ekonomike janë aq shumë interesante, sa që ky është shpërblimi i atyre, ju, ndoshta, nuk do pranoni vendin e punës, sepse niveli i pagës së ofruar është shumë i ulët. Në ekstremin tjetër, supozoni se keni fituar shumë para në lotarinë kombëtare, aq sa keni vendosur t’i lini studimet e universitetin dhe ta jetoni me paratë e fituara pjesën e mbetur të jetës suaj. A do ishit i papunë? Jo, sepse nuk do të ishit ende i gatshëm për punë, pavarësisht çfarë niveli page do u ishte ofruar. Pra, të qenët i papunë varet edhe nëse jeni i gatshëm të punoni (nëse jeni “i disponueshëm për punë” me nivelet ekzistuese të pagës (Mankiw N. Gregory & P. Taylor Mark, 2012)

Tani jemi në gjendje të japim një përkufizim më të përpiktë se çfarë do të thotë të jesh i papunë: numri i të papunëve në një ekonomi është numri i njerëzve në moshë për punë, të cilët janë të aftë dhe të gatshëm për të punuar me nivelet ekzistuese të pagave dhe që nuk kanë një vend pune. Normalisht, ekonomistët e gjejnë të përshtatshme të flasin për normën e papunësisë. Ky shpreh numrin e të papunëve si përqindje e forcës së punës, e cila nga ana e vet mund të përkufizohet si numri total i njerëzve, të cilët do të mund të punësoheshin në ekonomi në çdo çast të dhënë të kohës. Në qoftë se mendoni për këtë, ai duhet të jetë i barabartë me numrin total të njerëzve të cilët janë punësuar, plus numri total i njerëzve të cilët janë të papunë.

3.2 Papunësia në Kosovë ndër vite (2000-2014)

Me papunësi kuptojmë numrin e të papunëve nga forca punëtore. Papunësia konsiderohet një ndër sëmundjet më të mëdha ekonomike, si një simptomë e fazës së recensionit ekonomik.

Prandaj, analiza teorike e saj merr një rëndësi të veçantë, sepse na lejon të përcaktojmë drejt edhe “medikamentet”, politikat përkatëse për t’i shëruar këto sëmundje.

Norma e papunësisë (%) = të papunët/forca punëtore

Papunësia i ka kostot e veta si nga pikëpamja ekonomike ashtu edhe nga pikëpamja sociale. Nga pikëpamja ekonomike një papunësi e lartë do të thotë GDP më e ulët. Sipas ligjit të Okunit, në çdo 1% të rënies së punësimit do të ndikojë në 2% në rënien e bruto-produktit kombëtar. Ndërkaq, rënia e bruto-produktit kombëtar do të thotë rënie e mirëqenies së popullatës, në përgjithësi.

Përveç kostove ekonomike, papunësia shoqërohet edhe me kosto sociale. Kostot sociale të papunësisë është vështirë të shprehen në vlerë monetare. Këto kosto mund të paraqiten në disa forma. Papunësia e zhvlerëson kapitalin human, kurse rritja e papunësisë përbën një bazë shumë të favorshme për rritjen e kriminalitetit etj. Një problem i tillë vazhdon të mbetet ndër problemet kryesore ekonomike në Kosovë prej vitesh. Norma e papunësisë në Kosovë vazhdon të mbetet e lartë, edhe pse, siç theksuam më lart, nuk ka statistika të sakta.

Tabela 5. Shkalla e papunësisë nga burime të ndryshme gjatë viteve

BURIMI	VITI I REFERENCËS	SHKALLA E PAPUNËSISË
IOM 05/2000 DHS	2000	50%
ESK 03/2004 AFP 2001	2001	57%
UNDP UNDP KHDR	2001	50-55%
ESK LFS 2002	2002	55%
RIINVEST 01/2003 AFP	2002	39-49%
ESK 03/2004a DHS	2003	53%
ESK 2005 AFP 2003	2003	50%
UNDP 2004 KHDR/HDS 2003	2003	44%

MPMS 03/2004	2003	43%
BANKA BOTËRORE	2003	23-33%
FMN 2004	2003	30%
MPMS 03/2005*	2004	42%
ESK 2005a AFP2004	2004	40%
MPMS 05/2006*	2005	42-44%
ESK 2006 AFP 2005	2005	41 %
MPMS 06/2007*	2006	39-42%
ESK 2007 AFP 2006	2006	44,9%
ESK 2008 AFP 2007	2007	43,6%
MPMS 04/2009*	2007	38-41%
MPMS 03/2009*	2008	38-41%
MPMS DPP 06/2010	2008	39-41%
MPMS DPP 05/2010	2009	37-40%


Burimi: Raporti i performancës MPMS/DPP 06/2010.

Nga tabela shohim se papunësia në vitin 2002 ishte 53.2%, në vitin 2003 ajo u rrit për afro 2%, kurse në vitin 2004 papunësia ra në 49%, pra për 6%. Rënia vazhdoi edhe në vitin 2005 në 39.7%, pra rënie për 10%, mirëpo në vitin 2006 u ngrit në 41.4%. Ndërkaq, tash vazhdon të sillet afër 40%.

Këto shifra të larta tregojnë se papunësia do të mbetet edhe për një kohë të gjatë sfida kryesore e ekonomisë dhe e shoqërisë kosovare, në përgjithësi. Sipas një studimi të departamentit të makroekonomisë në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave, që papunësia të mbetet

në nivele të tanishme, duhet të ketë një rritje reale e bruto-produktit kombëtar prej 4.7%, ndërkaq rritja reale e bruto-produktit kombëtar prej 7.3% do të mund ta përgjysmonte papunësinë deri në vitin 2020.

Kosova, vend i dal pas luftës së vitit 1999, është përballur me shumë probleme jetësore të të gjitha natyrave, kurse një problem i tillë është edhe me punësimin, meqë shumica e ndërmarrjeve janë dëmtuar nga lufta në mënyra të ndryshme (djegur, plaçkitur, dëmtuar nga bombardimet etj.), e një pjesë e madhe e tyre, e që u kanë mbijetuar këtyre problemeve, e kanë humbur tregun e tyre dhe teknologjinë prodhuese, të cilën e kishin në posedim. Andaj, më të tillët nuk ishin konkurrentë në tregun rajonal dhe nuk mund ta përballonin sistemin e ri të ekonomisë së tregut. Si pasojë e gjithë këtyre problemeve që u cekën më lart, edhe punësimi ka filluar të paraqitet si problem dhe është krijuar një armatë e madhe e të papunëve dhe papunësia ka arritur në shifra të larta. E, kur kësaj i shtohet edhe procesi i privatizimit, i cili në vend se të gjenerojë vende të reja të punës, ai proces u përcoll me shumë probleme dhe nuk ndikoi në rritjen e vendeve të punës, por ndihmoi në rritjen e papunësisë, duke u mbyllur shumë vende të punës, meqë ndërmarrjet e privatizuara e ndërruan veprimtarinë e biznesit dhe shumica e tyre nga prodhimi kaluan në tregti apo shumica e tokave të blera u shfrytëzuan për ndërtimtari.



Grafiku 11. Burimi: Raport i performancës/puna dhe punësimi 2013, MPMS

Numri i përgjithshëm i të regjistruarve si të papunë nga shërbimet publike të punësimit (SHPP) të Kosovës deri në fund të vitit 2013 është 268.104 persona. Të dhënat e paraqitura tregojnë ngritje të vogël prej 3.4% për 12 muaj, gjë që është indikator mjaft domethënës, duke krahasuar me rezultatet e rënies për 12 muaj nga viti 2012 (-20.3%), (shih grafikun 11).

Tabela 6. Papunësia e regjistruar 2007-2013

Përshkrimi	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Hyrjet 12 mujore	23279	21979	19462	19914	20125	24879	17984
ShH mesatarja mujore	0.58%	0.55%	0.35%	0.49%	0.50%	0.77%	0.56%
Daljet 12 mujore	14710	20632	16509	23549	30124	90799	9221
ShD mesatarja mujore	0.37%	0.51%	0.41%	0.58%	0.75%	2.81%	0.29%
Rritja 12 mujore	2.60%	0.40%	0.90%	-1.10%	-3.00%	-	3.40%

Burimi: Raporti i performancës/puna dhe punësimi 2013, MPMS

Akumulimi i hyrjeve për 12 muaj në papunësi të regjistruar ka rënie mjaft të lartë prej -27.7%, krahasuar me rezultatet e vitit 2012. Në të njëjtën kohë, dalja e akumuluar e papunësisë së regjistruar ka treguar rënie të theksuar me më shumë se -89.8%.

Sa i përket shkallës së hyrjeve, shih tabelën 1, e cila konfirmon trendin e përgjithshëm të tregut të punës prej vitit 2007. Mirëpo, shkalla e daljeve tregon shifra mjaft të larta, duke treguar një qarkullim të ulët dhe dinamikë të kufizuar të krijimit të vendeve të punës dhe të ri-integrimit të të papunëve në punësim.

Papunësia në Kosovë në vitin 2014 është rritur rreth 18 për qind, krahasuar me vitin 2013. Shprehur në shifra konkrete, numri i të papunëve është rritur për 31.914 persona. Agjencia e Statistikave e Kosovës ka publikuar anketën e fuqisë punëtore që tregon se papunësia në Kosovë në vitin 2014 ishte 35.3 për qind.

Në vitin 2013 niveli i papunësisë ishte raportuar në shkallën prej 30 për qind. Kjo ngritje prej 5.3 pikë të përqindjes, apo rreth 18 për qind, është bërë shkak i rënies së numrit të punësuarve, si dhe i rritjes së personave aktivë.

Vitin e kaluar Agjencia e statistikave kishte marrë kritika nga shoqëria civile dhe partitë opozitare për uljen artificiale të numrit të papunësisë nëpërmjet rritjes së numrit të personave joaktivë. Persona joaktivë konsiderohen atë të cilët nuk ishin as të punësuar e as të papunë, si dhe që nuk kishin kërkuar punë e nuk ishin as të gatshëm të fillonin një punë me pagesë.

Raporti për nivelin e papunësisë për vitin 2013 ishte publikuar disa ditë para zgjedhjeve të 8 qershorit të vitit të kaluar. Edhe Banka Botërore kishte shprehur rezerva për vonesat e publikimit

të raportit për papunësinë, për shkak të nivelit të lartë të papunësisë që kishte rezultuar nga anketat e vitit të kaluar.

Në raportin e Agjencisë për vitin 2014, që është publikuar, janë disa faktorë që kanë ndryshuar krahasuar me raportin e vitit 2013. Në vitin 2014 ASK-ja thotë se numri i personave aktivë ka qenë më i lartë për 1.1 për qind. “Nga 41.6% e popullsisë, që është ekonomikisht aktive, 35.3% janë të papunë”, thuhet në raportin për papunësinë në vitin 2014. Në vitin 2013 papunësia ka qenë 30 për qind.

Shprehur në shifra konkrete, në vitin 2014 numri i personave të papunë, sipas të dhënave zyrtare, janë 176.743. Pra, në vitin 2014 ka 31.914 persona më shumë të papunë se në vitin 2013, kur edhe ishin vetëm 144.829 sish. Rritja e numrit të papunësisë, sipas të dhënave të ASK-së, ka ardhur nga disa faktorë. Faktori i parë është rënia e numrit të personave që janë të punësuar, përkatësisht humbja e vendeve të punës. Të dhënat flasin se në vitin 2014 numri i personave të punësuar ka qenë 323.508 persona apo vetëm 26.9 për qind e personave të aftë për punë. Në vitin 2013 numri i të punësuarve ka qenë 338.364 apo 28.4 për qind e personave në moshë pune. Kjo shifër tregon se në vitin 2014 punën e kanë humbur 14.856 persona, të cilët kanë qenë në marrëdhënie pune në vitin paraprak.

“Gjatë periudhës trevjeçare (2012-2014) shkalla e punësimit ka ndryshuar me një rritje prej rreth 3% nga 2012-2013 dhe rënie prej 1.5% nga 2013-2014”, thuhet në raportin e ASK-së.

Faktori tjetër që ka ndikuar në rritjen e shkallës së papunësisë ka qenë aktivizimi i personave që kanë qenë të dëshpëruar në vitet e kaluara. Në vitin 2014 llogaritet se 58.4 për qind e popullsisë në moshë për punë nuk kanë qenë ekonomikisht aktiv. Kjo do të thotë, ata nuk janë të punësuar dhe nuk kanë qenë aktiv në kërkim të punësimit gjatë katër javëve të kaluara ose nuk janë të gatshëm të fillojnë punë brenda dy javësh. Në vitin 2013 niveli i popullsisë joaktive ishte 59.5 për qind.

Në pjesë e personave joaktivë, përveç shkallës së lartë të femrave dhe nxënësve, janë edhe një shtresë e qytetarëve të aftë për punë, por që janë dëshpëruar shkak i pamundësisë në të kaluarën për të gjetur një vend pune.

“Nga 58.4% e popullsisë në moshë pune, që është joaktive, 18.2% (128.400 persona) nuk kërkonin punë, sepse besonin se nuk ka punë. Punonjësit e dekurajuar përbëjnë 10.7% të popullsisë në moshë pune, me nivele të ngjashme për femrat dhe meshkujt”, thuhet në raportin e ASK-së për vitin 2014.

Numri i personave të dekurajuar ka rënë për 15.300. Këtu është numri i personave që në vitin 2013 janë llogaritur si të dëshpëruar, por që në vitin 2014 kanë nisur sërish të kërkojnë punë dhe, rrjedhimisht, janë cilësuar si të papunë. Të dhënat e fundit të fuqisë punëtore të ASK-së tregojnë një pasqyrë më reale të papunësisë sesa ajo e disa viteve më parë, por prapëseprapë të dhënat se papunësia është 35.3% nuk janë reale. Madje, nëse lexohet në tërësi raporti i ASK-së, edhe aty shihet se metoda e kalkulimit të papunësisë nuk e tregon papunësinë reale në Kosovë.

Si është e mundur që një shoqëri me stad të zhvillimit si Kosova të ketë mbi 58% të personave në moshë të punës, të cilët nuk janë persona aktivë, apo persona që “nuk e duan punën”? Kjo ndodh shkaku se metodologjia e ASK-së përjashton një numër të madh të atyre që janë të aftë për punë, por të cilët nuk klasifikohen si të papunë. Në këtë hyjnë studentët, ata që gjatë javës së fundit të anketës janë përfshirë në ndonjë punë të familjes, ata të cilët janë lodhur nga aplikimet e shumta për punë, si dhe ata të cilët nuk mbajnë shpresë se nëse regjistrohen në qendrat e papunësisë mund të gjejnë punë.

Prandaj, themi se edhe niveli i punësimit tregon për gjendjen e vështirë të sektorit privat.

“Duke marrë parasysh se të punësuar janë rreth 323 mijë persona dhe kur dihet se në sektorin publik janë të punësuar rreth 100 mijë, atëherë del se afro 1/3 e punësimit bëhet në sektorin publik. Pra, një shifër shqetësuese që e dëshmon gjendjen dëshpëruese të sektorit privat”.

Prandaj, çereku i të punësuarve kanë punë të paqëndrueshme.

“Po ashtu, edhe ASK-ja pranon se jo të gjithë këta, mbi 323 mijë të punësuar, janë të punësuar të rregullt. Mbi 81 mijë, nga këta që konsiderohen të punësuar, kanë punësim të paqëndrueshëm, punësim pa kontratë, me ndërprerje kohore dhe me të ardhura të cilat nuk i mbulojnë shpenzimet mujore të të punësuarit”.

Raporti i ASK-së për anketën e fuqisë punëtore tregon për një dallim të madh gjinor në mesin e të punësuarve. Vetëm 1 në 5 femra në moshë pune janë aktive në tregun e punës, apo 21.4 për qind. Konkretisht, vetëm 12.5 për qind e femrave në moshë pune (15-64 vjeç) janë të punësuar. Pjesa më e madhe e femrave kanë deklaruar se janë joaktive shkaku i obligimeve familjare.

“Kjo shkallë shumë e ulët e papunësisë së femrave rrjedh nga kombinimi i pjesëmarrjes shumë të ulët në fuqinë punëtore dhe papunësisë së lartë. Përgjegjësitë familjare ishin arsyt kryesore për jo aktivitetin e femrave në tregun e punës. 38.8% e femrave të intervistuar kanë dhënë këtë arsye”, thuhet në raportin e ASK-së.

Por, i njëjti raport flet për shkallë shumë të lartë të papunësisë të rinjtë.

“Në vitin 2014 të rinjtë në Kosovë kishin gjasa dy herë më shumë të jenë të papunë krahasuar me të rriturit. Në mesin e personave të moshës 15-24 vjeç dhe në fuqinë punëtore, 61.0% ishin të papunë. Papunësia është më e lartë te femrat e reja (71.7%) sesa te të rinjtë meshkuj (56.2%)”, thuhet në raportin e ASK-së.

“Pothuajse një e treta (30.2%) e personave të moshës 15 deri 24 vjeç në Kosovë nuk ishin në shkollim, punësim apo trajnim. Kjo shifër është 34.0% për femrat e reja krahasuar me 26.6% për meshkujt e rinj”.


Personat që kanë fatin të punojnë llogaritet se kanë një pagë ndërmjet 300 dhe 400 euro.

“Pagat neto të shumicës së punonjësve ishin ndërmjet 300 deri në 400€ në muaj. Janë vërejtur dallime shumë të vogla gjinore”, thuhet në raportin e ASK-së.

3.3 Papunësia sipas moshës

Sa i përket papunësisë së regjistruar sipas grup-moshës, shumica e të papunëve (126.836) në shifra të akumuluar ende i referohen moshës prej 25-39 vjeç ose 47%.

Grafiku 12. Shkalla e rritjes së papunësisë sipas moshës




Burimi: Raporti i performancës/Puna dhe punësimi 2013, MPMS

Si në vitet paraprake, presioni më i lartë sa i përket papunësisë është prapë grupi më i ri për nga moshë, e në veçanti sa i përket rritjes në regjistrime me 3.6% (shih figurën). Në përgjithësi, duke shikuar tendencat e përgjithshme, por duke konfirmuar sipas rezultateve të vitit 2013, të papunët e moshave 25-39, pastaj 40-54, si dhe 55-64 vjeç tregojnë një rritje në regjistrime, e cila është 3.2%, 3.7% dhe 1.9%) në vitin 2013.

3.4 Papunësia e regjistruar sipas gjinisë

Numri i përgjithshëm i personave të regjistruar si të papunë në shërbimet publike të punësimit në Kosovë deri në fund të vitit 2013 ishte 124.369 femra dhe 143.735 meshkuj. Numri i femrave të regjistruara është në rritje prej 4.2% gjatë vitit 2013, sikurse edhe numri i meshkujve të regjistruar si të papunë që ka rritje rreth 2.7%.

Grafiku 13. Papunësia e regjistruar sipas gjinisë



Burimi: Raporti i performancës /Puna dhe punësimi 2013, MPMS

Megjithatë, zbrazëtia e gjithëmbarshme gjinore është me vlerë të theksuar me 1.5 pika përqindjeje (pp) në shkallën e rritjes. Për më shumë, te femrat e papuna shihet një ngritje e shkallës së daljeve nga papunësia. Si rrjedhojë, pjesa e femrave në dalje të përgjithshme në vitin 2013 është rritur në nivel prej më shumë se 38.2% (krahaso fig. 5). Duke marrë në konsideratë relacionin e divergjencave gjinore me “rrezikun”, grupet e të rinjve (15-24) dhe të pakualifikuarve të papunë, ekziston një zhvillim negativ. Sa i përket shifrave të meshkujve të papunë të të njëjtit grup moshe (15-24), tregojnë rritje prej -14.4%, sa ishte në vitin e kaluar, në 3.1%. Ndërsa, femrat e papuna (15-24) me moshë të re, në vitin 2013 si të papuna tregojnë një shkallë të rritjes prej -12.7% në 4.1% (shih. tabelën).

Tabela 7. Papunësia sipas gjinisë

	2011		2012		2013	
Përshkrimi	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj
Shkalla mujore e hyrjeve	0.52%	0.48%	0.70%	0.83%	0.58%	0.55%
Shkalla mujore e daljeve	0.67%	0.82%	329%	2.40%	0.24%	0.33%
Rritja 12 mujore	-2934	-7065	-38548	-27372	4995	3768
Shkalla e rritjes 12 mujore	-1.80%	-4.10%	24.40%	-16.40%	4.20%	2.70%
Papunësia	157922	167339	119374	139967	124369	143735
Proporcioni	48.60%	51.40%	46.00%	54.00%	46.40%	53.60%
Rritja 12 mujore e të pa kualif.	-1.60%	-4.10%	27.70%	-18.60%	-17.10%	28.70%
Regjistrimi i të pa kualifik.	113722	81672	82260	66489	68164	85557
Proporcioni i të pa kualifik.	58.20%	41.80%	55.30%	44.70%	44.30%	55.70%
Rritja 12 mujore 15-24 vjeç	2.10%	0.60%	12.70%	-14.40%	4.10%	3.10%
Të regjistruar 15-24	53172	53950	46423	46192	48338	47607
Proporcioni 15-24	49.60%	50.40%	50.10%	49.90%	50.40%	49.60%

Burimi: Raporti i performancës /Puna dhe punësimi 2013, MPMS

Shikuar në nivelet e kualifikimit sipas gjinisë, paraqitet një zbrazëti e reduktuar gjinore, e cila është e bazuar në një shkallë në rënie për femrat (shih tabelën), ku femrat kanë reduktuar pikë negative të përqindjes prej -27.7%, sa ishte në vitin e kaluar, në -17.1% për vitin 2013. Ndërsa, meshkujt e pakualifikuar kanë tendencë rritjeje, ku në vitin 2012 ishte -18.6%, ndërsa në vitin 2013 është 28.7%.

Sa u përket femrave të papuna të pakualifikuara, vlen të përmendet prapë procedura që aplikohet për asistencë sociale, e cila në Kosovë u jepet më shumë se 40.000 familjeve. Një kërkesë bazike për këtë është të dëshmohet se nuk marrin të ardhura të tjera. Për të bërë një gjë të tillë, ia vlen të regjistrohen të gjithë anëtarët e familjes me moshë madhore të një shtëpie si të papunë.

Edhe pse një analizë e hollësishme për këtë ka mangësi të të dhënave dhe zbrazëti, është mjaft bindëse se u është referuar regjistrimeve të shumta të femrave pa punë, të cilat në formë administrative janë “shtyrë” nga definimi i statusit personal si “jo aktive ekonomikisht” në status të të “regjistruarit si të papunë”.


Vlerësimet e njëanshme do të cilësonin këto raste më së paku 30.000-40.000 persona, të cilët duhet marrë parasysh sa i përket numrit të tanishëm të femrave të regjistruara, si dhe aktivitetet e mëtejme të promovimit të punësimit, në bazë të analizave të zbrazëtime aktuale gjinore (shih MPMS-DPP 2010, 2011, 2012 shih BB 2003, 2004, shih ESK 2009).

3.5 Punësimi sipas sektorit

Gjatë vitit 2013, sa i përket klasifikimit klasik të sektorëve ekonomikë, si në vitet e mëparshme, shumica e vendeve të lira të ofruara i referohen sektorit terciar (shërbimet 70%), ndjekur nga sektori sekondar (prodhimi 21%) dhe sektori primar (bujqësia 9%).

Sektori terciar tregon një rritje modeste në numrin e vendeve të lira të punës të raportuara gjatë kësaj periudhe raportuese prej 56%, sa ishte në vitin 2012, në 70% në vitin 2013. Ndërsa, sektori sekondar tregon vlera në rënie prej 32%, sa ishte në vitin 2012, në 21% gjatë këtij viti. Njëjtë edhe sektori primar tregon rënie prej 12%, sa ishte në vitin e kaluar, në 9% për vitin 2013.


Grafiku 14: Vendet e lira sipas sektorit në 12 muaj



Burimi: Raporti i performancës /Puna dhe punësimi 2013, MPMS

Sektori i shërbimeve (terciar) në vazhdimësi, si në periudhat e mëhershme raportuese, po ashtu edhe në vitin 2013, i ka realizuar vlerat maksimale në kërkesën e përgjithshme (shih figurën).

Grafiku 15. Vendet e lira sipas pronësisë



Burimi: Raporti i performancës /Puna dhe punësimi 2013, MPMS

Sa i përket zhvillimeve në tregun e punës në Kosovë, të ndara sipas sektorit të pronësisë, numri përgjithshëm i vendeve të lira i është referuar sektorit privat. Sipas rezultateve të përgjithshme, në vitin 2013 sektori privat ka realizuar rënie të vogël prej -4.4%, sa ishte në vitin 2012, në -13.5% gjatë këtij viti raportues. Ndërsa, sektori publik ka shënuar rënie shumë të theksuar, duke pasur parasysh se gjatë vitit 2012 rënia ka qenë -1.7%, ndërsa gjatë këtij viti raportues është -51% (shih figurën).

3.6. Migrimi i fuqisë punëtore

Nga teoria e migrameve dhe hulumtimet empirike mësohet se në migrimet ndërkombëtare ndikon një varg i tërë i faktorëve të ndërlikuar dhe shpeshherë reciprokisht të lidhur e të kushtëzuar, ku, në një anë, janë push faktorët (repulzivë) dhe, në anën tjetër, pull faktorët (atraktivë). Skema e përgjithshme e determinanteve të këto migrame në të dy drejtimet mund të përmbledhet në ato të natyrës ekonomike, politike, historike, fetare, raciale, klasore etj.

Në një vend si Kosova, ku dominohet me një mesatare të popullsisë për nga mosha e re dhe një papunësie të madhe, e ku kërkesa për punë është e lartë, pra më madhe sesa mundësia për punësim, pa dyshim, të jesh i punësuar është privilegj. Dhe, kur kësaj i shtohet fakti se edhe ata të cilët janë të punësuar, shumica prej tyre paguhet rreth 170€-400€, krahasimi karshi shpenzimeve dhe kostove është më se e sigurt se siguria ekonomike në familjet në Kosovë mungon.

Vazhdimësia e mungesës së sigurisë së mirëqenies, mungesa e hapjes së vendeve të reja të punës, mungesa e luftës së krimit dhe korrupsionit, si dhe mungesa e politikave fiskale adekuate e zhvillimore, kanë bërë që shumë qytetarë të Kosovës të ikin nga vendi që me mundësinë e parë që u jepet. E, një embargo e jashtëzakonshme ishte, pikërisht, në vitin 2015, edhe 16 vite pas lufte.

Raporti mbi migrimin kosovar, si i tillë, përgatitet për herë të parë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës. Raporti paraqet të dhënat për migrimin ndërkombëtar (emigrimin-imigrimin), si dhe atë kombëtar (emigrimin). ASK-ja këtë raport e ka përgatitur dhe e publikon në bazë të përgjegjësiqve që dalin nga Ligji për Statistikat Zyrtare të Republikën e Kosovës, Nr. 04/L-036, konkretisht në bazë të nenit 16 dhe 28 të këtij ligji.

3.7 Migrimi kombëtar

Bazuar në të dhënat e regjistrimit të popullsisë së vitit 2011, popullsia e Kosovës mund të përshkruhet si popullsi migruese. Të dhënat për migrimin, të mbledhura gjatë regjistrimit të popullsisë, kanë të bëjnë me ndryshimin e fundit të vendbanimit/komunës, kurdo që të ketë ndodhur ai. Nga numri i përgjithshëm prej 1.739.825 personave të regjistruar, në regjistrimin e popullsisë (prill 2011), prej tyre 517.992 persona, apo rreth 30% e tyre, kanë përjetuar, të paktën, një migrim.

Një numër i tillë i migrimit (rreth 30%) paraqet një përvojë të madhe sa i përket përshtatjes ndaj kushteve të ndryshme jetësore dhe pasurim të kulturës së përgjithshme të një personi që mund të jetë pasuri për tërë vendin.

Tabela 8. Imigrimi ndërkombëtar/kombëtar në Kosovë

Gjinia / përqindja	Gjithsej	Imigruan në Kosovë	Migrimi kombëtar (i brendshëm)	
			Migruan nga një komunë në tjetër komunë	Migruan brenda një komune
	517,992	128,808	196,429	192,755
Meshkuj	176,826	79,187	52,997	44,642
%	34.1	61.5	27.0	23.2
Femra	341,166	49,621	143,432	148,113
%	65.9	38.5	73.0	76.8

Burimi: Raporti i zhvillimit ekonomik në Kosovë, 2011

Tabela 9. Arsyet kryesore të migrimit kombëtar (brenda dhe jashtë komunës së tyre), të shprehur në përqindje.

Arsyet e migrimit	Gjithsej
Punësimi	5.8
Arsimi & qëllime trajnimi	2.8
Familjare	73.4
Luftës 1998-'99	4.5
Tjera	13.5


Burimi: Raporti i zhvillimit ekonomik në Kosovë, 2011

3.8 Trendet e migrimit në Kosovë

Kosova ka një nga normat më të larta të emigracionit në Evropën Lindore (shih figurën). Sipas anketës së migrimit 2009 (Banka Botërore 2010), çdo e katërta familje ka, së paku, një anëtar që jeton jashtë Kosovës. Shkalla e emigrimit për Kosovën nuk tregon emigrimin neto, sepse imigrantët nuk zbriten, mirëpo emigrimi neto nuk ndryshon shumë nga ai bruto, sepse shumica e imigrantëve në Kosovë janë banorë të përkohshëm që kthehen në vendin e tyre sapo të përfundojë detyra e tyre (Raporti nr. 60590 – XK, 2011)

Për më tepër, interesi për të migruar është i lartë. Rreth 2.1 për qind e të anketuarve deklaruan se ata kanë gjasa për të migruar brenda pesë viteve të ardhshëm (edhe pse të dhënat e vetëraportuara për të migruar shpesh mbivlerësojnë rrjedhat në të ardhmen dhe shpesh ka korrelacion shumë të vogël ndërmjet qëllimit për migrim dhe migrimit aktual). Në vitin 2008 rreth 0.6 për qind e popullsisë që punon u bë emigrantë. Edhe në vitin 2007, kur emigrimi arriti maksimumin, vetëm rreth 11.000 kosovarë u larguan (rreth 1 për qind e popullsisë që punojnë).


Grafiku 16. Neto emigrimi në Evropën Perëndimore, 1983–2003.



Burimi: Zyrat statistikore kombëtare; Anketa e migrimit në Kosovë, 2009. **Vërejtje:** Të dhënat e Kosovës nuk përfshijnë imigrimin. Të dhënat e Kosovës i referohen periudhës 1989-2009, ndërsa për shtetet e tjera periudha e cituar është 1983-2003.

Tradicionalisht, pothuajse 60 për qind e migruesve nga Kosova kanë shkuar në Gjermani dhe në Zvicër. Numri i migruesve nga Kosova nuk ka ndryshuar shumë që nga viti 2005. Megjithatë, vendet e tjera evropiane, gjithashtu, janë bërë destinacion (figura 3). Krahësuar me vitin 2005, në vitin 2009 mbi 10 për qind e migruesve u drejtuan për në destinacione të tjera në Evropë, veçanërisht në Itali (për të njëjtin model, shih, gjithashtu, UNDP 2010). Ky trend tregon se kosovarët janë duke ndërtuar rrjete në vende të tjera evropiane, që kontribuon në diversifikimin e mëtejshëm. Vendet e destinacionit janë të ngjashme me ato të vendeve fqinje të Ballkanit.

Grafiku 17. Ndarja e migruesve sipas destinacionit (1959–2009).




Burimi: Anketa e migrimit 2009 (Banka Botërore, 2010).

Mosha mesatare e migruesve ka qenë në rritje që nga vitet 1990, kur ishte 19, meqë në vitin 2009

ishte 29 (shih figurën). Kjo ndodhi, ndoshta, shkak se gjatë viteve të luftës shumë prej atyre që emigronin ishin refugjatë të rinj politikë (ESI 2006). Qëkur konflikti u qetësua në vitin 1999, prindërit dhe anëtarët më të vjetër të familjes kanë migruar për t'u bashkuar me emigrantët e mëhershëm (Raporti Nr. 60590 – XK, 2011)

Grafiku 18. Mosha mesatare e migruesve



Burimi: Anketa e migrimit 2009 (Banka Botërore, 2010).

Ky ndryshim në moshën e migruesve mund të ketë qenë i nxitur pjesërisht nga politikat e migrimit të vendeve të destinacionit. Për shembull, Gjermania futi një skemë të bashkimit, duke u lejuar anëtarëve të familjeve të emigrantëve në Gjermani, por duke kufizuar të pamartuarit që kërkojnë punë. Një trend i ngjashëm moshe është vënë re në Shqipëri (Azzari & Carletto 2009). Që nga viti 2000 mosha mesatare ka qenë pak më e lartë për gratë migruese sesa për burrat. Më parë, nga 1991-1993, gratë migruese ishin 3-5 vjet më të reja.

3.9. Modelet e analizës së kostove dhe përfitimeve nga migracioni

Në vendet nga të cilat ka migrim të konsiderueshëm, integrimi i politikave të lidhura me migrimin në strategjitë kombëtare të zhvillimit mund të kontribuojë në zhvillimin ekonomik dhe social. Marrëdhëniet ndërmjet migrimit dhe zhvillimit kanë qenë një temë e rëndësishme e diskutimit shkencor. Për disa kjo është marrëdhënie shkakësore, kurse disa mendojnë se migrimi është një efekt anësor i zhvillimeve ekonomike, ndërkaq të tjerë mendojnë të kundërtën. Disa

mendojnë se shkaqet janë të dyanshme dhe një perspektivë e fundit është se migrimi është thelbësor për zhvillimin e një shoqërie - një komponent i ndërtimit të zhvillimit ekonomik. Për shembull, Hain de Haas argumenton se "migrimi nuk është një variabël e pavarur që shpjegon ndryshimin, por është një variabël endogjene, një pjesë përbërëse e vet ndryshimit në të njëjtën shkallë sa ai mundëson ndryshimin e mëtejshëm. (De Haas, 2008)

Cilado pikëpamje të merret, nuk ka dyshim se politikat publike forcojnë efektet pozitive të migrimit në zhvillim. Politikat mund të synojnë çdo fazë në procesin e migrimit: para se emigrantët të largohen nga vendi, gjatë qëndrimit të tyre jashtë vendit dhe pas kthimit të tyre në vendlindje. Përfitimet e mundshme të politikave të tilla do të kishin efekte të përhapjes në gjithë ekonominë, jo vetëm në emigrantët dhe familjet e tyre.

Situata e emigrantëve, kualifikimet, statusi ligjor dhe i punësimit, kur ata hyjnë në vendin pritës, në masë të madhe, përcakton suksesin e tyre profesional atje, që, nga ana tjetër, përcakton se sa ndikim ata mund të kenë kur të kthehen në vendlindje. Emigrantët me status të kufizuar apo joligjorë jashtë vendit vuajnë nga mungesa e mundësive ose kanë mundësi të kufizuara punësimi. Për shembull, ata që largohen nga shtëpia pa leje formale të punës kanë më shumë gjasa për të fituar të ardhura më pak, përballen me më shumë vështirësi për të gjetur punë, janë objekt i stereotipave sociale dhe përballen me mundësitë e kufizuara të ngritjes në profesion. Dhe, të gjitha këto e ulin mundësinë e tyre për të dërguar para në shtëpi dhe për të fituar aftësi të reja. Mirëqenia ekonomike e emigrantëve përcaktohet edhe me aftësitë e tyre dhe sa ata janë të informuar për mundësitë e punësimit në vendin e destinacionit. Ata që kanë aftësi më të mira dhe dinë më shumë për perspektivat e tyre të punës, fitojnë më shumë dhe janë më të lidhur me vendin e tyre. Këta emigrantë kanë më shumë gjasa për të përdorur sektorin financiar për transferet e parave dhe kursimet, që, nga ana tjetër, i motivojnë familjarët e tyre për të përdorur shërbime të tilla.

- Faktorët shtytës dhe tërheqës të migrimit

Kosova vazhdon të vuajë nga korrupsioni sistematik, që shpeshherë është i përkeqësuar nga mitosja e zyrtarëve të lartë qeveritarë, nepotizmi në punësim dhe nga mjedisi i pasigurt për biznese. Sipas Transparency International, Kosova është ranguar e 110-ta me rezultat prej 33 pikësh në indeksin e perceptimit të korrupsionit, që atë e vë në të njëjtin nivel me vendet më së paku të zhvilluara, si: Etiopia, Guatemala, Ekuadori, Malavi etj.

Në rajon Kosova mbetet e fundit kur krahasohet me Serbinë, Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Malin e Zi. Për më tepër, Kosova vazhdon të mbizotërohet nga politizimi i sektorit publik dhe mungesa e mundësive të barabarta në punësim, që shpesh qytetarët i bëjnë të veprojnë si të tjetërsuar nga shteti.

Administrata publike vazhdon të jetë tejet e politizuar nga dy partitë kryesore politike në pushtet. Punësimi në sektorin publik vazhdon t'i joshë shumë të punësuar, duke ofruar një mjedis të pa konkurrencë për sektorin privat. Sektori publik vazhdon të ofrojë paga mesatare më të larta se sektori privat (paga mesatare në sektorin publik është 441€, kurse në sektorin privat është 228€). Mundësitë e kufizuara në punësim e përkeqësojnë mjedisin edhe ashtu të pasigurt për bizneset e vogla kosovare. Korrupsioni, nepotizmi dhe mundësitë e kufizuara vazhdojnë të ndikojnë edhe në investimet e huaja në Kosovë. Për shembull, Banka Qendrore e Kosovës ka raportuar se në gjysmën e parë të vitit 2014 investimet e huaja direkte në Kosovë ishin 110.1 milionë €, që është 32.9 për qind më pak krahasuar me shifrën përkatëse për vitin 2014, 46%. Përveç korrupsionit sistemik, nepotizmit dhe mundësive të kufizuara, Kosova mund të përballet edhe me mundësinë e trazirave sociale. Disa nga përfaqësuesit ndërkombëtarë priten shpërthime të dhunshme dhe jo stabilitet në Kosovë, të nxitura nga këta faktorë (Instituti KIPRED, 2015). Në janarin e vitit 2015 ndodhën protesta masive në Prishtinë, pas një kërcënimi të vazhdueshëm që shpërthyen befasisht pas vendimeve të qeverisë së zgjedhur rishtas. Protestat përfunduan dhunshëm, ku numri i të lënduarve ishte 170 qytetarë, 107 policë, 53 protestues dhe 10 kalimtarë të rastit. Kjo “bombë e kurdisur sociale” mbetet mbi qeverinë e zgjedhur rishtas, krahas numrit të madh të të migruarëve, të cilët kanë braktisur Kosovën kohëve të fundit.

Kthimi masiv i mundshëm i atyre që migruan nga disa shtete të BE-së, vetëm sa do ta acarojë gjendjen edhe më tutje. Duke pasur parasysh faktin se ata që migruan kanë paguar shuma të konsiderueshme të parave për të ikur nga Kosova dhe që Qeverisa e Kosovës është ngurruese për të ofruar asistencë financiare për të kthyerit, situata do të vazhdojë të jetë me rrezik për t'u përshkallëzuar në jo stabilitet.

Për më tepër, sipas Bankës Botërore, zhvillimi i Kosovës mbetet i pamjaftueshëm, me një papunësi të përhapur gjerësisht dhe me mungesë të vendeve cilësore të punës, që i kontribuojnë varfërisë dhe të ardhurave të pasigurta. Edhe strategjia për migrim e Qeverisë së Kosovës e përmendë papunësinë si shkaktarin kryesor të migrimit të qytetarëve të Kosovës dhe shkalla e papunësisë e cituar nga Agjencia e Statistikave është 45%.

Sidoqoftë, Kosova vazhdon të ketë shkallën e punësimit nga më të dobëtat në Evropë. Duke u bazuar në kufirin e vijës së varfërisë së brendshme të Agjencisë së Statistikave për vitin 2011 prej 1.72€ në ditë, Banka Botërore konsideron se 29.7 për qind e popullatës (nga 1.8 milionë banorë sa llogaritet të ketë Kosova) janë të varfër. Profili i migrimit i Ministrisë së Punëve të Brendshme për vitin 2013, i citon arsyet e migrimit si ekonomike dhe ato të bashkimit familjar. Edhe një faktor tjetër shtytës i përmendur qëndron në shërbimet e dobëta shëndetësore, si pasojë e të cilit qytetarët kërkojnë shërbime më të mira shëndetësore në vendet rajonale, më së shumti në Maqedoni dhe gjetiu. Kjo situatë vështirësohet edhe më tutje nga fakti se qytetarët e Kosovës ende nuk gëzojnë sigurim shëndetësor që nga viti 1999.

Në mesin e faktorëve tërheqës kanë qenë vendimet e disa shteteve evropiane, si, Gjermania, Franca dhe Austria, që të mos e konsiderojnë Kosovën si vend të sigurt, shkak i shkeljeve të ndryshme politike, ligjore, si dhe të të drejtave të njeriut në vend. Koncepti i vendeve të sigurta në Bashkimin Evropian ndryshon nga vendi në vend. Për shembull, sipas ligjit gjerman vend i sigurt konsiderohet ai "... në të cilin, në bazë të ligjeve të tij, të praktikave të zbatimit dhe të rrethanave të përgjithshme politike, mund të përfundohet me siguri që nuk ekzistojnë as persekutime politike dhe as dënime ose trajtime jonjerëzore dhe degraduese". Nga ana tjetër, në gjysmën e parë të vitit 2013, autoritetet hungareze hoqën dorë nga praktikat e ndalimit të azilkërkuesve, duke hapur kështu mundësi të mëdha për kontrabandistët për t'i drejtuar qytetarët e Ballkanit Perëndimor, përfshirë këtu edhe kosovarët, në vendet e tjera anëtare të BE-së. Kjo mundësi nuk u humb nga kontrabandistët kosovarë dhe serbë, gjë kjo që, në fundin e vitit 2014 dhe në fillimin e atij 2015, çoi në një rritje të kalimeve të paligjshme të kufirit dhe të aplikimeve për azil nga qytetarët kosovarë. Këta faktorë u shfrytëzuan nga kontrabandistët për t'i keqinformuar qytetarët dhe për ta rritur rrjedhën e migrimit për në shtetet e BE-së. Mediet u shfrytëzuan për të përhapur informata jo faktike dhe të paqarta, për atë se si disa nga shtetet e BE-së kishin filluar t'u jepnin azil kosovarëve. Kështu, shtetet kryesore të BE-së, që u shfrytëzuan si destinacion, ishin Gjermania, Franca e Austria dhe tranziti kryesor ishte nëpërmjet Serbisë për në Hungari.

Kosova është, po ashtu, vendi i vetëm që është lënë jashtë marrëveshjes për lehtësimin e vizave, e cila është nënshkruar me vendet e tjera të rajonit, para fillimit të procesit të liberalizimit të vizave. Marrëveshja për lehtësimin e vizave do t'i zbuste procedurat për aplikim për viza. Shkak i mungesës së lehtësimit të vizave, gjatë viteve 2010-2012 për viza Shengen aplikuan

217.862 kosovarë. Mbi 17% të aplikimeve për viza u refuzuan nga shtetet e zonës së Shengenit, ku kosovarët shpenzuan rreth 15 milionë euro për procedurat e aplikimit për viza. Në vitin 2013 në vendet e BE-së, me numrin më të lartë të azilkërkuesve nga Kosova, shkalla e refuzimit ishte 20 apo 625. Në vitet 2012 dhe 2013 numri i qytetarëve të Kosovës, të cilëve iu refuzua hyrja në shtetet anëtare të BE-së, u rrit nga 625 në 1.400. Kjo rritje e shkallës së refuzimit u vijua nga rritja e numrit të qytetarëve të Kosovës që qëndronin në mënyrë të paligjshme në BE, nga 5.200 në 7.870 sish. Bazuar në shifrat e viteve 2010-2012, vetëm një në dhjetë kosovarë e kishte lëvizshmërinë për të udhëtuar lirshëm në BE.

Dhe, të ndodhur ndërmjet këtyre faktorëve shtytës dhe tërheqës, qytetarët e Kosovës mbetën peng të mungesës së vullnetit politik të shteteve të BE-së për të përshpejtuar liberalizimin e vizave për Kosovën.

Vetëm kohëve të fundit, në mars të vitit 2015, Rezoluta e Parlamentit të BE-së për Procesin e Integritimit Evropian të Kosovës votoi me 64 vota kundër këtij izolimi, duke nxitur Komisionin e BE-së për t'i bërë përpjekjet më të mëdha për përshpejtimin e liberalizimit të vizave për Kosovën. Me një perspektivë të pasigurt lidhur me anëtarësimin në BE, si dhe me Kosovën si i vetmi vend pa liberalizim të vizave në rajon, qytetarët e Kosovës vazhdojnë të përballen me këtë izolim që i ka kontribuar migrimit masiv të parregullt të kosovarëve kohëve të fundit. Nga ana tjetër, përfituesit e vetëm nga ky izolim vazhdojnë të jenë kontrabandistët dhe grupet e organizuara kriminale të rajonit, si nga Kosova ashtu edhe nga Serbia (Instituti KIPRED, 2015)

3.10. Sa është kosto e emigrantëve që po e lëshojnë Kosovën dhe cila është mundësia e parandalimit të emigrimit?

Tash më aktualja në Kosovë është emigrimi ilegal për në shtetet e BE-së. Po u ule në ndonjë kafiteri në cilindo qytet të Kosovës, tema kryesore është si të gjendet rruga për në Perëndim. Rininë e Kosovës e ka kapluar një depresion dhe një zhgënjim që në Kosovë s'ka më perspektivë. Dhe, perspektiva e vetme janë rrugët ilegale për në vendet e BE-së. Struktura e popullsisë, e cila po emigron është, kryesisht, grupmosha 25-44, e që përbën 47.2% të popullsisë emigruese. Pra, dominon grupmosha 30-34 me 12.7% (ASK, 2014). Mirëpo, sa po i kushton Kosovës kjo dhe sa po u kushton personave që po dalin të kërkojnë një mirëqenie më të mirë?

Së pari, parashtrojmë pyetjen: Si ka mundësi që aq lehtë të kalohet kufiri për në vendet e BE-së, konkretisht nga Serbia për në Hungari, e më pas edhe deri në destinacionet tjera nëpërmjet Austrisë në Francë, në Gjermani a Zvicër? Përgjigja është: përfitimi financiar i kontrabandistëve nga vendet që po i organizojnë këto emigrime ilegale.

- Kosto financiare arrin afër 17 milionë euro

Duke iu referuar statistikave nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, numri i emigrantëve kosovarë gjatë vitit 2013 ishte gjithsej 20.246 (1 janar-31 dhjetor 2013). Ndërsa, sipas EUROSTAT-i janë rreth 20.000 azilkërkues nga Kosova. Kur i shtojmë fluksin e madh në gjashtëmujorin e fundit, mund të konkludojmë se numri është dyfishuar. E dimë që për të marrë rrugën ilegale për në vendet e BE-së nevojitet një shumë e konsiderueshme e parave. Sipas disa burimeve, për një person kosto për të arritur në një nga vendet e BE-së, mesatarisht, është rreth 700 euro. Nëse thirrëmi në statistikën zyrtare të EUROSTAT-it dhe ASK-së, del se Kosovës jo vetëm që i ka emigruar fuqia punëtore, por bashkë me ta edhe diku rreth 14 milionë euro ($20.000 \times 700\text{€}$). Nëse nga statistikën zyrtare i shtojmë dhe 20% të emigrantëve ilegalë, si numër të rritur në gjashtëmujorin e fundit, del se 24.000 emigrantë kanë emigruar dhe kosto arrin shumën prej 16,8 milionë euro ($24.000 \times 700\text{€}$). Pra, është një kalkulim i thjeshtë, duke mos i përfshirë investimet e tyre që kanë bërë në shkollimin e deritashëm.

Humbjet për Kosovën janë edhe më të mëdha nëse hyjmë në analiza më të thella. Dhe, po qe se e bashkojmë shumën prej 16.8 milionë euro nëpërmjet aksioneve a letrave me vlerë për ta shndërruar në investim, sa vende të reja të punës do të ishin hapur!

Burimi kryesor i financimit të emigrantëve ilegalë është nëpërmjet kredive personale në bankat e Kosovës ose të të afërmeve që kanë në Perëndim. Mirëpo, ka raste edhe kur personat shesin pasuri që ka vlerë. Kjo është edhe një barrë e madhe për Kosovën, duke rritur pasigurinë e kthimit të kredive. E, me pasigurinë e kthimit të kredive kemi edhe rritjen e kamatave.

3.10.1 Cila është mundësia për parandalimin e emigrantëve?

Sipas vlerësimeve të ASK-së, Kosova në vitin 2014 ka 1.811.372 banorë, ku popullsia në moshë pune[1] është 1.191.630. Nga fuqia punëtore[2] që konsiderohen persona aktivë, e që përbëhen nga mosha mesatare 15-64 vjeç, janë 483.193. Kurse, personat joaktivë[3] të moshës 15-64 vjeç janë 708.436. Nga fuqia punëtore janë të punësuar 338.364 të numrit të përgjithshëm, kurse të rinj 35.476 (Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2014). Ky është një tregues se shkalla e papunësisë në Kosovë është e lartë dhe duhet të krijohen modele dhe forma të reja për nxitjen e rritjes së punësimit, sidomos te të rinjtë.

Nga tabela shihet se shkalla e papunësisë në Kosovë është 30%, ndërsa shkalla e papunësisë te të rinjtë (15-24 vjeç) është edhe më e lartë - 55.9%.

Tabela 10. Indikatorët kryesorë të tregut të punës në %

	Meshkuj	Femra	Total
Shkalla e pjesëmarrjes në fuqi punëtore	60.2	21.1	40.5
Shkalla e jo aktivitetit	38.8	78.9	59.5
Raporti punësim ndaj popullsisë (shkalla e papunësisë)	44.0	12.9	28.4
Përqindja e punësimit të cënueshëm ndaj punësimit të përgjithshëm	25.0	18.9	23.6
Shkalla e papunësisë	26.9	38.4	30.0
Shkalla e punësimit te të rinjtë (15-24 vjeç)	50.4	68.4	55.9

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, Rezultatet e fuqisë punëtore në Kosovë, 2013.

Nëse thirremi në këto statistika, shohim se në Kosovë nuk ka ndonjë perspektivë të madhe, meqë papunësia është mjaft e lartë. Dhe, nëse shohim se emigrantët kosovarë, që dalin në disa vende të BE-së, si, për shembull, në Gjermani, marrin vetëm nga 370 euro në muaj, del se kjo është shumë e vogël për të mbijetuar.

Andaj, duhet që Qeveria e Kosovës të hartojë një strategji urgjente që të parandalojë emigrimin e kosovarëve, duke ruajtur resurset njerëzore, si një pasuri të madhe që ka Kosova dhe, gjithashtu, të krijojë mundësi vetëpunësimi.

3.10.2. Hartimi i një strategjie për parandalimin e migracionit nëpërmjet bujqësisë

Mundësia më e mirë për të dalë nga kjo gjendje e krijuar është zhvillimi i bujqësisë apo hartimi i një strategjie për parandalimin e migracionit nëpërmjet bujqësisë. Veçoria e Kosovës, si një vend me një pjesë të madhe të popullsisë së re, është edhe në sektorin e bujqësisë, ku brezi i moshës 15-29 vjeç përbën pjesën më të madhe të popullsisë bujqësore me 29 %. Ndërkaq, personat mbi 65 vjeç përbëjnë vetëm rreth 7% të popullsisë.

Shumica e pronave bujqësore (56%) kanë 5-8 anëtarë, që tregon se familjet bujqësore në Kosovë janë mjaft të mëdha. Mesatarja e ekonomive bujqësore është 7.3 anëtarë. Me potencialin që ka Kosova në sektorin e bujqësisë, mundet që me anë të subvencioneve në këtë sektor, të ketë shpresa për një jetë mesatare në vendin e tyre dhe të mos bredhin kampeve të Evropës për të marrë një “social” prej 370 eurosh. Sektori i bujqësisë ofron një zgjidhje të tillë, duke riaktivizuar tokat bujqësore, e të cilat nuk është duke i punuar askush. Po ashtu, nëpërmjet aplikimit të tatimit në pronë të klasifikohen pronarët e tokave, të cilët e punojnë tokën dhe ata të lirohen nga tatimi, ndërsa pronarët që nuk e punojnë tokën dhe e mbajnë shterpë t’u shtohet norma e tatimit, ashtu që t’i japin me qira ose t’i punojnë vetë. Kjo do t’i stimulonte fermerët dhe të gjithë ata që kanë tokë të punueshme, që të fillojnë ta punojnë dhe të krijojnë të ardhura mesatare për familjet e tyre.

3.11. Migrimi i brendshëm (kombëtar)

Bazuar në të dhënat e regjistrimit të popullsisë 2011, popullsia e Kosovës mund të përshkruhet si popullsi migruese. Të dhënat për migrimin, të mbledhura gjatë regjistrimit të popullsisë, kanë të bëjnë me ndryshimin e fundit të vendbanimit/komunës, kurdo që të ketë ndodhur ai. Nga numri i përgjithshëm, pra 1.739.825 persona të regjistruar në regjistrimin e popullsisë (prill 2011), prej tyre 517.992 persona apo rreth 30% e tyre kanë përjetuar, të paktën, një migrim. Një numër i tillë i migrimit (rreth 30%) paraqet një përvojë të madhe sa i përket përshtatjes ndaj kushteve të ndryshme jetësore dhe pasurim të kulturës së përgjithshme të një personi që mund të jetë pasuri për tërë vendin.

Tabela 11. Imigrimi ndërkombëtar/kombëtar në Kosovë

Gjinia/përqindja	Gjithsej	Imigran në Kosovë	Migrimi kombëtar(i brendshëm)	
			Migran nga një komunë në tjetrën	Migran brenda një komune në tjetrën
	517,992	128,808	196,429	192,755
Meshkuj	176,826	79,187	52,997	44,642
%	34,1	61,5	27,0	23,2
Femra	341,166	49,621	143,432	148,113
%	65,9	38,5	73,0	76,8

Burimi: ASK, Kosovë

Në këtë numër hyjnë vetëm personat që kanë migruar dhe jo anëtarët e tjerë të familjes që kishin lindur në vendbanimin e ri.

Për sqarim të shfrytëzuesve të të dhënave: një person i lindur në Gjilan, që ka emigruar (shpërngulur) për të jetuar në Prishtinë para 1, 5, 10, 20, 30 apo më shumë viteve, gjatë regjistrimit të popullsisë 2011 është llogaritur si popullsi rezidente në Prishtinë dhe jo në vendin e tij të lindjes (në këtë rast jo në Gjilan). Dhe, fëmijët e tyre të lindur në Prishtinë nuk ishin imigrantë, pasi ata nuk kishin imigruar nga asnjë vend, por si vendbanim të lindjes apo si vendbanim të zakonshëm rezident kishin Prishtinën. I linduri në Gjilan është migrant kombëtar, në këtë rast emigrant (i larguar) nga Gjilani dhe imigrant (i ardhur) në Prishtinë (Raporti i ASK, 2014)

Ky migrim në Kosovë ndikoi edhe në mbipopullimin e disa zonave urbane dhe të atyre ndër urbane dhe shpopullimin e zonave rurale, e kryesisht atyre kodrinore-malore. Të dhënat tregojnë se viteve të fundit kemi një rishpërndarje të re të popullsisë brenda në Kosovë dhe vetë komunave.

Faktorët e ndryshëm që u përmendën më lart (*shih: pse njerëzit migrojnë*) ndikuan në një lëvizje të tillë, përfshirë edhe mungesën e infrastrukturës bazë në vendbanimet rurale (*rrugët, kanalizimi, ujësjellësi*) për një kohë të gjatë, kurse viteve të fundit dukshëm janë përmirësuar kushtet e infrastrukturës.

Tabela 12. Arsyt kryesore të migrimit kombëtar (brenda dhe jashtë komunës së tyre) të shprehur në përqindje.

Arsyet e migrimit	Gjithsej
Punësimi	5.8
Arsimimi &qëllime trajnimi	2.8
Familjare	73.4
Lufta 1998-99	4.5
Të tjera	13.5

Burimi: ASK

Në pyetësonin e aplikuar gjatë regjistrimit të popullsisë ishin parashtruar 5 arsyt kryesore që kishin ndikuar te popullsia që të migrojë nga një vendbanim në një vendbanim tjetër. Përgjigjet ishin si në tabelën e mësipërme.

3.11.1 Faktorët që shtyjnë apo tërheqin (faktorët pull-push) lëvizjen e popullsisë nga njëri rajon i Kosovës në tjetrin, si dhe nga Kosova jashtë saj

Faktorët që i shtyjnë kosovarët të lëvizin nga një vend i Kosovës në tjetrin, janë që t'u ofrohen më shumë qendrave kryesore, sepse mundësia për punësim është më e madhe. Arsye tjetër është shkollimi më i lehtë i fëmijëve. Po ashtu, edhe aspekti mjekësor është faktor shtytës.

Gjithashtu, faktor tjetër është se një pjesë e popullsisë nuk dëshirojnë të merren me bujqësi, kurse e dëshirojnë jetën në qytet.

Një qasje tjetër e studimit është identifikimi i arsyeve për largimin nga Kosova (faktorët shtytës). Faktori më i rëndësishëm që ka nxitur emigracionin në vendka qenë faktori ekonomik, ku 72% u përgjigjën se vështirësitë ekonomike (p.sh., varfëria, problemet ekonomike, papunësia) ishin arsyeja e parë për largim. Mirëpo, duhet theksuar se faktor tjetër shtytës ishte edhe siguria në të ardhmen, që, d.m.th., edhe ata që janë duke punuar po migrojnë si shkak i pasigurisë. Pra, edhe ata që po punojnë në shkollë, në komunë e në biznese private, po ikin nga vendi, sepse shohin se për fëmijët e tyre këtu nuk ka ardhmëri. Me ndërrimin e pushtetit, edhe gjithçka rrënohet, andaj edhe mbesin pa punë. Faktorë të tjerë me rëndësi janë kushtet e këqija të jetesës në vend dhe mundësia për jetesë më të mirë në Evropën Perëndimore dhe në vendet e tjera.

Faktori ekonomik - Kosovarët largohen, kryesisht, për arsye ekonomike, siç janë: mungesa e mundësive për punësim, kushtet e vështira të jetesës, veçanërisht në disa zona ku mungojnë kushtet elementare, si, bie fjala, energjia elektrike, uji dhe strehimi. Niveli i lartë i papunësisë, si pasojë e reformave në ekonominë shqiptare pas rënies së komunizmit, ka qenë faktori kryesor për flukset masive të emigracionit pas viteve 90 e këtej.

- Faktorët shtytës

Mungesa e mundësive të punësimit në Kosovë, e gërshetuar me kërkesat e tregut të punës në vendet pritëse, për krah të lirë pune në fusha, si: ndërtimtari, bujqësi etj., është një faktor i madh nxitës për emigracionin e personave të pakualifikuar.

Nga ana tjetër, shumë shqiptarë të kualifikuar, pra me diplomë universitare, kanë emigruar si rezultat i mungesës së mundësive të përshtatshme të punësimit në Kosovë dhe janë punësuar jashtë vendit në vende pune larg kualifikimit të tyre.

Kosova është përballur me flukse masive emigracioni, si pasojë e nivelit të ulët të sigurisë publike apo të trazirave në vend. Një numër i madh i personave të kualifikuar, me kushte të mira ekonomike, janë larguar nga vendi për një të ardhme më të sigurt për veten dhe familjen e tyre. Kjo dukuri ka ndodhur, veçanërisht, pas vitit 2004, që u shoqërua me një valë të eksodit masiv. Institucionet e dobëta çojnë në mungesën e besimit te qytetarët për përmirësimin e situatës në vend, ku korrupsioni dhe krimi i organizuar paralizojnë funksionimin normal të institucioneve shtetërore. Institucionet e dobëta dhe vështirësitë në zbatimin e ligjit, gjithashtu, ndikojnë në përpjekjet dhe perspektivat e emigrantëve për t'u kthyer dhe vendosur në vend, veçanërisht kur ata hasin vështirësi në ndërtimin e aktiviteteve private apo në marrëdhënie me administratën shtetërore.

Ndër faktorët nxitës, e që përmenden gjerësisht në studime të ndryshme, janë:

- rritja e ulët ekonomike, e kombinuar me një pabarazi të dukshme në shpërndarje të të ardhurave;
- mbipopullimi;
- niveli i lartë i papunësisë;

- nepotizmi (lidhjet familjare në institucionet shtetërore).

Abuzimet me të drejtat e njeriut, diskriminimi dhe trajtimi çnjerëzor dhe degradues, persekutimi apo frika nga persekutimi për shkak të bindjes politike, fesë apo përkatësisë në një grup social, katastrofat natyrore dhe degradimi ekologjik, keqqeverisja.

Ndër faktorët tërheqës përmendën:

- siguria dhe zhvillimi ekonomik në vendin e destinacionit;
- mundësia e punësimit;
- mundësia për legalizim të dokumentacionit;
- mundësitë e integritit;
- distancat me vendin e destinacionit dhe ekzistenca e rrjeteve migruese.

Ndër shkaqet e lëvizjeve migruese të viteve të fundit, renditen: pagat më të larta, mbështetja financiare e familjes, kushte më të mira pune, kushte më të mira jetese, kushte më të mira arsimimi për vete apo për pjesëtarët e tjerë të familjes, si dhe, në periudha të caktuara, niveli i sigurisë dhe i rendit në vend. Ndërsa, përzgjedhja e vendit të destinacionit ka të bëjë me faktorët, si: lehtësia për të gjetur punë, afërsia gjeografike, lehtësia e hyrjes në vendin pritës, njohja me mundësitë për arsimim dhe përmirësimi i aftësive profesionale, mundësia për të punuar në profesionin e tyre dhe paga më të mira në krahasim me vendet e tjera.

3.12. Pasojat e migrimit

Do i cekim edhe pasojat e migrimit, ku edhe i kemi përkufizuar dy pasoja kryesore: Në vend të parë janë dëmet imediate e negative të ikjes masive; efektet e të cilave veçse mund të shihen.

Së pari, një largim enorm si ky, domosdoshmërisht do të prekë nivelin e kërkesës së brendshme në Kosovë; nëpërmjet prekjës së konsumit e investimeve. Rënia e konsumit në Kosovë do të ketë dy implikime imediate; fillimisht do të bien importet (meqë konsumi ynë në to bazohet), kurse më pas do të bien edhe të hyrat buxhetore, si rezultat i rënies së importeve dhe vetë kërkesës.

Rënia e konsumit, përveç të tjerash, do të përcillet edhe me rënie të investimeve të një zinxhir i tërë operuesish në Kosovë. Të theksojmë se një blerje, tek kushdo qoftë ajo, nxit një sërë sjelljesh ekonomike të agjentëve të ndryshëm; nga bukëpjekësi të bujku, nga bujku të mësuesi, nga mësuesi të punëdhënësi; të gjithë, pra, preken nga secila lëvizje regressive e konsumit. Së dyti, do të ketë lëvizje të shpejta në tregun e parasë; pra në kreditë bankare. Sërish, kjo për dy arsye. Fillimisht, sepse një pjesë e bankave tanimë veçse ballafaqohen me kredi të këqija, të individëve që kanë marrë kredi të vogla e që kanë ikur – një fenomen i shpërndarë gjithandej, sidomos në ditët e para të eksodit; e më pas, sepse në kohë të paqartësive shoqërore si këto, do të rritet risku i kredidhënies, rrjedhimisht do të rritet çmimi i parasë.

Së treti, do të ketë implikime të menjëhershme në tregun e banimit e qiradhënies; njërin ndër sektorët më ekspansiv të Kosovës. Sidomos, do të preken regjionet periferike të qyteteve të mëdha, të cilat do të kenë – në terma marginalë – shumë më të vështirë përballjen me një fluks të tillë ikësish masivë.

Së katërti, rastet e lëshimeve kolektive të Kosovës, nga individë e punëtorë madje, do të kenë pasojë për bizneset vendorë, të cilët do të duhet tash t'i zëvendësojnë të njëjtët me forcë të re punëtorë të paaftësuar, veçanërisht në sektorët e prodhimit. Kjo, natyrshëm, do të ndikojë në aftësinë konkurruese të tyre, ashtu-kështu të rëndë. Në terma afatgjatë, gjithmonë duke tjetërsuar moralitetin e pranimin e ikjes masive si normale. Dhe, mbi të gjitha, duke besuar se ikësit që do të akomodohen nëpër Evropë do gjejnë punë e krijojnë vlerë. Andaj, edhe efekti i ikjes do të jetë më i lehtë për Kosovën. Në fakt, në disa raste ai edhe mund të jetë pozitiv (gjithmonë përtej stabilitetit social që pakësimi krijon).

Për të ndodhur një gjë e tillë, natyrisht, largimi do të duhej të ishte selektiv, e jo e tërë familja, siç ishte rasti i një familjeje prej 113 anëtarësh! Pra, në rastet kur i gjithë nukleusi i familjes ikë, e s'mbetët kush pas, është e pamundur të ndërtohet ndonjë beneficion remittance nga krijimi i gjeneratës së re të diasporës. Por, në raste të tjera, kjo diasporë e re do të shërbejë për mirëmbajtjen e mbarëvajtjen e një vendi të tërë. Sepse, për aq kohë sa punojnë ata, do të krijohen të ardhura të reja, potenciale të reja e (në rastin më të mirë) edhe investime të reja. Normalisht, rastet e tilla do të duhej të trajtoheshin, në rend të parë, nëpërmjet programeve ndërqeveritare të punësimit; pra duke dërguar fuqinë tonë punëtorë në punë sezonale afatshkurtër.

Sidoqoftë, zbrazja mbetet tragjedi. Dhe, në gjithë këtë tragjedi arsyetimet ekonomike e sociale mbetin të zbehta. Por, për të ndalur këtë tragjedi, për të zëvendësuar eksodin me punë, vlerë e energji, duhet ta ndryshojmë gjithë paradigmen tonë ekonomike, sociale e politike. Paraprakisht duhet të ndryshojmë diçka...

KAPITULLI IV

POLITIKAT E PUNËSIMIT

Hyrje

Stabiliteti makroekonomik mund të themi se është kusht për një rritje ekonomike të qëndrueshme. Eksperienca e vendeve në tranzicion dëshmon për këtë. Në mungesë të stabilitetit të çmimeve dhe të politikave makroekonomike mbështetëse, investitorët do të jenë të rrezikuar të kryejnë investime afatgjata dhe kjo do të sjellë vështirësi në rritjen ekonomike. Stabiliteti makroekonomik është i nevojshëm, por jo një kusht i mjaftueshëm për rritjen ekonomike. Institucione të forta, të drejta, të pronësisë së përcaktuar saktë, një sistem gjyqësor efektiv, pa dyshim, janë të pashmangshme për një funksionim të mirë të sistemit të tregut.

4.1 Indikatorët makroekonomik të Kosovës

Nëse u referohemi koncepteve makroekonomike, ekonomiksi konsiderohet si një i tërë, ku përfshihen: bruto-produkti kombëtar, rritjet dhe rëniet e ciklit të prodhimit, inflacioni, papunësia, bilanci i pagesave etj.

Makroekonomia, si shkencë, merret edhe me përpunimin dhe hartimin e politikave të përshtatshme ekonomike, siç janë: politikat monetare-kreditore, politikat fiskale, politikat e të ardhurave, politikat e marrëdhënieve me jashtë etj. Politikat e tilla kanë për qëllim të përballen dhe t'i evitojnë dukuritë e tilla, si: papunësia, inflacioni, deficiti i bilancit të pagesave, rënia ekonomike etj. Pra, makroekonomia shpjegon *papunësinë dhe jep zgjidhje*, mënyra dhe rrugë për uljen e saj, shpjegon inflacionin dhe ofron zgjidhje se si të sigurohet stabiliteti i çmimeve, e, po ashtu, tregon si të arrihet rritja ekonomike, e që është faktori kryesor, i cili siguron rritje të punësimit dhe mirëqenie sa më të madhe për të gjithë.

Indikatorët kryesorë makroekonomikë janë:

1. GDP-ja,
2. Papunësia,

3. Inflacioni.

Këto janë tri çështje themelore me të cilat merret makroekonomia, e, së këndejmi, edhe kërkimi ynë. Synimi ynë është të japim përgjigje në këto pyetje:

1. Si shpjegohen periudhat e papunësisë së lartë dhe të qëndrueshme?
2. Kush e përcakton rritjen ekonomike?
3. Si ta shpjegojmë inflacionin?

Dihet se Kosova trashëgoi një ekonomi socialiste, që shquhej për një nivel të pazhvilluar të forcave prodhuese dhe joeficiente. Dhuna dhe apartheidi dhjetëvjeçarë (1989-1999), si dhe lufta e viteve 1998-99, e shkatërroi pjesën dërmuese të potencialit ekonomik që ishte akumuluar deri në atë kohë, edhe pse ishte i pakët.

Viti 1999 ishte fundi i këtyre zhvillimeve dramatike për Kosovën dhe fillimi i një epoke të re drejt demokratizimit, si dhe transformimit të ekonomisë nga një ekonomi e tipit centralist drejt një ekonomie të lirë të tregut.

Ky transformim ka të bëjë me krijimin e një shoqërie demokratike me sistem pluralist politik dhe me krijimin e ekonomisë të tregut me pluralizëm të pronës. Duke i pasur parasysh problemet ekonomike, shoqërore dhe politike, realizimi i këtyre synimeve ishte dhe vazhdon të jetë mjaft kompleks.

Siç theksuam edhe më sipër, bruto-produkti kombëtar është më i ulëti në rajon dhe sillet afër 2.000 euro për kokë banori, që është sa gjysma e vlerës mesatare të bruto-produktit kombëtar të vendeve të rajonit. Ndërkaq, rritja mesatare ekonomike gjatë viteve të fundit ishte afër 5%. Kjo rritje ekonomike, edhe pse në parim konsiderohet si një rritje e madhe ekonomike, kur merret parasysh niveli i ulët i zhvillimit të Kosovës, nuk mund t'i adresojë problemet kryesore ekonomike me të cilat ballafaqohet Kosova, si: papunësia, varfëria, niveli i ulët i zhvillimit të arsimit, kujdesi i pamjaftueshëm shëndetësor etj.

Zgjidhja e këtyre sfidave, me të cilat ballafaqohet ekonomia dhe shoqëria në Kosovë, kërkon një rritje mbi 7%. Ndërkaq, bazuar në trendin e zhvillimeve aktuale ekonomike, politikave dhe parashikimeve të qeverisë, një gjë e tillë është e paarrtshme. Pas vitit 1999, deri tani, Kosova ka

pasur një bilanc tregtar të tillë, ku raporti eksport-import është 95-5%, raport ky shumë i disfavorshëm për zhvillimin ekonomik.

Një nga problemet ekonomike dhe shoqërore esenciale pas vitit 1999 vazhdon të jetë papunësia. Megjithëse nuk ka statistika të qarta rreth normës së papunësisë, sipas shumë studimeve, qoftë të institucioneve vendore apo të atyre ndërkombëtare, papunësia në Kosovë është afër 40%.

Bruto-produkti kombëtar (GDP) është koncept kyç makroekonomik. “Bruto-produkti kombëtar (GDP) përfaqëson vlerën e të gjitha të mirave dhe shërbimeve përfundimtare të prodhuara në vend brenda një periudhe të dhënë”(Dornbusch, Rudiger & Fisher, Stanley 2003). Ky produkt përfshin vlerën e të mirave të prodhuara (shtëpitë, makineritë, ndërtesat etj.), si dhe vlerën e shërbimeve (udhëtimet, shërbimet e kontabilitetit, leksionet ekonomike etj.)

Si indikator kryesor makroekonomik, i cili tregon dhe përcakton zhvillimin ekonomik të një vendi, GDP, historikisht, ka qenë i ulët në Kosovë. Ndërkaq, periudha e aparteidit 1989-1999, si dhe lufta, i shkatërroi edhe ato potenciale ekonomike të cilat i kishte Kosova.

Bruto-produkti kombëtar në Kosovë sillet afër 2.000 euro, me një rritje mesatare ekonomike në vitet e fundit prej afër 5%.

Tabela 13. Bruto-produkti vendor 2004-2009.

BPV me çmime aktuale	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Shpenzimet e konsumit final	3212.7	336.7	3466.2	3810.6	3344.6	4279.99
Shpenzimet e konsumit final të ekonomive shtëpiake	2487.6	2638.4	2770.8	3145.9	3646.7	3584.3
Shpenzimet e konsumit final të qeverisë	701.5	705.5	670.6	641.6	674.4	670.5
Qeveria e Kosovës	355.5	329.2	340.8	327.3	372.6	409.7
Donatorët	346.0	376.3	329.8	314.3	301.8	260.8

Të punësuarit e huaj	247.8	258.4	213.8	169.9	196.9	178.7
Të punësuarit vendorë	98.2	117.9	116.6	117.4	104.9	82.1
Shpenzimet e konsumit	23.5	23.7	24.8	23.1	23.6	25.0

Final IJPESHESH

Formimi bruto i kapitalit	701.2	722.2	798.3	892.5	1093.9	116.5
Formimi bruto i kapitalit fiks	583.6	592.8	657.1	744.7	937.9	1026.5
Ndryshimet në inventar	117.7	129.4	141.2	48.3	156.0	140.0
Eksporti neto	-1,001.4	-1,086.9	-1,144.1	-1,309.4	- 1,587.1	- 1534.1
Eksporti i mallrave dhe i shërbimeve	310.6	332.8	441.4	512.2	569.0	611.8
Eksporti i mallrave	63.8	67.8	112.5	177.2	217.5	177.2
Eksporti i shërbimeve	246.8	265.0	319.0	335.0	351.6	334.6
Importi i mallrave dhe i shërbimeve	1312.0	1419.7	1585.5	1281.7	2156.1	2145.8
Importi i mallrave	1046.9	1146.3	1295.6	1545.2	1885.7	1850.6
Importi i shërbimeve	265.1	273.3	289.9	276.5	270.5	295.1
Popullsia	2041	2070	2100	2130	2153	2180
BPV për kokë banori	1427	2451	1486	1593	1789	1799

Burimi: MEF, 2009

Me inflacion kuptojmë rritjen e përgjithshme të nivelit të çmimeve.

$$\text{Norma e inflacionit } (t) = \frac{\text{niveli i çmimeve } (t) - \text{niveli i çmimeve } (t-1)}{\text{niveli i çmimeve } (t-1)}$$

Inflacioni përbën një ndër sëmundjet më të rënda makroekonomike dhe konsiderohet si një problem shqetësues për ekonominë, në tërësi, dhe për firmat e konsumatorët, në veçanti. Për këtë arsye çdo qeveri problemin e inflacionit e konsideron si një ndër politikatat kryesore stabilizuese makroekonomike (S. Qirici, S. Hadëri, Dh. Kule, A. Manqellari, 2000) Pas luftës së vitit 1999 Kosova adaptoi si valutë të saj në përdorim markën gjermane, ndërsa pas hyrjes në fuqi të euros, si valutë unike në eurozonë, Kosova prapë e adaptoi euron si valutë të saj zyrtare në përdorim. Kosova është një ekonomi e euroizuar. Ky fakt e ka ndihmuar mjaft për të siguruar një stabilitet financiar dhe makroekonomik, në përgjithësi. Që nga paslufta e vitit 1999, në pjesën dërmuese të kohës, ka pasur inflacion, por ai ka qenë i moderuar.

Tabela 14. Norma e inflacionit BQK 2003-2009

VITI	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Norma	1.3%	-1.1%	-1.3%	0.6%	4.6%	9.4%	-2.4%

Burimi BQK

Siç shihet nga tabela, Kosova në vitin 2003 ka pasur inflacion të lehtë prej 1.3%, i pasuar me deflacion në dy vitet pasuese, konkretisht në vitet 2004 dhe 2005 me -1.1%, përkatësisht -1.3%. Në vitin 2006 prapë shfaqet inflacioni jashtëzakonisht i moderuar prej 0.6%, për t'u ngritur në 4.3% në vitin 2007. Ndërkaq, viti 2008 ishte një vit specifik sa i takon inflacionit. Ky vit u shoqërua me një inflacion mjaft të lartë prej 9.4%. Një shkallë kaq e lartë e inflacionit ishte rrjedhojë e krizës botërore të ushqimeve.

Një ekonomi e mbështetur në treg nënkupton, përveç të tjerash, një lidhje të ngushtë ekonomike ndërmjet ekonomive të vendeve të ndryshme. Këto lidhje realizohen nëpërmjet kanaleve tregtare dhe financiare. Ekzistojnë disa arsye që tregojnë pse ekzistojnë marrëdhënie tregtare ndërmjet dy vendeve. Disa nga arsyet e tilla janë:

1. Kushtet e ndryshme të prodhimit,

2. Ekonomizimet e shkallës,

3. Ndryshimet në shije etj.

Bilanci tregtar është një koncept kyç i përgjithshëm, i cili shpreh totalin e të gjitha transaksioneve tregtare të një vendi me të gjitha vendet e tjera. Në Kosovë bilanci tregtar është tejet negativ, prandaj paraqet një nga problemet kryesore me të cilat përballlet ekonomia e vendit. Këtë mund ta shohim më së miri nëpërmjet disa të dhënave që do i paraqesim në vazhdim...

Tabela 15. Bilanci tregtar në Kosovë

Viti	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Eksporti neto	-1,001.4	-1,086.9	-1,1441.1	-1,309.4	-1,587.1	-1,534.0
Eksporti i mallrave dhe shërbimeve	310.6	332.8	441.4	512.2	569.0	611.8
Eksporti i mallrave	63.8	67.8	112.5	177.2	217.5	177.2
Eksporti i shërbimeve	246.8	265.0	319.0	335.0	351.6	334.6
Importi i mallrave dhe shërbimeve	1312.0	1419.7	1585.5	1281.7	2156.1	2145.8
Importi i mallrave	1046.9	1146.3	1295.6	1545.2	1885.7	1850.6
Importi i shërbimeve	265.1	273.1	289.9	276.5	270.5	295.1

Burimi: MEF, 2009

Siç shihet nga tabela e mësipërme, deficitit tregtar i Kosovës është jashtëzakonisht i lartë. Në vitin 2002 Kosova importoi 1 miliard e 312 milionë euro, ndërsa eksportoi ishte vetëm 310 milionë euro. Nga ky raport tejet disbalancues ndërmjet importit dhe eksportit rezultoi me një deficit tregtar prej 1 miliard e 1.4 milionë euro.

Një deficit i tillë tregtar kaq i lartë vazhdoi të mbetet edhe në vitet pasuese. Ai, vazhdimisht, mbeti mbi 1 miliard euro. Por, kulmin e arriti në vitin 2008 me 1 miliard e 587.1 milionë euro, kurse në vitin 2009 pat një rënie të lehtë në 1 miliard e 534 milionë euro.

4.2. Politikat për rritjen e punësimit në Kosovë

Punësimi, në përgjithësi, është një sfidë mjaft komplekse. Rritja e punësimit është çështje multisektoriale, që përfshin politika makroekonomike, funksionimin e shtetit ligjor, politika arsimore dhe politika sociale. Këto politika janë të domosdoshme për krijimin e një terreni të përshtatshëm për investime, e si rrjedhojë e kësaj për rritjen e punësimit.

Papunësia konsiderohet si sëmundja më e madhe ekonomike dhe sociale. Në rast të shfaqjes të saj, institucionet e një vendi fokusohen në hartimin e politikave dhe marrjen e masave konkrete që do ndikonin në rritjen e punësimit. Kjo është një ndër sfidat kryesore me të cilën përballen pothuajse të gjitha shtetet, e sidomos ato që janë në tranzicion. Në këto shtete dizajnimi i politikave të tilla është një ndër qëllimet kryesore. Për më tepër, ato u bënë të nevojshme me qëllim të sigurimit të një përkrahjeje nga punëtorët dhe masa e gjerë për procesin e ristrukturimit të ish-ndërmarrjeve shoqërore-shtetërore.

Megjithatë, nuk kishte një politikë të qartë që do të mund të zbatohet pa pasur efekte anësore negative. Qeveritë e këtyre vendeve do të duhej të gjenin një balans ndërmjet reduktimit të intervenimit të shtetit në ekonomi, të trashëguar nga sistemi i mëparshëm, dhe lejimit të veprimit të lirive të tregut e formimin e politikave sociale, që do t'u siguronte përkrahje për procesin e tranzicionit (Hoti, Avdullah., 2008). Duke pasur parasysh faktin se papunësia në Kosovë është mjaft e madhe, punësimi mbetet, pikërisht, një ndër sfidat më të mëdha për institucionet dhe shoqërinë kosovare.

- Kjo papunësi, kaq e lartë, shtrihet si detyrë parësore para institucioneve të Kosovës krijimin e politikave ekonomike favorizuese për investime, politika këto që do të ndikonin në rritjen e bruto-produktit kombëtar dhe rrjedhimisht në zvogëlimin e normës së papunësisë.

Siç theksuam edhe më lart, politikat dhe masat për rritjen e punësimit janë komplekse dhe multisektoriale, ashtu siç është komplekse dhe multisektoriale edhe çështja e punësimit.

Politikat që ndikojnë në rritjen e punësimit mund të jenë:

- Politikat fiskale, që duhet të jenë politika favorizuese për investime, si të brendshme ashtu edhe të jashtme;
- Politikat monetare-kreditore, që duhet të jenë të dizajnuara, në atë mënyrë që bizneset të furnizohen me para me kushte të volitshme;
- Politikat tregtare, që duhet të favorizojnë zhvillimin e biznesit;
- Politikat arsimore, të cilat duhet të dizajnohen, në atë mënyrë që të ndikojnë në ngritjen e një sistemi arsimor që do u përgjigjej nevojave të tregut të punës;
- Politikat e tregut të punës, të cilat duhet të krijojnë kushte të favorshme për tregun e punës etj.

4.2.1 Politikat fiskale të Kosovës

Politikat fiskale kanë të bëjnë me përdorimin e shpenzimeve qeveritare dhe politikat e tatimeve. Qëllimi i këtyre politikave është menaxhimi i kërkesës agregate për të mbajtur rritje të qëndrueshme ekonomike me punësim relativisht të lartë, pa gjenerim të inflacionit, pa rritje të borxhit publik dhe me bilanc të kënaqshëm të pagesave.

Qëllimet e politikave fiskale ndahen në tri kategori: alokative, shpërndarëse dhe stabilizuese (S, Hadëri., Qiric, S., Kul, Dh., Manqellari, A., 2000) Qëllimet alokative kanë të bëjnë me ndikimin e politikave buxhetore të qeverisë në alokimin e resurseve të shoqërisë. Qeveria ofron të mira publike, rregullon eksternalitetet dhe mund të ndikojë në shpenzimet private, nëpërmjet inkurajimeve që përmban sistemi tatimor. Qëllimet shpërndarëse kanë të bëjnë me ndikimin e politikave buxhetore në shpërndarjen e të ardhurave të shoqërisë. Politikat qeveritare kanë ndikime të ndryshme ndërmjet grupeve të ndryshme të popullsisë. Qëllimet stabilizuese kanë të bëjnë me ndikimin e qeverisë mbi inflacionin, papunësinë dhe rritjen ekonomike.

Buxheti qeveritar i pasqyron shpenzimet dhe të ardhurat e parashikuara brenda një periudhe njëvjeçare. Shteti i realizon të ardhurat nga taksat dhe tatimet, por edhe nga kreditë, ndërsa këto të hyra i shfrytëzon për financimin e arsimit, shëndetësisë, mbrojtjes, ngritjes së infrastrukturës

etj. Në Kosovë sistemi fiskal filloi të ndërtohet pas vitit 1999, me themelimin e Administratës Tatimore dhe Shërbimit Doganor.

Politikat fiskale paslufte kanë qenë më shumë të orientuara në mbushjen e buxhetit sesa në përcaktimin dhe zbatimin e instrumenteve të saj, që do të ishin në funksion të biznesit kosovar, posaçërisht të atij prodhues, si dhe në nxitjen e investimeve të huaja, shumë të nevojshme dhe të domosdoshme për zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Së këndejmi, politikat fiskale kishin disa të meta. Ato nuk ishin gjithëpërfshirëse, d.m.th., nuk u përfshinë të gjitha format dhe instrumentet në këtë fushë. Disa instrumente ishin kundër produktive, siç ishin doganat, të cilat, në disa raste, kishin edhe efekte negative për prodhuesit vendorë, sepse qëllimi i tyre kryesor ishte të krijojnë të hyra buxhetore. Prandaj, të gjitha këto veprime biznesin vendor e vunë në pozitë inferiore me prodhimet e importuara. (Limani, Musa., 2006). Politikat fiskale të Kosovës paslufte kanë ndryshuar në disa drejtime. Me rregulloren e UNMIK-ut 2004/13 përcaktohen:

- a) reduktimi i tarifave doganore për lëndë të parë për agro-biznes dhe disa sektorë të tjerë prodhues nga 10% në 0%;
- b) reduktimi i tarifave doganore për të mirat kapitale nga 10% në 0%;
- c) reduktimi i tarifave doganore të substancave të ndërmjetme për përpunim të mëtejshëm nga 10% në 0%.

Ndryshimet tatimore vazhduan edhe më tutje. Me rregulloren e UNMIKU-ut 2007/12 përcaktohen përjashtime nga tarifat doganore për disa lëndë të para të domosdoshme për procesin e prodhimit. Sipas Rregullores 2007/1 asnjë tarifë doganore nuk kërkohet për lëndë djegëse dhe produkte të lëndëve djegëse të destinuara për aktivitetet e prodhimit. Ndërkaq, sipas Rregullores së UNMIK-ut 2007/31, nuk kërkohen taksa doganore për importin e grurit dhe të misrit. Por, reformat tatimore të vitit 2009 sjellin reduktime në tatimin në fitim nga 20% në 10%, reduktime në të ardhurat personale, mirëpo sjellin një ngritje të lehtë të TVSH-së nga 15% në 16%. Reformat që u ndërmorën gjatë viteve të kaluara ishin disa hapa të rëndësishëm për bërjen e politikës tatimore më të favorshme për biznesin dhe investimet vendore, por edhe të huaja.

Megjithatë, mbetet ende shumë punë për t'u bërë, që të krijohen politika fiskale edhe më të favorshme, e të cilat do të ishin një mbështetje e madhe për zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Politikat e tilla në Kosovë duhet të ndryshojnë, si në kompozicionin e të hyrave, ashtu edhe të shpenzimeve, ashtu që kërkesa agregate të menaxhohet në mënyrë më efektive dhe të realizohet punësim më i lartë pa gjenerim të inflacionit .

4.2.2 Politika monetare-kreditore e Kosovës

Politikat monetare-kreditore luajnë një rol të rëndësishëm në kuadër të politikave makroekonomike. Këto politika janë tërësia e të gjitha rregullave, dispozitave, masave dhe instrumenteve, të cilat, në sferën monetare-kreditore të riprodhimit kombëtar, i ndërmerr shteti për rregullimin e nivelit strukturor dhe të dinamikës së masës monetare me të cilat rregullon qarkullimin monetar, nivelin strukturor dhe dinamikën e kredisë, likuiditetin e ekonomisë, me qëllim të ruajtjes dinamike të ekuilibrit monetar dhe të stabilitetit ekonomik (Komoni, Sabahudin., 1976).

Me fjalë të tjetra, nëpërmjet politikave monetare-kreditore, si instrumente të politikës ekonomike, shteti angazhohet për arritjen e qëllimeve të ekonomisë kombëtare.

Disa nga synimet parësore të politikës monetare-kreditore janë:

- Rritja ekonomike;
- Rritja e punësimit;
- Ruajtja e stabilitetit të çmimeve;
- Ekuilibri i bilancit të pagesave etj.

Sistemi monetar-kreditor në Kosovë pësoi një shkatërrim të madh gjatë viteve 90, ndërkaq filloi të rilindë vetëm pas vitit 1999. Kjo kohë konsiderohet si fillimi i ngritjes së një sistemi financiar modern, i cili do të jetë boshti kurrizor i ekonomisë së lirë të tregut, të cilin Kosova pretendon ta ndërtojë. Me gjithë dobësitë e shumta, sistemi financiar i Kosovës ka arritur rezultate të konsiderueshme. Fillimisht u formua Autoriteti Qendror Bankar dhe i Pagesave, ndërsa pas

Pavarësisë së Kosovës, në shkurt të vitit 2008, ky autoritet u transformua në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Aktualisht, në Kosovë veprojnë 7 banka komerciale dhe disa institucione mikrofinanciare. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës i kryen të gjitha funksionet e Bankës Qendrore, përveç emetimit të parasë.

Meqenëse Kosova është pjesë e Eurozonës, funksioni i emetimit të parasë është kompetencë ekskluzive e Bankës Qendrore Evropiane. Sistemi financiar, që nga themelimi i tij e deri më sot, ka realizuar rritje të vazhdueshme. Ky sistem ka arritur vlerën e aseteve 2.8 miliardë euro. Shumicën e vlerës së këtyre aseteve e përbën sektori bankar me 2.2 miliardë euro.

Tabela 16. Struktura e aseteve të sektorit bankar (në milion)

Përshkrimi	2007	2008	2009
Paraja e gatshme dhe bilanci në BQK	189.0	218.2	322.7
Bilanci në bankat komerciale	208.1	283.9	405.6
Letrat me vlerë	78.9	40.5	97.0
Kreditë dhe lezingu	892.1	1183.4	1289
Asetet fikse	27.2	39.0	43.1
Asetet tjera	39.7	43.1	46.7
Gjithsej	1.435	1808	2204

Burimi: BQK

Sistemi bankar i Kosovës me 2.2 miliardë euro asete, ka performuar vazhdimisht me bilanc pozitiv të suksesit.

Tabela 17. Bilanci i suksesit i sistemit bankar (në milion)

Përshkrimi	2007	2008	2009
Të hyrat			
Të hyrat nga interesi	117.9	155.7	163.2
Të hyrat nga jo interesi	39.5	39.3	38.2
Gjithsej të hyrat	157.4	195.0	201.4

Shpenzimet			
Shpenzimet e interesit	26.0	37.3	51.6
Shpenzimet e tjera, përveç interesit	19.9	21.9	32.6
Shpenzimet e përgjithshme administrative	69.7	86.0	87.0
Gjithsej shpenzimet	115.6	145.2	171.3
Të hyrat neto			
Të hyrat operuese neto	41.7	49.0	29.6
Të hyrat para tatimit	41.3	47.6	28.9
Provizionet për tatim	7.9	11.2	3.6
Neto fitimi brenda periudhës	33.5	36.4	25.3

Burimi: BQK

Sistemi bankar, përkundër këtyre sukseseve, i ka edhe dobësitë e veta. Politika monetare-kreditore nuk është një politikë adekuate për rritjen e investimeve, rritjen e punësimit dhe të zhvillimit të gjithëmbarshtëm ekonomik të Kosovës. Çmimi i kredisë është shumë i lartë, i cili vjen si rezultat i ofertës së ulët kreditore, e, në anën tjetër, i nevojës së madhe për investime që ka Kosova.

Një fenomen absurd ekziston në aspektin e menaxhimit të mjeteve monetare, në shumë të madhe, të akumuluar nga Trusti Pensional i Kosovës, Fondi i Privatizimit, si dhe një pjesë e mjeteve të PTK-së, që, së bashku, arrijnë vlerën mbi 1 miliard euro. Duke pasur parasysh nevojën e madhe që ka Kosova për mjete financiare, në një anë, dhe pamjaftueshmërinë në treg, në anën tjetër, eksportimi i kapitalit financiar dhe mos qarkullimi i tyre në bankat e Kosovës është një absurditet i madh logjik. Kthimi i këtyre mjeteve, si dhe akumulimi i mjeteve të tjera nga aparati bankar, është një parakusht për një politikë intensive investimore, e cila do të ishte faktori kryesor për rritjen e punësimit.

4.2.3 Politikat tregtare të Kosovës

Politikat tregtare janë ndër politikat më të rëndësishme ekonomike me anë të së cilave shteti (qeveria) përpiqet t'i arrijë synimet e veta, si: rritjen ekonomike, rritjen e punësimit etj.

Zhvillimi ekonomik botëror dhe i ekonomisë së vendeve të veçanta dëshmon për thellimin e ndërvarësisë ekonomike e financiare ndërmjet vendeve të ndryshme. Një pjesë e madhe e mallrave dhe e shërbimeve të prodhuara në vende të veçanta këmbehen në tregjet ndërkombëtare (Manqellari, Ahmet., 2013) Këto zhvillime të ekonomisë botërore, të cilat kanë qar drejt marrëdhënieve shumë të intensifikuara ekonomike, kanë bërë të paevitueshme dhe shumë të nevojshme aplikimin e politikave tregtare nga të gjitha shtetet. Këto politika i zbaton shteti (qeveria), e cila përdor mjete tarifore, si dhe jo tarifore me anë të së cilave kufizon apo stimulon eksportin dhe importin. Nëpërmjet këtyre mjeteve shteti synon të arrijë qëllime të caktuara.

Ata mund të jenë të llojeve të ndryshme, si:

- Tatime ose subvencione:
 - mbi importet (tarifat, rastet e veçanta-taksat kundërvepruese, taksat antidamping);
 - mbi eksportet (dampingu, si formë e subvencionimit të eksportit).
- Kufizime sasiore:
 - kuotimi i importit (embargo e eksportit, kufizimi i blerjeve qeveritare nga të huajt);
 - kuotimi i eksportit (embargo e eksportit, monopoli shtetëror i eksportit).
- Politika të tjera:
 - kufizime teknike e administrative;
 - asistencë përshtatëse ndaj të dëmtuarve nga konkurrenca e huaj;
 - politika valutore, që ka efekte të njëjta me pagesat nga subvencionet tregtare.

Këto mjete të politikës tregtare kanë ndikim shumë të madh në zhvillimet e rëndësishme ekonomike. Mjetet e politikave tregtare kanë një rëndësi të veçantë për Kosovën. Në analizat ekonomike, përveç treguesve të tjerë, për të shprehur nivelin e zhvillimit ekonomik të një vendi, merren edhe transaksionet ekonomike. Sikurse edhe treguesit e tjerë makroekonomikë, po ashtu, edhe këmbimi ndërkombëtar, shpreh nivelin e zhvillimit të forcave prodhuese të vendit përkatës, i cili shprehet nëpërmjet vlerës dhe strukturës së mallrave të importuara dhe të eksportuara.

Këmbimet ekonomike me botën për ekonominë e Kosovës ishin dhe mbetën të pavoritshme. Niveli i ulët i zhvillimit ekonomik të Kosovës në periudhën e pasluftës, ndikoi që në marrëdhëniet ekonomike të dominojë importi i mallrave dhe i shërbimeve, i cili është dukshëm më i madh se eksporti. E tërë kjo u reflektua në deficitin e madh të bilancit të pagesave (Limani, Musa., 2006).

Prandaj, ky deficit i madh tregtar, paraqet një nga problemet kryesore, me të cilat ballafaqohet ekonomia kosovare. Importi i mallrave dhe i shërbimeve përbën 50% të bruto-produktit kombëtar që realizon Kosova. Deficiti tregtar i Kosovës, në vazhdimësi, ishte shumë i lartë, madje ka ardhur duke u rritur. Kosova ka një politikë tregtare liberale. Kjo ka qenë rezultat i ndërmarrjes së inicuar nga Pakti i Stabilizimit për Liberalizimin e Tregtisë. Marrëveshjen e parë për tregti të lirë Kosova e ka nënshkruar me Shqipërinë, pastaj me Maqedoninë, Bosnjë e Hercegovinën dhe me Kroacinë. Në vitin 2006 Kosova nënshkroi marrëveshjen e CEFTA-s për tregti të lirë edhe me vendet e Evropës Juglindore.

CEFTA ka për qëllim krijimin e rregullave dhe të mekanizmave me anë të të cilave qeveriset tregtia e jashtme në rajon. Këto rregulla kanë qenë të harmonizuara me principet e BE-së dhe të OBT-së. Përvoja e fituar tregtare me vendet e rajonit do t'i bëjë produktet e Kosovës konkurruese për tregun e BE-së dhe më gjerë. Gjithashtu, Kosova në këtë proces do t'i formojë institucionet dhe politikat që janë në përputhje me kërkesat e OBT-së. Një tjetër qëllim i CEFTA-së është edhe krijimi i një tregu tërheqës rajonal, i cili do të krijojë mundësi të reja për bizneset e vendeve apo investitorët e huaj. Por, duhet theksuar faktin se marrëveshjet për tregti të lirë, si dhe liberalizimi i tregtisë si i tillë, nuk mjafton për t'u zhvilluar ekonomia e Kosovës.

Orientimet e Ministrisë së Tregtisë dhe të Industrisë, lidhur me formulimin e politikave tregtare, duhet të kenë disa pikësnyime:

- Politikat tregtare duhet të formulohen, zbatohen dhe të vlerësohen në mënyrë të tillë që do t'i jepnin më tepër përparësi zhvillimit sesa vetë rezultateve të tregtisë ndërkombëtare. Kjo do të thotë se reduktimet tarifore dhe jotarifore duhet të menaxhohen nëpërmjet seleksionimit sektorial.
- Politikat tregtare, por edhe politikat zhvillimore që kanë të bëjnë me tregtinë, duhet të kuptohen dhe të menaxhohen mirë, në mënyrë që përfitimet nga liberalizimi i tregtisë të jenë më të larta dhe më të qëndrueshme. Zgjerimi i konkurrencës është i një rëndësie të madhe për promovimin e eksportit. Por, politikat që e përmirësojnë konkurrueshmërinë nuk janë politikat tregtare, por politikat e lidhura me tregtinë. E, dihet se tregtia është një koncept i ndërlidhur që ndikon pothuajse në të gjitha fushat ekonomike dhe sociale. Prandaj, ekziston një nevojë urgjente institucionale për sforcimin e bashkëpunimit dhe të koherencës ndërmjet të gjithë akterëve relevantë, që e formojnë sistemin e tregtisë në Kosovë.
- Politikat tregtare të Kosovës duhet të jenë të harmonizuara me politikat e tjera ekonomike dhe me politikat zhvillimore, në mënyrë që të jenë të suksesshme në realizimin e objektivave zhvillimore të Kosovës.
- Marrëveshjet tregtare, anëtarësimi i Kosovës në OBT dhe në institucionet e tjera ekonomike ndërkombëtare, i japin Kosovës mundësinë e qasjes në tregjet e vendeve të tjera. Qasja në tregjet ndërkombëtare ka ndikim të rëndësishëm në bilancin tregtar, në rritjen ekonomike, si dhe në rritjen e punësimit.

Për këtë arsye, është e rëndësishme që të krijohet një skemë, e cila do t'u shërbente qëllimeve të përgjithshme zhvillimore të Kosovës.

Dimensioni i qasjes në treg duhet të shqyrtohet nga këndvështrimi i të qasurit në tregjet e vendeve të tjera. Duhet të gjenerohet një skenë e tarifave tarifore dhe jotarifore që do t'i jepnin Kosovës përfitimet në të mira nga perspektiva e zhvillimit human. Kjo do të përfshinte atë se çfarë mund të kërkojë Kosova nga vendet e tjera dhe cilat kategori të mallrave dhe të shërbimeve.

Ndikimi i reduktimit të tarifave në fushat që janë të rëndësishme për diversifikimin industrial dhe bujqësor të Kosovës, si dhe realizimi i potencialit të saj konkurrues, duhet të shqyrtohen thellësisht. Pjesë e kësaj duhet të jetë, gjithashtu, edhe ndikimi ndërsektorial. Mundësitë për t'i shfrytëzuar produktet e Kosovës me përparësitë më të mëdha krahasuese, si mjet negociimi, po ashtu, duhet të analizohen në mënyrë shumë rigoroze.

Pjesë të studimit duhet të jenë edhe sistemet e tarifave preferenciale, si dhe alternativat e një sistemi të thjeshtë të tarifave. Pamëdyshje, Kosova e ka problematikën e rregullativës ligjore dhe institucionale për t'u inkuadruar në ekonominë botërore. Por, është mjaft e qartë rruga të cilën ajo dëshiron ta ndjekë. Është rruga e integritit në ekonominë botërore dhe kurrësi rruga protoksioniste. Kjo nënkupton që ajo, rrjedhimisht, është e interesuar për liberalizimin e tregtisë. Por, liberalizimi duhet të jetë në sinkroni me politikat zhvillimore, në mënyrë që t'i kontribuojë zhvillimit ekonomik të Kosovës.

4.2.4 Politikat e tregut të punës në Kosovë

Puna, së bashku me tokën dhe kapitalin, përbëjnë tre faktorët themelorë të prodhimit. “Puna është tërësia e aftësive fizike e mendore që zotëron njeriu, është një shërbim i pandashëm nga personi apo individ që e ofron atë në tregun e punës. Në kushtet kur individ e ofron punën e tij dhe kur firma e blenë, vendosën disa lidhje personale të veçanta. Në këtë rast, ajo që e përmban objektin e këmbimit në tregun e punës - **puna** është trupëzuar e personifikuar te qeniet njerëzore. Pra, nuk ka ekzistencë të pavarur fizikisht nga individ, e cila mund të ofrohej në tregjet e shkëputura prej tij” (Qirici, Stefan., 2005).

Tregu i punës nuk është një treg unik, si tregu i mallrave ku shiten dhe blihen mallra. Ai është një hapësirë në të cilën ka blerës dhe shitës në masë të mjaftueshme në komunikim e sipër. Çmimet e punës synohen të njëjta në kuadrin e tërë territorit. Në këtë mënyrë, treva mund të dallojë sipas marrëdhënieve - nga hapësira e vogël e deri në përmasat botërore, respektivisht të botës në tërësi.

Ky treg rregullohet nëpërmjet institucioneve të tregut të punës dhe kuadrit ligjor. Institucionet shtetërore përpilojnë “politikat e tregut të punës”.

Politikat e tregut të punës konsistojnë në:

1. Kuadrin ligjor të tregut të punës;
2. Kombinimin e beneficioneve për papunësinë, të beneficioneve sociale dhe pagave minimale;
3. Politikat aktive të tregut të punës (ALMP).

Kosova, si vend në tranzicion dhe me nivel të ulët të zhvillimit ekonomik, papunësinë e ka problem ekonomik dhe social më të rëndësishmin. Prandaj, krijimi dhe forcimi i institucioneve dhe politikave të tregut të punës paraqet një nevojë imediate.

Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale e Republikës së Kosovës është ndër akterët kryesorë për përpilimin dhe implementimin e politikave të tregut të punës. MPMS-ja, që nga themelimi i institucioneve të Kosovës, pas vitit 1999 është në proces të themelimit dhe të konsolidimit të politikave të tregut të punës dhe institucioneve që merren me implementimin e këtyre politikave. Një nga aspektet e politikave të tregut të punës është edhe aspekti ligjor. “E drejta e punës është në raport të drejtpërdrejtë me të drejtën kushtetuese. Kushtetuta, si instrumenti apo akti juridik më i lartë, përmban parimet dhe normat e përgjithshme mbi rregullimin e sistemit ekonomiko-shoqëror të një vendi. Me kushtetutë vihen parimet nga fusha e marrëdhënieve të punës dhe ato, zakonisht, janë bazë për legjislacionin e punës, si dhe për rregullativën nënligjore dhe atë autonome. Me dispozita kushtetuese, zakonisht, institucionalizohen këto parime: e drejta për punë, liria e punës, liria sindikale, barazia e personave në marrëdhëniet e punës, e drejta në sigurim social etj. (Ismaili, Hava., 2010)

E drejta e punës, përveç me dispozita kushtetuese, specifikohet edhe me akte ligjore dhe nënligjore, siç janë: ligji i punës, ligji për sigurim social etj.

Në Kosovë, e drejta, përkatësisht e drejta e punës, është e rregulluar parimisht edhe me Kushtetutë, por edhe me ligjin e punës, i cili hyri në fuqi në vitin 2010. Para hyrjes në fuqi të këtij ligji tregu i punës ishte i rregulluar me rregulloren e UNMIK-ut 2001/27.

Ligji themelor i punës, 03/L-212, rregullon të drejtat dhe marrëdhëniet e punës. Ky ligj është i obligueshëm për punëtorët dhe punëdhënësit, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat.

Diskriminimi që ka të bëjë me rekrutimin në punë, trajnimin, promovimin e punësimit, kushtet e punësimit, masat disiplinore, ndërprerjen e kontratës ose çështje të tjera nga marrëdhënia e punës, është i ndaluar me ligj. I punësuari e ka të drejtën për sigurimin në punë, mbrojtjen e shëndetit dhe të ambientit të përshtatshëm të punës.

Sipas ligjit themelor të punës, mosha 18 vjeç është mosha minimale për punësim, megjithëse individët mund të punësohen edhe mbi moshën 15 vjeç. Sidoqoftë, kjo moshë kërkon kushte më të veçanta që korrespondojnë me shëndetin dhe zhvillimin e kësaj moshe. Prandaj, ata, kryesisht, mundën apo lejohen të angazhohen në punë më të lehta, të cilat nuk e dëmtojnë shëndetin dhe zhvillimin e tyre. Ndërsa, punësimi nën moshën 15 vjeç është i ndaluar me ligj. Ligji i punës i përcakton edhe normat që kanë të bëjnë me orarin e punës. Orari i punës, i përcaktuar me këtë ligj, është 40 orë në javë. Por, ka edhe mundësi të tjera që i lejojnë punëtorët të punojnë edhe jashtë orarit, por, pa dyshim, nën kushte të përcaktuara dhe të rregulluara me ligj.

Kuadri ligjor, që ka të bëjë me funksionimin e tregut të punës dhe të marrëdhënieve në punë në aspektin formal, konsiderohet një kuadër ligjor modern, që, në masë të madhe, i afrohet legjislacionit të Bashkimit Evropian. Megjithatë, funksionalizimi praktik i ligjit ende është larg së qenit i realizuar.

Ekonomia joformale në Kosovë është shumë e theksuar. Dhe, si rezultat i kësaj, një numër i madh i punëtorëve, e që punojnë në ekonominë joformale, është jashtë kuadrit ligjor dhe pa mbrojtjen e duhur. Edhe në sektorin formal punëtorët kanë vështirësi në realizimin e të drejtave të tyre, të cilat u takojnë me ligj. Kjo ndodh shkak i mosefikasitetit të inspektoratit dhe, përgjithësisht, mungesës së funksionimit të shtetit ligjor, që është një nga problemet më madhore me të cilën ballafaqohet Kosova.

Një aspekt tjetër i politikave të tregut të punës janë edhe kombinimi i beneficioneve për papunësinë, i beneficioneve sociale dhe paga minimale.

Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale është përgjegjëse për planifikimin, organizimin dhe monitorimin, si të beneficioneve për papunësinë ashtu edhe të beneficioneve për ndihma sociale.

Duke pasur parasysh papunësinë e lartë dhe gjendjen e rëndë sociale, Kosova i ka të domosdoshme beneficionet për papunësinë dhe beneficionet sociale. Mirëpo, kapacitetet

jashtëzakonisht të kufizuara buxhetore ia pamundësojnë një trajtim të gjerë të të papunëve dhe të rasteve sociale.

Kompensimi financiar për të papunët, pothuajse, është inekzistent, ndërsa beneficionet financiare për çështjet sociale janë mjaft prezent. Ndhimën sociale për vitin 2010 e kanë gëzuar 35.940 familje, me 157.329 anëtarë, me vlerë totale 28.473.580 euro, ndërkaq shuma të cilën e gëzon një familje me asistencë sociale është 60 euro, shumë kjo që nuk është aspak e mjaftueshme në qoftë se merret parasysh shporta e konsumit. Por, potenciali buxhetor i Kosovës është mjaft i vogël dhe i pamjaftueshëm, kështu që nuk arrin t'i trajtojë në mënyrë të duhur beneficionet për papunësinë, si dhe beneficionet për rastet sociale. Paga minimale, sipas ligjit të punës, përcaktohet me akt nënligjor dhe arrihet me anë të marrëveshjes së komitetit ekonomiko-social, ku bëjnë pjesë: përfaqësuesit e qeverisë, përfaqësuesit e punëtorëve (sindikatat), si dhe përfaqësuesit e biznesit.

Në përcaktimin e pagës minimale duhet të merren parasysh këta faktorë:

1. Kostoja e shpenzimeve jetësore;
2. Përqindja e shkallës së papunësisë;
3. Gjendja e përgjithshme në tregun e punës;
4. Shkalla e konkurrencës dhe e produktivitetit në vend.

Nëse i kemi parasysh shpenzimet jetësore, paga prej 180 eurosh nuk i plotëson standardet, mirëpo kjo pagë korrespondon me faktorët e tjerë, si me shkallën e papunësisë, gjendjen e përgjithshme të tregut të punës dhe produktivitetin e ekonomisë kombëtare. Prandaj, bazuar në këto fakte, ajo konsiderohet deri diku e pranueshme.

Një aspekt tjetër i politikave të tregut të punës janë edhe “politikat aktive të tregut të punës”.

Këto politika kanë të bëjnë me:

1. Ndërmjetësimin në punë dhe profesion;
2. Këshillimet në punë dhe profesion;

3. Formimin profesional;
4. Programet e nxitjes së punësimit etj.

Departamenti i Punës dhe i Punësimit, në kuadër të Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale, me anë të divizioneve të veta, merret me ndërmjetësimin në punë, trajnimin profesional etj. Kjo ministri e bën ndërmjetësimin në punë nëpërmjet qendrave të saj rajonale të vendosura në qytetet kryesore. Ndërkaq, secila qendër rajonale i ka degët përkatëse nëpër qendrat më të vogla të Kosovës.

Roli i këtyre zyrave të punësimit është regjistrimi i të papunëve. Zyrat e punësimit, përveç që i regjistrojnë të papunët, ato ndërmjetësojnë edhe ndërmjet të papunëve dhe punëdhënësve. Në zyrat e punësimit janë të regjistruar afër 340 mijë persona si të papunë. Deri në vitin 2003 numri i të papunëve të regjistruar në këto zyra, vazhdimisht, ka ardhur duke u rritur. Kurse, në vitin 2004, përjashto vitin 2007, ritmi i rritjes ka ardhur duke u zvogëluar.

Këtë rrjedhë zhvillimi më së miri mund ta pasqyrojmë nëpërmjet tabelës:

Tabela 18. Numri i të papunëve të regjistruar

VITET	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
SHK. E RRITJES	8.2%	9.7%	6.7%	5.7%	2.4%	2.6%	0.4%	0.2%

Burimi: MPMS, Puna dhe punësimi

Gjatë viteve ka pasur hyrje dhe dalje të të regjistruarve si të papunë në qendrat e punësimit. Personat që kanë hyrë në këta regjistra kanë qenë qoftë persona që e kanë humbur vendin e punës, qoftë persona që kanë hyrë rishtazi në tregun e punës. Ndërkaq, daljet nga këta regjistra kanë të bëjnë, kryesisht, me persona që janë punësuar, apo me persona që kanë dalë nga këto lista si të dekurajuar. Hyrjet dhe daljet nga viti 2005-2010 i japim në tabelën, e cila i pasqyron në mënyrë të detajuar rezultatet:

Tabela 19. Hyrjet dhe daljet nga viti 2005-2010

Viti	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Hyrjet 12-mujore	29661	30327	23279	21979	19462	19914
SHH mes. mujore	0.79%	0.78%	0.58%	0.55%	0.35%	0.49%
Daljet 12-mujore	12585	22691	14710	10632	16509	23549
SHD mes. mujore	0.34%	0.58%	0.37%	0.51%	0.41%	0.58%

Tabela 19. Burimi: MPMS, Puna dhe punësimi

Personat, të cilët janë regjistruar si të papunë në qendrat e punësimit, janë të kategorive të ndryshme të shkollimit, duke filluar nga ata të pakualifikuar, gjysmë të kualifikuar, të kualifikuar, me shkollë të mesme, shkollë të lartë e deri te ata me kualifikim universitar.

Tabela 20. Kualifikimi i të papunëve, MPMS, Puna dhe punësimi

Kualifikimi	ISLE D	Pap. regji	%	Hyrj.12 muj.	Da. 12 muj	Sh.H Mes.muj	SH.D. M
Të pakualifikuar	0-2	202764	60	10406	7611	0.33%	0.31%
Gjys.të kualifik.	3	13355	4	457	358698	0.28%	0.45%
Të kualifikuar	3a	28849	9	839	1015	0.18%	0.29%
Shk. e mesme	3c	87681	26	6613	6019	0.38%	0.57%
Shk. e lartë	4	2184	1	139	168	0.5%	0.64%
Universiteti	5a+	3062	1	1107	998	3.23%	2.74%

Burimi: MPMS, Puna dhe punësimi

Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, në kuadër të Divizionit të Punësimit, i cili merret me regjistrimin e të papunëve dhe ndërmjetëson në punësimin e tyre, e ka edhe Divizionin e Aftësimeve Profesionale (DAP), i cili merret me aftësimin profesional të punëkërkesve. Ky divizion, qysh nga viti 2002, ka trajnuar një numër të madh të të papunëve, me qëllim që t'i përgatisë ata për tregun e punës.

Këtë pasqyrë do ta japim nëpërmjet tabelës:

Tabela 21. Numri i të aftësuarve të të papunëve

Vitet	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Nr. i të aftës.	1658	2201	3108	3928	2455	3047	3047	2977	3306

Burimi: MPMS, Puna dhe punësimi

Siç shihet nga tabela, Divizioni i Aftësimeve Profesionale (DAP) ka aftësuar një numër të madh të personave të papunë. Pa dyshim, nevojat e punëkërkesve për trajnim dhe aftësim profesional janë shumë më të mëdha, por kapaciteti i DAP-s është i kufizuar për t'i përmbushur të gjitha ato. Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale ka ndërmarrë edhe shumë programe aktive për nxitjen e punësimit. Më i rëndësishmi është ai i bashkëpunimit me UNDP-në dhe komunat, me ç'rast kanë nënshkruar memorandumin e mirëkuptimit për projektin e vitit 2010. Për vitin 2010 në këtë projekt janë ndërmjetësuar 962 persona punëkërkes, në skemat e trajnimit në kompani dhe institucione të ndryshme. Ky projekt synohet të vazhdojë edhe në vitet e ardhshme.

4.3. Përfundimi

Si përfundim theksojmë se politikat e punësimit duhet të përmirësohen dhe të përshtaten me nevojat e tregut të punës. Gjithashtu, këto politika janë zhvilluar gradualisht dhe janë përmirësuar në krahasim me vitet e shkuara dhe nga aspekti ligjor që duhet të përmirësohen më tej, për të arritur qëllimet e caktuara.

Kosova është në proces të krijimit të institucioneve dhe politikave të tregut të punës. Përvojat e vendeve të tjera duhet të merren parasysh dhe të përdoren në përputhje me rrethanat.

Pra, themelimi i politikave të qëndrueshme aktive dhe pasive të tregut të punës, duhet të bazohen në specifikat e tregut të punës në Kosovë: papunësia e lartë, posaçërisht te femrat dhe të rinjtë, me të hyra neto të larta potenciale në tregun e punës. Qëllimi kryesor është krijimi i vendeve të reja të punës, që ka të bëjë më shumë me politikat dhe kornizat makroekonomike. Në

këtë situatë specifike dhe me kufizimet buxhetore ekzistuese, institucionet dhe politikat e tregut të punës duhet të stimulojnë mobilitetin e fuqisë punëtore dhe edukimin modern.

Në këtë punim i trajtuam politikat më me ndikim në punësim, veç e veç, si, Politika Fiskale, e cila duhet t'i përkrahë më shumë investitorët. Rrjedhimisht, të krijohen më shumë vende të reja të punës; importimi i të mirave kapitale dhe inputet për bujqësi duhet të gëzojnë lehtësi fiskale, ndërsa shkalla ekzistuese e papunësisë duhet të konsiderohet si prioritet në këtë aspekt.

Politika monetare-kredituese, tregu ekzistues kreditor nuk është ende i përshtatshëm për investime në krijimin e vendeve të reja të punës. Kreditë janë afatshkurta, me shkallë të lartë të interesit. Kursimi afatgjatë nuk është i stimuluar nga bankat (shkalla shumë e lartë e interesit) që krijojnë vështirësi financiare për bankat në sigurimin e huave afatgjata.

Marrëdhëniet tregtare dhe mundësitë për eksport: importuesit dhe eksportuesit kosovarë ende ballafaqohen me pengesa të ndryshme, ekziston një asimetri në marrëdhëniet tregtare dhe mungesë e reciprocitetit (në regjimet tregtare dhe doganat që nuk aplikohen nga vendet fqinje). Ambientet miqësore për investime të huaja direkte akoma mungojnë. Nuk ka ndonjë strategji të duhur promovuese lidhur me koordinimin e aktiviteteve. Për shkak të mungesave në politika, kryesisht në tri fushat e përmendura më parë, si dhe sigurimi i kushteve për tërheqjen në Kosovë, investimet e huaja nuk janë në shkallën të duhur, gjë që reflektohet me punësim më të ulët. Bazuar me rrethanat e Kosovës, mund të konkludojmë se zhvillimi i NVM-ve, zhvillimi i bujqësisë dhe bizneset familjare, priten të bëhen gjeneratorë për krijimin e vendeve të reja të punës. Gjithsesi, nëse politikat dhe strategjitë e përgjithshme dhe sektoriale ndërtohen duke pasur parasysh fushat e mësipërme.

Si politikë me ndikim në punësim e shoh edhe krijimin e një tregu të përbashkët Kosovë-Shqipëri, duke pasur shembull tregun e Bashkimit Evropian. E që, nëpërmjet tij, do të bëhej e mundur lëvizja pa pengesa e fuqisë punëtore dhe e kapitalit. Kjo do ta forconte dhe zhvillonte më tepër tregun e punës në të dy vendet. Pra, do të ndikonte drejtpërdrejt në uljen e numrit të të papunëve dhe në krijimin e vendeve të reja të punës. Njëkohësisht, do të krijohej edhe një hapësirë joshëse edhe për investitorët e huaj, e që do të shkonte në dobi të zhvillimit ekonomik të të dyja vendeve.

KAPITULLI V

5.1 Metodologjia e kërkimit dhe burimet e informacionit

Pyetjet bazë të këtij punimi kërkimor janë:

1. Cili është roli i arsimit në formimin e kapitalit njerëzor?
2. Cili është roli i arsimit në rritjen e të ardhurave të individëve?

Po i cekim edhe hipotezat bazë të këtij punimi:

- a) Niveli i arsimit ndikon pozitivisht në zvogëlimin e kohës së të qenit i papunë,
- b) Niveli i arsimit ndikon pozitivisht në rritjen e të ardhurave të individëve.

5.2 Burimet kryesore për vërtetimin e këtyre hipotezave janë:

- a) Burimet parësore, të mbledhura nga të intervistuarit nëpër komunat e Kosovës,
- b) Citimi i të dhënave nga raporte të ndryshme nga vendi dhe nga autorë të ndryshëm, lidhur me tregun e punës dhe punësimin.

5.2.1 Popullata dhe kampioni i studimit

Në këtë studim janë marrë mendimet vetëm të familjeve, të cilat kanë, së paku, një student ose më shumë. Gjithashtu, janë marrë në konsideratë edhe mendimet e familjeve që kishin familjarë të punësuar në sektorë të ndryshëm. Esenca ishte: Sa ka zgjat koha e pritjes që të punësohen dhe a ka ndikim arsimimi në nivelin e të ardhurave?

5.3 ANALIZA E TË DHËNAVE EMPIRIKE

Në këtë hulumtim janë marrë përgjigje prej 385 respondentëve, mjaftueshëm për të arritur besueshmërinë prej 95-99% të përgjigjeve sipas “Sample Calculator”. Shtrirja e respondentëve ka qenë në qendrat (duke përfshirë rrethinën) më të mëdha të Kosovës. Nga 385 të anketuar del se 51.7% prej tyre ishin të gjinisë mashkullore, kurse 48.3% ishin të gjinisë femërore.

Gjinia e të intervistuesit					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Femër	186	48.3	48.3	48.3
	Mashkull	199	51.7	51.7	100.0
	Total	385	100.0	100.0	

Tabela 1. Gjinia e të intervistuarve

Siç dihet, grupin më të madh të popullsisë në Kosovë e përbën pjesa e rinisë. Nga ky hulumtim 43.6% e respondentëve ishin të grupmoshës 18 deri në 24 vjeç, 27.8% ishin të grupmoshës 25 deri në 34 vjeç, kurse nga grupmosha 65 e më të vjetër përqindja e anketuarve ishte 4.9%.

Mosha e të intervistuesit					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	18 deri 24 vjeç	168	43.6	43.6	43.6
	25 deri 34 vjeç	107	27.8	27.8	71.4
	35 deri 44 vjeç	37	9.6	9.6	81.0
	45 deri 54 vjeç	28	7.3	7.3	88.3
	55 deri 64 vjeç	26	6.8	6.8	95.1
	65 ose më i vjetër	19	4.9	4.9	100.0
	Total	385	100.0	100.0	

Tabela 2. Mosha e respondentëve

A jeni të punësuar?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Po	175	45.5	45.5	45.5
	Jo	127	33.0	33.0	78.4
	Student	64	16.6	16.6	95.1
	Pensionist	17	4.4	4.4	99.5
	Nuk dëshiroj të punoj	2	.5	.5	100.0
	Total	385	100.0	100.0	

Tabela 3. Niveli i papunësisë në Kosovë

Sipas hulumtimit të kryer nga 385 respondentë në qendrat më të mëdha të Kosovës dhe rrethinat e tyre, mund të konkludojmë se papunësia mbetet problemi më i madh që përballët shoqëria kosovare pas përfundimit të luftës. Sipas hulumtimit të kryer, shifra e papunësisë në Kosovë është 33%, kurse i atyre që janë në punë është 45.5. Pensionistët përbëjnë 4.4%, ndërsa studentët përbëjnë 16.6%.

Nëse jeni të punësuar, në çfarë sektori punoni?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Sektorin publik (shtetëror)	58	15.1	33.0	33.0
	Sektorin privat	82	21.3	46.6	79.5
	I vetëpunësuar	36	9.4	20.5	100.0
	Total	176	45.7	100.0	
Missing	System	209	54.3		
Total		385	100.0		

Tabela 4. Shkalla e papunësisë në Kosovë

Sektori privat përbën pjesën më të madhe të atyre që janë të punësuar, pra 21.3%, ndërsa në sektorin publik janë 15.1%. Kjo e dhënë nuk është shenjë e mirë për “shëndetin ekonomik” të Kosovës, pasi 15.1% janë të punësuar në sektorin publik. Kosova, si ekonomi me tregun e lirë,

politikat e saj zhvillimore duhet t'i drejtojë në sektorin privat dhe vendet e punës të hapen, pikërisht, në këtë sektor.

Cili është niveli juaj i shkollimit?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Niveli 1. Arsimi fillor (klasa I deri V)	8	2.1	2.1	2.1
	Niveli 2. Arsimi i mesëm i ulët (klasa VI deri IX)	8	2.1	2.1	4.2
	Niveli 3. Arsimi i mesëm i lartë (klasa X deri XIII)	120	31.2	31.3	35.5
	Niveli 4. Arsimi post-sekondar jo terciar (studime profesionale 6 muaj deri 2 vjet)	25	6.5	6.5	42.0
	Niveli 5. Faza e parë e arsimit terciar (bachelor)	149	38.7	38.9	80.9
	Niveli 6. Faza e parë e arsimit terciar (master)	71	18.4	18.5	99.5
	Niveli 7. Faza e dytë e arsimit terciar (doktoraturë, PhD)	2	.5	.5	100.0
	Total	383	99.5	100.0	
Missing	System	2	.5		
Total		385	100.0		

Tabela 5. Niveli i shkollimit

Niveli i shkollimit, i nxjerrë nga ky hulumtim, tregon se në Kosovë 31.2% kanë të kryer shkollën e mesme, kurse nivelin bachelor e kanë të mbaruar 38.7%, ndërsa atë master 18.5%.

Këtu shihet se shkollimi në Kosovë çdo vit e më shumë po rritet. Mirëpo, krahas rritjes së pjesëmarrjes në shkollim, duhet të rritet edhe niveli i cilësisë në arsim.

Nëse jeni të papunë, qe sa muaj/vjet jeni duke kërkuar punë?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Më pak se 3 muaj	26	6.8	17.0	17.0
	Më pak se 6 muaj	28	7.3	18.3	35.3
	Më pak se 1 vit	47	12.2	30.7	66.0
	Më pak se 2 vjet	34	8.8	22.2	88.2
	Më pak se 5 vjet	18	4.7	11.8	100.0
	Total	153	39.7	100.0	
Missing	System	232	60.3		
Total		385	100.0		

Tabela 6. Pritja për gjetjen e vendit të punës

Gjetja e vendit të punës është imperativ kryesor për gjithsecilin njeri. Papunësia mbetet problemi më i madh me të cilin po ballafaqohet popullsia e Kosovës. Gjetja e një vendi të punës është shumë i vështirë, si për ata që kanë të kryer nivelin post-sekondar, e edhe për ata që kanë të kryer nivelin e mesëm apo fillor. Përqindja e atyre që janë duke kërkuar punë 5 e më shumë vjet është 11.8%, kurse i atyre që janë duke kërkuar punë më pak se 1 vit është 30.7%.

Cili është niveli juaj i shkollimit? * A jeni të punësuar?

			A jeni të punësuar?					Total
			Po	Jo	Student	Pensionist	Nuk dëshiroj të punoj	
Cili është niveli juaj i shkollimit?	Niveli 1. Arsimi fillor (klasa I deri V)	Count	0	0	1	7	0	8
		% of	.0%	.0%	.3%	1.8%	.0%	2.1%
		Total						
	Niveli 2. Arsimi i mesëm i ulët (klasa VI deri IX)	Count	1	3	0	4	0	8
		% of	.3%	.8%	.0%	1.0%	.0%	2.1%
		Total						
	Niveli 3. Arsimi i mesëm i lartë (klasa X	Count	45	47	24	2	2	120

deri XIII)	% of Total	11.7%	12.3%	6.3%	.5%	.5%	31.3%
Niveli 4. Arsimi post-sekondar jo terciar (studime profesionale 6 muaj deri 2 vjet)	Count % of Total	4 1.0%	11 2.9%	8 2.1%	2 .5%	0 .0%	25 6.5%
Niveli 5. Faza e parë e arsimit terciar (bachelor)	Count % of Total	81 21.1%	42 11.0%	26 6.8%	0 .0%	0 .0%	149 38.9%
Niveli 6. Faza e parë e arsimit terciar (master)	Count % of Total	42 11.0%	23 6.0%	4 1.0%	2 .5%	0 .0%	71 18.5%
Niveli 7. Faza e dytë e arsimit terciar (doktoraturë, PhD)	Count % of Total	2 .5%	0 .0%	0 .0%	0 .0%	0 .0%	2 .5%
Total	Count % of Total	175 45.7%	126 32.9%	63 16.4%	17 4.4%	2 .5%	383 100.0%

*Tabela 7. Cili është niveli juaj i shkollimit? * A jeni të punësuar?*

Punësimi shpeshherë është i lidhur edhe me nivelin e shkollimit. Më lart paraqitëm tabelën e nivelit të shkollimit dhe papunësisë. Nga tabela shihet se pjesa më e madhe e të punësuarve kanë të kryer nivelin bachelor.

Mosha mesatare e të punësuarve në Kosovë

Descriptive Statistics

	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation
Në ç'moshë jeni punësuar?	199	12	47	23.63	4.437
Valid N (listwise)	199				

Tabela 8. Cila është mosha mesatare që njerëzit punësohen në Kosovë?

Mosha mesatare në të cilën punësohen njerëzit në Kosovë është 23.63 vjeç. Pa dyshim, konstatojmë se mosha mesatare në Kosovë është shumë e re.

ANOVA. Kërkimi për punë. Niveli i shkollimit

Nëse jeni të papunë, qe sa muaj/vjet jeni duke kërkuar punë?

	Sum of Squares	df	Mean Square	F	Sig.
Between Groups	2.552	4	.638	.402	.807
Ëithin Groups	234.794	148	1.586		
Total	237.346	152			

Tabela 9. Muajt që nevojiten për të kërkuar punë

Analiza e Variances (ANOVA) tregon se nuk ka dallim signifikant ndërmjet grupeve me nivel më të lartë të shkollimit dhe grupeve me nivel më të ulët të shkollimit, sa i përket kohëzgjatjes së papunësisë (sa kohë është kërkuar punë).

Correlations

		Cili është niveli juaj i shkollimit ?	Nëse jeni të papunë, qe sa muaj/vjet jeni duke kërkuar punë?	A jeni të punësuar ?	Kur jeni punësuar ?	Sa vjet përvoje pune keni?	Sa janë të ardhurat e juaja vjetore?
Cili është niveli juaj i shkollimit?	Pearson Correlation	1	-.054	-.342**	-.573**	-.186**	.292**
	Sig. (2-tailed)		.505	.000	.000	.008	.000
	N	384	153	384	198	203	286
Nëse jeni të papunë, qe sa muaj/vjet jeni duke kërkuar punë?	Pearson Correlation	-.054	1	-.210**	.082	.161	.258*
	Sig. (2-tailed)	.505		.009	.753	.537	.017
	N	153	153	153	17	17	85
A jeni të punësuar?	Pearson Correlation	-.342**	-.210**	1	.225**	.414**	-.427**
	Sig. (2-tailed)	.000	.009		.001	.000	.000
	N	384	153	385	198	203	286
Kur jeni punësuar?	Pearson Correlation	-.573**	.082	.225**	1	.377**	-.013
	Sig. (2-tailed)	.000	.753	.001		.000	.864
	N	198	17	198	198	197	188

Sa vjet përvojë pune keni?	Pearson Correlation	-.186**	.161	.414**	.377**	1	.262**
	Sig. (2-tailed)	.008	.537	.000	.000		.000
	N	203	17	203	197	203	191
Sa janë të ardhurat tuaja vjetore?	Pearson Correlation	.292**	.258*	-.427**	-.013	.262**	1
	Sig. (2-tailed)	.000	.017	.000	.864	.000	
	N	286	85	286	188	191	286

Tabela 10. Korrelacioni

Vërehet lehtë se niveli i shkollimit nuk është faktor kryesor që vendos për punësim. Ka edhe faktorë të tjerë që janë të rëndësishëm. Arsimi është me kosto të lirë dhe atë po e bëjnë të gjithë. Kjo ka bërë që me arsim të lartë janë të shumtë dhe punësimi është bërë i vështirë.

Interpretimi i hipotezës

Siç duket, niveli më i lartë i shkollimit nuk ndikon në mënyrë signifikante ($p=0.505$) në shkurtimin ose zgjatjen e kohës së papunësisë. Megjithatë, ka korrelacion signifikant ndërmjet nivelit të shkollimit e punësimit dhe kohës së punësimit. Gjithashtu, niveli më i lartë i shkollimit (siç pritet) duket se i rritë gjasat për të pasur numër më të vogël të viteve të përvojës së punës, por i rritë të ardhurat vjetore në mënyrë signifikante.

Gjinia e të intervistuesit * A jeni të punësuar?

			A jeni të punësuar?					
			Po	Jo	Student	Pensionist	Nuk dëshiroj të punoj	
Gjinia e të intervistuesit	Femër	Count	73	68	38	7	0	186
		% of Total	19.0%	17.7%	9.9%	1.8%	.0%	48.3%
	Mashkull	Count	102	59	26	10	2	199
		% of Total	26.5%	15.3%	6.8%	2.6%	.5%	51.7%
Total		Count	175	127	64	17	2	385
		% of Total	45.5%	33.0%	16.6%	4.4%	.5%	100.0%

Tabela 11. Sa është përqindja e të punësuarve?

Sipas hulumtimit del se në Kosovë, nga 45.5% sa janë të punësuar, 26.5% prej tyre janë meshkuj, kurse 19% janë femra. Gjithashtu, sipas gjinisë në nivelin e papunësisë, femrat përbëjnë 17.7%, kurse meshkujt e papunë janë 15.3% në nivel të Kosovës. Numri më i madh i studentëve janë të gjinisë femërore, kurse meshkuj janë 6.8%.

Gjinia e të intervistuesit * Nëse jeni të punësuar, në çfarë sektori punoni?

			Nëse jeni të punësuar, në çfarë sektori punoni?			Total
			Sektorin publik (shtetëror)	Sektorin privat	I vetëpunësuar	
Gjinia e të intervistuesit	Femër	Count	22	41	10	73
		% of Total	12.5%	23.3%	5.7%	41.5%
	Mashkull	Count	36	41	26	103
		% of Total	20.5%	23.3%	14.8%	58.5%
Total		Count	58	82	36	176
		% of Total	33.0%	46.6%	20.5%	100.0%

Tabela 12. Në çfarë sektori punoni?

Meshkujt punojnë më shumë në sektorin publik sesa femrat, kurse në sektorin privat kjo ndarje është e barabartë me nga 23.3% pjesëmarrje. Gjithashtu, nga ky hulumtim shohim se në Kosovë janë më shumë meshkujt që më shumë marrin iniciativën për punësim, me 14.8%, ndërsa femrat me 5.7%.

Cili është niveli juaj i shkollimit? * Gjinia e të intervistuesit, Crosstabulation

			Gjinia e të intervistuesit		total
			femër	mashkull	
Cili është niveli juaj i shkollimit?	Niveli 1. Arsimit fillor (klasa I deri V)	Count	5	3	8
		% of Total	1.3%	.8%	2.1%
	Niveli 2. Arsimit mesëm i ulët (klasa VI deri IX)	Count	6	2	8
		% of Total	1.6%	.5%	2.1%
	Niveli 3. Arsimit mesëm i lartë (klasa X deri XIII)	Count	56	64	120
		% of Total	14.6%	16.7%	31.2%
	Niveli 4. Arsimit post-sekondar jo terciar (studime profesionale 6 muaj deri 2 vjet)	Count	14	11	25
		% of Total	3.6%	2.9%	6.5%
	Niveli 5. Faza e parë e arsimit terciar (bachelor)	Count	69	80	149
		% of Total	18.0%	20.8%	38.8%
	Niveli 6. Faza e parë e arsimit terciar (master)	Count	36	36	72
		% of Total	9.4%	9.4%	18.8%
	Niveli 7. Faza e dytë e arsimit terciar (doktoraturë, PhD)	Count	0	2	2
		% of Total	.0%	.5%	.5%
Total		Count	186	198	384
		% of Total	48.4%	51.6%	100.0%

Tabela 13. Niveli i shkollimit

Nga tabela shihet se niveli i shkollimit është më së shumti i theksuar në nivelin bachelor, me 20.8% te meshkujt, krahas 18% te femrat.

Sa janë të ardhurat tuaja vjetore?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Më pak se 2.000 EUR	107	27.8	37.4	37.4
	Më pak se 3.000 EUR	55	14.3	19.2	56.6
	Më pak se 4.000 EUR	33	8.6	11.5	68.2
	Më pak se 5.000 EUR	29	7.5	10.1	78.3
	Më pak se 8.000 EUR	46	11.9	16.1	94.4
	Më pak se 10.000 EUR	9	2.3	3.1	97.6
	Më pak se 20.000 EUR	6	1.6	2.1	99.7
	Më pak se 50.000 EUR	1	.3	.3	100.0
	Total	286	74.3	100.0	
Missing	System	99	25.7		
Total		385	100.0		

Tabela 14. Sa janë të ardhurat vjetore?

Sa i përket nivelit të të ardhurave shihet se të ardhurat janë nën nivelin 2.000 euro, ku edhe dominon kjo vlerë me %.

Pas diplomimit, a keni ndjekur ndonjë kurs/trajnim profesional?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Po	137	35.6	53.9	53.9
	Jo	117	30.4	46.1	100.0
	Total	254	66.0	100.0	
Missing	System	131	34.0		
Total		385	100.0		

Tabela 15. Sa kanë ndjekur trajnime profesionale të anketuarit?

Përqindja e studentëve, të cilët kanë ndjekur trajnime profesionale, ka qenë afro 53.9%.

Trajnimet janë të domosdoshme për të gjetur më lehtë një vend pune.

Trajnimet luajnë një rol shumë të madhë në avancimin e diturive praktike tek te rinjtë.

A të përgatit sistemi i arsimit i Kosovës për tregun e punës?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Po	199	51.7	56.2	56.2
	Jo	155	40.3	43.8	100.0
	Total	354	91.9	100.0	
Missing	System	31	8.1		
Total		385	100.0		

Tabela 16. A i përgatit sistemi i arsimit i Kosovës për tregun e punës?

Nga të intervistuarit, në pyetjen se a i përgatit sistemi i arsimit për tregun e punës, u përgjigjen pozitivisht 51.7%. Ata që e mohuan një gjë të tillë ishin 40.3%. Nuk u shprehën 8.1%.

Sipas jush, a janë studimet më kualitative në universitetin publik a privat?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Publik	285	74.0	82.8	82.8
	Privat	59	15.3	17.2	100.0
	Total	344	89.4	100.0	
Missing	System	41	10.6		
Total		385	100.0		

Tabela 17. Sipas jush, a janë studimet më kualitative në universitetin publik a privat?

Se ku janë studimet më kualitative, del se janë në universitetet publike. Universitetet publike sjellin studime më cilësore. Mirëpo, unë mendoj se kjo është relative, sepse kjo varet edhe nga studentët.

Nëse pranoni të ardhura, ju lutemi, na tregoni sa është shuma vjetore e pranuar?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Më pak se 1.000 EUR	48	12.5	32.0	32.0
	Më pak se 3.000 EUR	53	13.8	35.3	67.3
	Më pak se 5.000 EUR	41	10.6	27.3	94.7
	Më pak se 10.000 EUR	4	1.0	2.7	97.3
	Më shumë se 10.000 EUR	4	1.0	2.7	100.0
	Total	150	39.0	100.0	
Missing	System	235	61.0		
Total		385	100.0		

Tabela 18. Shuma e të ardhurave të pranuar nga jashtë

Nga të dhënat në tabelë shihet se sasia më e madhe e parave sillet për shumën deri në 3.000 euro, apo shprehur në përqindje afro 13.8%

Po t’u ofrohej mundësia e migrimit jashtë Kosovës, a do të pranoni?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Po	194	50.4	51.5	51.5
	Jo	183	47.5	48.5	100.0
	Total	377	97.9	100.0	
Missing	System	8	2.1		
Total		385	100.0		

Tabela 19. Arsyeja e migrimit

Nga tabela shihet se 51.5 % do të emigronin jashtë nëse do t’u jepej mundësia, krahas të tjerëve që u përgjigjen me “jo”, me 48.5%.

Nëse do të migronit jashtë, cila është arsyeja e migrimit?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Punësimi	126	32.7	52.5	52.5
	Shëndetësia	34	8.8	14.2	66.7
	Mundësia për karrierë më të mirë	34	8.8	14.2	80.8
	Shkollimi më cilësor	13	3.4	5.4	86.2
	Paga më e lartë	28	7.3	11.7	97.9
	Stabiliteti politik	2	.5	.8	98.8
	Mungesa e sigurisë	3	.8	1.2	100.0
	Total	240	62.3	100.0	
Missing	System	145	37.7		
Total		385	100.0		

Tabela 20. Arsyet e migrimit

Ndoshta kjo edhe është tema më e ndjeshme. Siç shihet edhe nga tabela, arsyeja kryesore për migrim jashtë vendit është punësimi, me 52.5%, pastaj prijnë kushtet për shëndet më të mirë.

Kur jeni punësuar?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Gjatë studimeve	54	14.0	27.3	27.3
	Pas përfundimit të studimeve	91	23.6	46.0	73.2
	Pas përfundimit të shkollës së mesme	46	11.9	23.2	96.5
	Pas përfundimit të shkollës fillore	7	1.8	3.5	100.0
	Total	198	51.4	100.0	
Missing	System	187	48.6		
Total		385	100.0		

Tabela 21. Kur ka ndodhur punësimi?

Nga tabela shihet se koha kur më së shumti janë punësuar të anketuaritka qenë pas diplomimit.

Nëse jeni të papunë, qe sa muaj/vjet jeni duke kërkuar punë? * Gjinia e të intervistuesit

			Gjinia e të intervistuesit		total
			femër	mashkull	
Nëse jeni të papunë, qe sa muaj/vjet jeni duke kërkuar punë?	Më pak se 3 muaj	Count	19	7	26
		% of Total	12.4%	4.6%	17.0%
	Më pak se 6 muaj	Count	13	15	28
		% of Total	8.5%	9.8%	18.3%
	Më pak se 1 vit	Count	26	21	47
		% of Total	17.0%	13.7%	30.7%
	Më pak se 2 vjet	Count	20	14	34
		% of Total	13.1%	9.2%	22.2%
	Më pak se 5 vjet	Count	8	10	18
		% of Total	5.2%	6.5%	11.8%
	Total	Count	86	67	153
		% of Total	56.2%	43.8%	100.0%

Tabela 22. Koha e nevojshme për të gjetur punë

Nga tabela shihet se afro 1 vit është përqindja më e madhe që nevojitet për të gjetur punë me afro 17% te femrat dhe 13.7% te meshkujt. Arsyet pse zgjat koha e pritjes për një vende pune i kemi cekur te hipoteza e parë. Aty, në veçanti, i kemi shënuar arsyet një nga një...

Nëse jeni të punësuar, në çfarë sektori punoni? * Gjinia e të intervistuesit

Crosstabulation

			Gjinia e të intervistuesit		total
			femër	mashkull	
Nëse jeni të punësuar, në çfarë sektori punoni?	Sektorin publik (shtetëror)	Count	22	36	58
		% of Total	12.5%	20.5%	33.0%
	Sektorin privat	Count	41	41	82
		% of Total	23.3%	23.3%	46.6%
	I vetëpunësuar	Count	10	26	36
		% of Total	5.7%	14.8%	20.5%
Total	Count	73	103	176	
	% of Total	41.5%	58.5%	100.0%	

Tabela 23. Përqindja e punësimit në sektorë

Më së shumti të punësuar ka në sektorin privat, me përqindje 46% në total. Edhe sa i përket numrit të të punësuarve, të dhënat tregojnë se është një lloj barazie ndërmjet femrave dhe meshkujve sa i përket sektorit privat, mirëpo me dallime në sektorët e tjerë.

Pas diplomimit, a keni ndjekur ndonjë kurs/trajnim profesional? * Gjinia e të intervistuesit

			Gjinia e të intervistuesit		total
			femër	mashkull	
Pas diplomimit, a keni ndjekur ndonjë kurs/trajnim profesional?	Po	Count	69	68	137
		% of Total	27.2%	26.8%	53.9%
	Jo	Count	56	61	117
		% of Total	22.0%	24.0%	46.1%
Total		Count	125	129	254
		% of Total	49.2%	50.8%	100.0%

Tabela 24. Ndjekja e trajnimeve profesionale sipas gjinisë

Nga tabela shihet se 27% e femrave kanë ndjekur kurse trajnimi, krahas 25.8% të meshkujve.

A jeni të punësuar? * Nëse do t'u ofrohej mundësia e migrimit jashtë Kosovës, a do të pranoni ? Crosstabulation

			Nëse do t'u ofrohej mundësia e migrimit jashtë Kosovës, a do të pranoni?		Total
			Po	Jo	
A jeni të punësuar?	Po	Count	69	102	171
		% of Total	18.3%	27.1%	45.4%
	Jo	Count	79	46	125
		% of Total	21.0%	12.2%	33.2%
	Student	Count	41	21	62
		% of Total	10.9%	5.6%	16.4%
	Pensionist	Count	3	14	17
		% of Total	.8%	3.7%	4.5%
	Nuk dëshiroj të punoj	Count	2	0	2
		% of Total	.5%	.0%	.5%
	Total	Count	194	183	377
		% of Total	51.5%	48.5%	100.0%

Tabela 25. Mundësia e migrimit, po qe se do u jepej mundësia...

Sa i përket mundësisë së migrimit jashtë vendit, 27% ishin meshkuj që përgjigja e tyre ishte pozitive, krahas 18.3% të femrave që, gjithashtu, ishte pozitive.

A jeni të punësuar? * Lloji i vendbanimit

			Lloji i vendbanimit		total
			qytet	fshat	
A jeni të punësuar?	Po	Count	111	64	175
		% of Total	28.8%	16.6%	45.5%
	Jo	Count	88	39	127
		% of Total	22.9%	10.1%	33.0%
	Student	Count	43	21	64
		% of Total	11.2%	5.5%	16.6%
	Pensionist	Count	14	3	17
		% of Total	3.6%	.8%	4.4%
	Nuk dëshiroj të punoj	Count	2	0	2
		% of Total	.5%	.0%	.5%
	Total	Count	258	127	385
		% of Total	67.0%	33.0%	100.0%

Tabela 26. Punësimi sipas vendbanimit

Nga tabela shihet se shumica që punojnë vijnë nga pjesa urbane, me afro 28.8%, kurse nga fshati 16.6%.

Sa janë të ardhurat tuaja vjetore? * Çfarë është statusi martesor juaji?

			Çfarë është statusi martesor juaji?				total
			beqar	i martuar	divorcuar	i/e ve	
Sa janë të ardhurat tua vjetore?	Më pak se 2.000 euro	Count	78	21	1	7	107
		% of Total	27.3%	7.3%	.3%	2.4%	37.4%
	Më pak se 3.000 euro	Count	39	14	0	2	55
		% of Total	13.6%	4.9%	.0%	.7%	19.2%
	Më pak se 4.000 euro	Count	15	16	2	0	33
		% of Total	5.2%	5.6%	.7%	.0%	11.5%
	Më pak se 5.000 euro	Count	8	20	0	1	29
		% of Total	2.8%	7.0%	.0%	.3%	10.1%
	Më pak se 8.000 euro	Count	10	35	0	1	46
		% of Total	3.5%	12.2%	.0%	.3%	16.1%
	Më pak se 10.000 euro	Count	3	6	0	0	9
		% of Total	1.0%	2.1%	.0%	.0%	3.1%
	Më pak se 20.000 euro	Count	0	5	0	1	6
		% of Total	.0%	1.7%	.0%	.3%	2.1%
	Më pak se 50.000 EUR	Count	0	1	0	0	1
		% of Total	.0%	.3%	.0%	.0%	.3%
Total		Count	153	118	3	12	286
		% of Total	53.5%	41.3%	1.0%	4.2%	100.0%

Tabela 27. Përqindja e të ardhurave

Nga tabela shihet se përqindja më e madhe e të ardhurave, e që marrin të ardhura nga jashtë, nuk kalon shifrën më shumë se 2.000 euro, prej të cilëve beqarët janë ata që përfitojnë më së shumti, me 27.3%, krahas atyre të martuar, me 7.3%.

Nëse jeni të papunë, qe sa muaj/vjet jeni duke kërkuar punë? * Lloji i vendbanimit

			Lloji i vendbanimit		total
			qytet	fshat	
Nëse jeni të papunë, qe sa muaj/vjet jeni duke kërkuar punë?	Më pak se 3 muaj	Count	20	6	26
		% within Nëse jeni të papunë, qe sa muaj/vjet jeni duke kërkuar punë?	76.9%	23.1%	100.0%
	Më pak se 6 muaj	Count	20	8	28
		% within Nëse jeni të papunë, qe sa muaj/vjet jeni duke kërkuar punë?	71.4%	28.6%	100.0%
	Më pak se 1 vit	Count	32	15	47
		% within Nëse jeni të papunë, qe sa muaj/vjet jeni duke kërkuar punë?	68.1%	31.9%	100.0%
	Më pak se 2 vjet	Count	23	11	34
		% within Nëse jeni të papunë, qe sa muaj/vjet jeni duke kërkuar punë?	67.6%	32.4%	100.0%
	Më pak se 5 vjet	Count	12	6	18
		% within Nëse jeni të papunë, qe sa muaj/vjet jeni duke kërkuar punë?	66.7%	33.3%	100.0%
Total		Count	107	46	153
		% within Nëse jeni të papunë, qe sa muaj/vjet jeni duke kërkuar punë?	69.9%	30.1%	100.0%

Tabela 28. Koha e nevojshme për të gjetur punë në raport me ata që jetojnë në fshat a qytet

Hipoteza e dytë:

Sipas studimit të kryer në Kosovë, niveli më i lartë i shkollimit (siç pritet) ndikon në mënyrë signifkante në nivelin 0.005 dhe i rritë gjasat për të pasur numër më të vogël të viteve të përvojës së punës, por i rritë të ardhurat vjetore në mënyrë signifkante.

Kjo hipotezë është e pranueshme për arsye se për të përfunduar shkollimin duhen disa vite studim dhe mësim deri në diplomim. Gjatë viteve 1970-1999 në Kosovë ka mbizotëruar trendi i punësimit të të rinjve menjëherë pas përfundimit të shkollës së mesme dhe kyçjes së tyre në industri të ndryshme. Gjithashtu, shumica e të rinjve i kanë ndërprerë studimet për t'u marrë qoftë me bujqësi apo të sigurimit të një vendi të punës dhe mbajtjes së familjes. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe kostoja e studimit ka qenë shumë e lartë, ndërsa rëndësia e shkollimit nuk ka qenë e lartë për arsye të nivelit relativisht të ulët të ngritjes intelektuale.

Kjo ka bërë që gjeneratat më të hershme të fillojnë punën shumë më shpejt dhe të kenë përvojë më të madhe të punës sesa gjeneratat pas përfundimit të luftës. Gjeneratat pas vitit 1999 më shumë i kanë dhënë hapësirë shkollimit, për arsye të kostos më të ulët të shkollimit dhe qasjes më të lehtë në institucionet arsimore. Vetëdija për përfundim të shkollimit, gjithashtu, është rritur, e që ka bërë që shumë të rinj pas përfundimit të shkollës së mesme të drejtohen drejt universiteteve, sesa të aspirojnë sigurimin e një vendi të punës. Kjo ka bërë që të kemi dallime të përvojave ndërmjet gjeneratave, për arsye se vitet mesatare të punësimit të gjeneratave më të hershme janë 19-20 vjet, ndërsa gjeneratat pas përfundimit të luftës mbi 24-25 vjet. Sipas këtij studimi të kryer, del, gjithashtu, se niveli më i lartë i shkollimit të ketë ndikim signifkant në rritjen e të ardhurave.

Kjo edhe pritet për arsye se ata, të cilët kanë investuar në shkollimin e tyre, të presin rikthim të investimit të tyre në dije dhe të mos pranojnë punë në të cilat pagesa është e vogël. Personat të cilët kryejnë dhe kanë shkollim, aspirojnë të paguhen më shumë sesa personat e moshës së njëjtë, por me nivel më të ulët të shkollimit. Këtu paraqitet edhe problemi me të cilin ballafaqohet Kosova, për arsye se është një pjesë e gjeneratës, të cilët janë të shkolluar dhe kërkojnë paga më të larta, por nuk kanë përvojë pune. Dhe, në anën tjetër, është gjenerata e cila është më pak e shkolluar dhe pranon të punojnë me pagë më të vogël, kurse përvojën e punës e ka më të madhe, shkak i kyçjes më të hershme në punë. Vendi i punës me kërkesa komplekse, kërkone edhe nivel

të larte të studimeve.Kjo është arsye se pse niveli i larte i arsimit ndikon pozitivisht ne rritjen e te ardhurave.

Tabela 22. Vërtetimi i hipotezës së dytë

Variables Entered/Removed			
Model	Variables Entered	Variables Removed	Method
	Cili është niveli juaj i shkollimit?		Enter
a. All requested variables entered			
b. Dependent Variable: A jeni të punësuar?			

Tabela 23. Vërtetimi i hipotezës së dytë

Coefficients ^a						
Model		Unstandardized Coefficients		Standardized Coefficients	t	Sig.
		B	Std. Error	Beta		
1	(Constant)	2.860	.154		18.616	.000
	Cili është niveli juaj i shkollimit?	-.240	.034	-.342	-7.104	.000
a. Dependent Variable: A jeni të punësuar?						

5.4 Variablat

Variabla e varur është marrë punësimi që të shihet nëse punësimi varet nga niveli i shkollimit, pasi punësimi në Kosovë mbetet problemi më i madh makroekonomik, me të cilin përballet vendi ynë. Shkollimi në Kosovë është me kosto të ulët, por nga kjo shohim se, megjithatë, ka ndikim gjatë procesit të punësimit, meqë niveli sa më i lartë i shkollimit ndikon drejtpërdrejt në gjasat për punësim. Por, gjithashtu, shkollimi sa më i madh edhe i rritë gjasat që përvoja në punë të jetë më e vogël. Përvoja më e vogël i zbehë gjasat që pas punësimit të ardhurat të jenë më të mëdha.


Variabla e pavarur, në këtë rast, është selektuar shkollimi. Është selektuar i pavarur shkaku se arsyet e shkollimit mund të jenë të tjera, përveç punësimit. Arsyet e shkollimit mund të jenë të ndryshme, ngritje e nivelit të dijes, e plotësimit të egos personale, e arritjes së kënaqshmërisë të familjarët. Në këtë rast, shkollimi është marrë i pavarur, duke ndikuar që punësimi të mos jetë arsye për punësim.

Tabela 24. Anova


ANOVA ^b						
	Model	Sum of squares	df	Mean of square	F	Sig.
1	Regression	36.238	1	36.238	50.473	.000 ^a
	Residual	274.262	382	.718		
	Total	310.500	383			
a. Predictors: (Constant). Cili është niveli juaj i punësimit?						
b. Dependent Variable: A jeni të punësuar?						

Analiza e Variancës (ANOVA) tregon se ka dallim signifikant ndërmjet grupeve me nivel më të lartë të shkollimit dhe grupeve me nivel më të ulët të shkollimit, sa i përket asaj se a janë të punësuar. Siç shihet, grupi i njerëzve me nivelin më të lartë të shkollimit i rritë gjasat për punësim, ndërsa i atyre me nivel më të vogël të shkollimit i zbehë gjasat për punësim.


Nga ky hulumtim janë marrë përgjigje prej 385 respondentëve, mjaftueshëm për të arritur besueshmërinë prej 95-99% të përgjigjeve. Shtrirja e respondentëve ka qenë në qendrat (duke përfshirë rrethinën) më të mëdha të Kosovës. Nga 385 të anketuarit, del se 51.7% prej tyre ishin të gjinisë mashkullore, kurse 48.3% të gjinisë femërore. Siç dihet, grupin më të madh të popullsisë në Kosovë e përbën pjesa e rinisë. Nga ky hulumtim, 43.6% e respondentëve ishin të grupmoshës 18 deri në 24 vjeç, 27.8% të grupmoshës 25 deri në 34 vjeç, kurse nga grupmosha 65 vjeç e më të vjetër, përqindja e të anketuarve ishte 4.9%. Sipas hulumtimit të kryer nga 385 respondentë, në qendrat më të mëdha të Kosovës dhe rrethinat e tyre, mund të konkludojmë se papunësia mbetet problemi më i madh që përballet shoqëria kosovare pas përfundimit të luftës. Sipas hulumtimit të kryer, shifra e papunësisë në Kosovë është 33%, kurse e atyre që janë në punë është 45.5. Pensionistët përbëjnë 4.4%, ndërsa studentët përbëjnë 16.6%.





Nga diagrami shihet se 45.45% punojnë, krahas atyre që nuk punojnë me 32.99%. 16% janë studentë.




Nga figura mund të vërehet se të punësuar në sektorin privat janë 46.59%, ku edhe mbizotëron si përqindje, krahasuar me 32.95% në sektorin publik dhe, pastaj, me 20.45% si të vetëpunësuar.



Nga diagrami shohim se me më pak se 2.000 euro të ardhura vjetore janë shumica e të anketuarve. E, kështu me radhë, gjithherë në normë zvogëlimi duke u rritur të ardhurat.



Më lart kemi paraqitur të dhënat e mëhershme në mënyrë grafike. P. sh., grafiku i dytë tregon se afro 45.96% janë të punësuar pas studimeve, krahas 27.28% gjatë studimeve.



Nëse jeni të papunë, që sa muaj/vjet jeni duke kërkuar punë ?

Përqindja më e madhe e të papunëve që kërkojnë punë janë ata të cilëve u është dashur thujse një vit për të kërkuar punë, ose shprehur në përqindje 30.72%.

5.5 REGRESIONI

Coefficients^a

Model		Unstandardized Coefficients		Standardized Coefficients	t	Sig.
		B	Std. Error	Beta		
1	(Constant)	3.957	.406		9.752	.000
	Nëse keni të kryer fakultetin, ju lutemi, na tregoni a e keni kryer në universitet publik apo privat?	-.713	.298	-.181	-2.394	.018

a. Dependent Variable: Sa janë të ardhurat tuaja vjetore?

Nga analiza e kryer e regresionit linear, ku si variabël e varur është marrë niveli i të ardhurave vjetore, shihet se nuk ka ndikim signifikant në nivelin 5% ndërmjet të ardhurave dhe asaj se në universitet publik apo privat i kanë kryer studimet. Edhe pse universiteti publik merret si institucion më serioz dhe më kredibil i përfundimit të studimeve të larta, kjo nuk ka ndikim në të ardhurat vjetore të personave. Gjithashtu, me këtë kuptojmë se, pavarësisht se studimet në universitetet private kanë koston më të lartë, ato nuk arsyetohen të të ardhurat vjetore.

Coefficients^a

Model		Unstandardized Coefficients		Standardized Coefficients	t	Sig.
		B	Std. Error	Beta		
1	(Constant)	3.802	.137		27.679	.000
	Sa janë të ardhurat tuaja vjetore?	.221	.043	.292	5.153	.000

a. Dependent Variable: Cili është niveli i juaj i shkollimit?

Ashtu edhe siç pritet, ka ndikim signifikant ndërmjet të ardhurave dhe nivelit të shkollimit në nivelin 5% të signifikançës, pasi personat të cilët kanë të ardhura më të larta edhe kanë nivel më të lartë të shkollimit, meqë kjo ua mundëson që të investojnë në arsimimin e tyre. Të ardhurat në këtë rast nuk janë specifikuar.

KAPITULLI VI

KONKLUDIMET DHE REKOMANDIMET

Largimi i punëtorëve, shumica prej të cilëve të diplomuar, ka bërë që konkurrenca për vend të punës të rritet në masë të madhe dhe arritja deri te vendi i punës të jetë shumë e vështirë. Ky largim i punëtorëve vjen edhe si pasojë e mos kontrollit adekuat nga ana e institucioneve. Tregu i punës në Kosovë nuk është i segmentuar dhe jo mirë i strukturuar, e që, në këtë mënyrë, bën që kualiteti i punëtorëve dhe zbulimi i tyre të mos jetë adekuat. Numri i atyre të cilët e kanë kryer shkollimin e lartë është në rritje të vazhdueshme dhe, në këtë mënyrë, shumica e atyre të cilët aplikojnë për një vend pune kanë të kryer një nivel të lartë shkollimi, qoftë bachelor apo master.

Pas përfundimit të luftës në Kosovë janë hapur një numër shumë i madh i institucioneve shkollore. Kjo ka bërë që mundësia për të përfutur shkollim dhe diplomë të jetë e madhe. Universiteti i Prishtinës mbetet institucioni që pranon numrin më të madh të studentëve, por mbetet edhe universiteti publik që ka numrin më të vogël për metër katror për student, e që ndikon direkt në kualitetin e studimeve. Kostoja shumë e ulët e studimeve në universitetet publike ka bërë që shumë studentë të regjistrohen dhe të mos e kenë të qartë perspektivën e punësimit dhe të zhvillimit të karrierës së tyre.

Një numër i madh i tyre regjistrohen në universitetet publike dhe studimet e tyre zgjasin me vjet, shkak i mos presionit të përfundimit të studimeve për arsye të kostos shumë të ulët të shkollimit. Arsye tjetër që shkollimi i lartë nuk ndikon në mënyrë signifikante në shkurtimin ose zgjatjen e kohës së papunësisë është se trendet e zhvillimit të teknologjisë informative kanë bërë që shumë kompani t'i largojnë nga puna shumë punëtorë për arsye të automatizimit të shërbimeve, por gjithashtu edhe të uljes së shpenzimeve qeveritare dhe mosrespektimit të kontratës kolektive dhe ligjit të punës.

Shumë punëtorë diskriminohen dhe largohen nga puna, e kontratat e punës nuk respektohen. Sigurimi i një vendi të punës është proces i rëndë dhe mundësia e punësimit është shumë e vogël në një vend me ekonomi të pazhvilluar, siç është Kosova. Prandaj, koha për të cilën kërkohet

punë nuk kemi dallim ndërmjet grupeve me nivel të lartë të shkollimit dhe nivel të ultë të shkollimit.

Në bazë të asaj që u cek më lartë, mundë të konstatojë se këto janë arsyt bazë pse është hedhur poshte hipoteza bazë :

- sepse sistemi arsimor në Kosovë nuk ka lidhje të forte me tregun e punës,
- sistemi arsimor në Kosovë është i orientuar vetëm në aspektin teorikë, e aspak në atë praktikë. Gjithashtu është më shumë në dobi të sektorit publikë, se sa të atij privat.
- zgjerimi i arsimit nuk ka ndodhë në menyrë racionale me nevojat e tregut të punës (që nga paslufta e deri me sot), dhe për këtë arsye është krijuar mospërputhje në tregun e punës (në mes ofertes dhe kërkesës për punë).

Pra, kërkesa është rritur disa herë më shumë se oferta. në shumë drejtime, që do të thotë në menyrë koherente nuk është rritur numri i të diplomuarve krahas ofertës.

- Arsye tjetër pse u hodhe posht hipoteza bazë është se vazhdimi i masterit vetëm se po i bënë individët më të moshuar, e aspak nuk po ndikon në rritjen e aftësive praktikë. Këtu duhet theksuar se mosha pastaj po bëhet edhe pengesë për disa vende të punës, e sidomos në institucione financiare. Pra vetëm një titull më shumë, e jo mundësi më shumë për punësim.

Pra, papunësia në vendin tonë llogaritet të jetë ndër më të lartat apo edhe më e larta në Evropë, që do të thotë edhe zhvillimi ekonomik është më i ulët në këtë pjesë të botës.

Shtrohet pyetja: Çka duhet të bëjmë?

Shumica e firmave e paraqesin si problem faktorin human, pra kuadrot e dala nga arsimit. Mirëpo, a është arsimit në vendin tonë në nivel të njëjtë me shkallën e zhvillimit ekonomik dhe me lëmit e tjerë në vend? A është përpara apo mbrapa? A duhet që arsimit të prodhojë kuadro që do e zhvillonin vendin, apo ka mundësi që vendi të zhvillohet dhe të kemi rrije ekonomike me një arsim çfarë e kemi? Pa dyshim, pyetjet e shtrura donë një elaborim të gjatë dhe do japin

përgjigje të ndryshme. Mirëpo, shikuar në shpejtësi, por edhe nga biseda që mund të kesh me shumë sipërmarrës në vend, fitohet përshtypja se arsimi në Kosovë është, pikërisht, i njëjtë me zhvillimin ekonomik të vendit, e që për të kontribuar në zhvillimin e vendit, pa dyshim, do të ishte e nevojshme një gjendje ndryshe.

Mirëpo, si mund të bëhen ndryshimet?

Ndërlidhja e arsimit me tregun e punës, pra pjesa teorike dhe ajo praktike dhe cilat do të ishin rezultatet?

Pa dyshim, një gjë e tillë do të sillte ngritjen e nivelit të arsimit në vendin tonë. Mirëpo, të jemi konkurrentë me botën dhe të mos e kemi një papunësi çfarë e kemi, nuk mjafton një gjë e tillë.

Marrim shembull vendet e botës që kanë fuqi të lirë punëtore dhe ajo fuqi punëtore shfrytëzohet nga firmat e ndryshme që sjellin investime në vendet e tyre, bie fjala, Kina dhe India, e që një krahasim i tillë, ndoshta, duket jo shumë i drejtë krahasuar me numrin e banorëve të këtyre vendeve me Kosovën. Por, Kosova ka një përparësi tjetër, sepse gjeografikisht gjendet në kontinentin e Evropës, ku zhvillimi ekonomik, në shumicën e vendeve të këtij kontinenti të vjetër, ka arritur majat botërore dhe pagat e punëtorëve janë deri në dhjetëra herë më të mëdha se mesatarja e pagave në vendin tonë.

Pse nuk kemi investime nga firmat e këtyre vendeve në vendin tonë? Ku është problemi? Në arsimimin e fuqisë punëtore apo diku tjetër?

Arsimimi, pa mëdyshje, luan një rol shumë të rëndësishëm, mirëpo nuk është i vetmi. Problemet si: sundimi i ligjit dhe korrupsioni, siguria e investimeve, barrierat e ndryshme për të eksportuar jashtë vendit, pa dyshim, janë probleme më të mëdha sesa arsimimi i fuqisë punëtore. Megjithatë, arsimimi më i mirë, sigurisht, do të ndikonte dhe do i zgjidhte problemet e cekura më lart, duke e rritur vetëdijen e përgjithshme në vend, madje edhe krijimin e kuadrove cilësore me paga konkurruese në treg. Investimet e huaja në prodhimin e produkteve të ndryshme, veçanërisht të atyre teknologjike, u kanë mundësuar shumë kuadrove të këtyre vendeve, të cilët kanë studiuar në universitetet më të mira amerikane dhe botërore, që, pastaj, kur janë kthyer për të kontribuar në vendin e tyre, pa dyshim, kanë pasur mundësi të punojnë në firmat më të mëdha botërore, të cilat kanë investuar në vendet e tyre.

Mundësimi i bursave për studentët, për të studiuar jashtë vendit dhe kontributi i tyre pasi të kthehen në vend, paraqet një prej mundësive më të shpejta për ngritjen e cilësisë së kuadrove në vend, e edhe përmirësimin e cilësisë së arsimit në vend. Mirëpo, pa investime vendore dhe të huaja në prodhim, vlera e këtyre studentëve dhe kontributi i tyre do të jetë shumë i vogël.

Numri më i madh i pronarëve të firmave përpunuese të drurit dhe firmave të tjera, atë punë e kanë traditë të mëhershme nga familja ose atë zanat e kanë fituar nga shkollat e ndryshme profesionale. Disa prej tyre një kohë kanë punuar në firmat e tjera, si punëtor në atë punë, e disa të tjerë janë kthyer nga diaspora, ku atë punë e kanë punuar edhe atje dhe pas kthimit kanë investuar në vendin e tyre.

Nga kjo vijmë në përfundim se shkollat profesionale kanë ndikuar dhe po ndikojnë në masë të madhe në krijimin e vendeve të reja të punës dhe në rritjen e aftësive sipërmarrëse të individëve që i ndjekin këto shkolla. Forcimi i këtyre shkollave dhe hapja e shkollave të reja është e domosdoshme në vendin tonë.

Universitetet e vendit duhet të krijojnë kurikula të atilla, sa t'i aftësojnë studentët në mënyrë që pas diplomimit të kenë, të paktën, mundësi të punësimit.

Ndërkaq, përveç sistemit arsimor, që duhet t'i përshtatet nevojave të tregut e punës, shteti duhet ta ndryshojë qasjen ndaj bizneseve.

Përputhshmëria e arsimit profesional me nevojat e tregut të punës

Duke pasur parasysh nivelin e lartë të papunësisë, si dhe fluksin e madh të të rinjve që futën në tregun e punës çdo vit, atëherë, doemos, duhet të kemi një qasje shumë gjithëpërfshirëse, në mënyrë që të mund, së paku, ta zbusim këtë dukuri.

Për këtë, lidhur me përputhshmërinë e arsimit profesional me nevojat e tregut, do të përpiqemi të sjellim disa **rekomandime**:

1. Në mënyrë që t'u përgjigjemi kërkesave dhe sistemit në tregun e punës, është e nevojshme që konkurrenca të jetë sa më cilësore dhe koherente në harmoni me tregun e punës. Atëherë, fokusimi duhet të jetë në arsimimin profesional dhe përgatitjen e kuadrove. Kjo do të mund të

arrihet vetëm në sajë të një përkushtimi të të gjithë faktorëve relevantë, të cilët duhet implikuar në këtë çështje, duke filluar nga Ministria e Arsimit (MASHT), DKA, si dhe duke i shtrirë përgjegjësitë dhe dhënë kompetenca më të mëdha shkollave profesionale. Sidomos, ndarja e përgjegjësiave të shkollat profesionale dhe krijimi i lidhjeve ndërmjet shkollës dhe punës, mendoj se do të ishte një qasje më se optimale për t'i arritur efektet e kërkuara, sa i përket përshtatshmërisë ndërmjet përgatitjes profesionale dhe tregut të punës.

E para ka të bëjë me ndarjen e përgjegjësiave të shkollave profesionale, e cila do u jepte kompetenca të mjaftueshme shkollave që të hartojnë strategji adekuate, sa i përket përgatitjes profesionale specifike dhe të përgjithshme, duke pasur në punë personel të përgatitur dhe profesional të mësimdhënies dhe mësimnxënies, të cilët do të jenë të aftë në zbatimin e kurrikulave dhe planeve mësimore, si dhe menaxhimin e mirë të këtyre shkollave.

E dyta ka të bëjë me një lidhshmëri të fortë ndërmjet shkollave dhe vendeve të punës, e cila do të nënkuptonte një rritje të përvojës dhe njohje më të mirë ndërmjet punës dhe kuadrit për nivelin e arritshmërisë dhe përputhshmërisë së shkathtësive të nxënësve për profilin përkatës, që si pasojë do të kishte vendosjen e kontaktit të drejtpërdrejtë ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit, duke racionalizuar kohën dhe energjitë.

Po ashtu, edhe trajnimet e kuadrit, të cilat bëhen qoftë në vendin e punës apo nëpërmjet seminareve dhe programeve të ndryshme, janë një formë e përshtatshme për një përputhshmëri me tregun e punës. Kjo formë e ngritjes së aftësive profesionale është treguar mjaft e suksesshme, nga e cila të interesuarit i kanë ngritur aftësitë e tyre, si produktive dhe organizative, në mënyrë që të punojnë qoftë si individ apo edhe në grupe.

Të gjitha këto që i përmendëm më lart, kërkojnë një monitorim permanent, që të mund të realizohet nëpërmjet një sistemi informativ të rregullt, i cili domosdo do të përcillet edhe me implikime financiare për të cilat organet kompetente do të duhej të hartonin plane financiare konform kërkesave të paraqitura.

2. Sistemimi i të gjithë sektorëve për të arritur rezultate të dëshiruara është më se i nevojshëm. Kjo do të mund të arrihet nëpërmjet një bashkëpunimi ndërmjet sektorit privat, sektorit

joprofitabil dhe sektorit publik, të cilët, së bashku, do të hartonin programe si në sasi ashtu edhe në cilësi, ku do të vendosnin kriteret kualitative dhe të vazhdueshme. Pra, koordinimi i këtyre sektorëve do të jepte rezultatet e dëshiruara sa i përket rritjes së aftësisë profesionale, si në regjione të veçanta ashtu edhe në nivel vendi, kur kemi parasysh edhe specifikat regjionale dhe nacionale. Këtë e themi, sepse përvojat kanë treguar se ndërlidhja e shkollave profesionale me vendin e punës, kanë bërë që të njihen më mirë bizneset me kuadrin e ardhshëm. E, po ashtu, edhe njohja e kuadrit të ri me punën e ardhshme, nëpërmjet së cilës do të rritet cilësia dhe produktiviteti në punë.

3. Bashkëpunimi ndërmjet vendeve të rajonit do të ishte një mundësi e mirë për të rritur kërkesën dhe ofertën për punë, në mënyrë që të shkëmbehen përvojat dhe të njihen me përparësitë e njëri-tjetrit. Kjo është e domosdoshme në kohën tonë, sepse tregu i punës tash nuk mund të funksionojë si i izoluar, por kemi të bëjmë me një globalizim të tërë të sistemit ekonomik dhe jo vetëm. Prandaj, shkollat profesionale, të nxitura si nga MASHT-i ashtu edhe nga DKA-ja, do të ishte mirë që të mundësonin takime të rregullta, si të personelit mësimor ashtu edhe të nxënësve me shkollat e rajonit dhe më gjerë. Mirëpo, kjo do të mund të ndodhte nëpërmjet një interesi reciprok të vendeve për fushat me interes të veçantë, ku do të shkëmbehen informacione dhe përvoja.

Në këtë aspekt një bashkëpunim i veçantë duhet të jetë mes shtetit të Shqipërisë dhe shtetit tonë. Ky bashkëpunim duhet të fillojë në prodhim, në unifikim të politikave fiskale dhe doganore dhe në eksportin e energjisë elektrike.

4. Informatizimi i sistemit të integruar të arsimit profesional, duke themeluar një databazë, ku do të mundësohet një qasje më e shpejtë dhe më e plotë. Kjo është e rëndësishme për faktin se do të regjistroheshin të gjitha të dhënat për çdo nxënës, duke krijuar një pasqyrë reale për secilin nxënës, i cili nesër do të jetë kuadër i mundshëm që do të futet në tregun e punës dhe për të cilin do të posedojmë informacione të plota për cilësinë dhe personalitetin e tij. Kjo do të ndikojë, sigurisht, edhe në përkushtimin e nxënësve për të rritur aktivitetin e tyre nënxënien e mësimi teorik e praktik, si dhe në aktivitete të tjera, duke e ditur se janë në monitorim të vazhdueshëm.

5. Të zhvillohet një dialogë i vazhdueshëm në mes të Kolegjeve dhe bizneseve. Kjo të bëhet me qëllim që arsimi i lartë të jetë në hap me biznesin dhe drejtimet të jenë në përputhje me to.

Mbi bazën e krijimit të vendeve të reja të punës kemi skema të shumta, ndër të cilat do të mund ta përmirësonim gjendjen aktuale në vend. Ajo në çka do të mund të ndërhyjnë qeveria dhe ministritë përkatëse, do të ishin subvencionet në forma të ndryshme, si, për shembull:

- Skema mbi financimin e bizneseve fillestare,
- Skema mbi financimin e bizneseve në sektorin e bujqësisë.

Çdonjëri nga ne i atribuohet një drejtimi apo një profesioni mbi të cilin do të mund ta ndërtojë atë dhe të punojë në të. Prandaj, një plan biznesi mbi bazë të analizës SMART dhe analizave të tjera ndihmëse, do të ishte stimulues i vullnetit të mirë të punës mbi krijimin e vendeve të reja të punës.

Nga ajo çka sot punohet në vend, sektori bujqësor është në fazën më të hovshme të zhvillimit, prandaj subvencionet do jenë fryti më i mirë i rezultateve të rendimentit mbi kulturat bujqësore.

Qeveria dhe organet përkatëse duhet të krijojnë strategjinë e zhvillimit mbi politikën përkatëse e të punësimit dhe të vlerësojnë se në ç'masë politikat ekonomike ekzistuese janë në përputhshmëri me këtë qëllim primar, ngase nën këtë pikë do të rekomandoja: krijimin e kushteve më të mira për kredi për NVM-të dhe bizneset familjare, eliminimin e pengesave në tregti me vendet fqinje dhe, pastaj, krijimi për mundësinë e eksportimit edhe më tej, si dhe lansimi i një programi atraktiv për tërheqjen e investimeve të jashtme në forma të ndryshme.

Skema mbi financimin në sektorin e bujqësisë do të mundë të drejtohej në shumë mënyra për formën e shpërndarjes dhe për subvencionimin e qytetarit. Qeveria, fillimisht, mund t'u krijojë jetë më të lehtë qytetarëve, sidomos banorëve në zona rurale, p. sh., t'u ofrojë kushte për jetesë, bie fjala, qendër të mjekësisë familjare, rrjet telefonik e gjëra të tjera, që qytetarit do ia lehtësonin jetën.

E, kur qytetari ta ketë një jetë më të lehtë, ai aktivitetin biznesor mund ta zhvillojë edhe në fshat, ngase qytetari në zonën ku jeton edhe posedon tokë familjare, me të cilën ai e mbanë familjen.

Kjo mund të arrihet me bashkëpunim të qeverisë dhe qytetarëve në zona rurale. E, si? Qeveria t'i fillojë takimet me ta dhe të kuptojë se në çfarë forme ata dëshirojnë fillimin e punës dhe të jetësimit të bërit biznes. Dhe, nga interesimi i tyre, qeveria do të mund të aktivizonte një mekanizëm të ri të punës. E, pa dyshim, ai mekanizëm dukshëm do të ishte i mirëseardhur, ngase qytetari, së pari, nuk do të varej nga qyteti për shumë gjëra dhe si banor i zonës rurale do të mund ta shërbente, pastaj, qytetin me rendimentin të cilit i përkushtohet dhe me biznesin të cilin e bën.

Jeta normale e një qytetari do të kishte favore të shumta në këtë rast, ngase ai qytetar, i cili nis biznesin nga një subvencionim i qeverisë, jetëson produkte vendore dhe krahas kësaj ai do të punësonte më pas edhe shumë të tjerë, ngase tregu shumë shpejt do të absorbonte produkte me veti natyrale dhe produkte me cilësi të prodhimit të lartë që do të mund të arriheshin.

Dhe, nën këto përparësi, qeveria do të mund të propozonte një draft udhëzues për të gjithë të interesuarit në disa nene, si:

1. Për çdo banor të zonës rurale, i cili posedon mbi 3 hektarë tokë, qeveria e subvencionon me 30% të mbulimit të shpenzimit për mbjelljen e mjedrës;

2. Për çdo banor të zonës rurale, i cili posedon 10 krerë bagëti, qeveria e subvencion me makinë për grumbullim të qumështit;

3. Për çdo banor të zonës rurale, i cili posedon mbi 3 hektarë tokë, qeveria e subvencion me 30% të mbulimit të shpenzimeve për mbjelljen e kungujve.

Ndalemi te pika 1, ku tashmë e dimë se mjedra mund të përdoret në forma të ndryshme. Banori i zonës rurale mund ta jetësojë atë si produkt të vlefshëm dhe profitabil. Nga qeveria të propozohet edhe forma e bashkëpunimit, ngase një qytetar, nëse nuk i ka 3 hektarë tokë, ai mund të bashkohet me fqinj dhe planin e hartuar e të punuar më pas ta dorëzojnë në formë projekti dhe në bashkëpunim me organet qeveritare ta jetësojë biznesin.

Në pikën 2 kemi shumë eksportues të qumështit dhe të produkteve që vijnë nga qumështi. Prandaj, një subvencionim për të gjithë ata që posedojnë krerë bagëtish, do të ishte pasqyrë e

mirë e investimit në produkte dhe punë vendore. Qytetari me anë të pikës grumbulluese do të ishte në gjendje ta bënte shitjen e qumështit.

Në pikën 3, po ashtu, mund të kemi bashkëpunimin e pikës 1 dhe më pas produkti të jetë për treg vendor, ku plasimi i tij mund të bëhet në markete, në formë të farave dhe aty të hyjë gramazha në shumë mënyra, ashtu që blerësi të këtë shumë çmime për zgjedhje.

Spektori i bujqësisë është, ndoshta, sektori primar në të cilën mundemi lehtë të zhvillohemi dhe më pas favoret do të ishin të shumta, sepse çdo interpretim i tij ka të bëjë me përfaqësim të produktit vendor.

Kosova zhvillon një ekonomi tranzicioni dhe sot si burim më i mirë i rregullimit të tregut të punës do të ishte financimi i prodhuesve vendorë, ngase aty do të mund t'i masim efektet e zhvillimit të biznesit në bazë të prodhimit vendor. Dhe, në këtë mënyrë, ky efekt do të ndikonte direkt në rritjen e bruto-prodhimit vendor, ngase rritjet ekonomike në kuadër të prodhuesve vendorë do të na dërgonin në një stabilitet makroekonomik të vendit, e si rezultat do të kemi rritje të punësimit, pamëdyshje.

Në këtë rast politikat e shtetit do të duhej të ishin të matura, ngase çdo vendim i marrë në politikën fiskale nuk është i lehtë shkaku se ndryshimi i një variable mund të shkaktojë ndryshimin e variablave të tjerë dhe të marrë kah të gabuar. Për shembull, do të mund të kishim rënie të konsiderueshme të importit, me ç'rast prodhuesit vendorë do të mund të vendosnin çmimin pa ndonjë "pengesë" shtesë. Por, hartimi i politikave fiskale, në këtë rast, do të duhej t'i stimulonte prodhuesit vendorë deri në atë masë sa të pranohej çmimi i produkteve në treg dhe prodhuesit vendorë të mos "goditen" nga importi.

Por, shteti në hartimin e politikave fiskale dhe stimulimin e prodhuesve vendorë do të mund të ndërtonte politika të veçanta, si:

- Lehtësimi mbi eksportin e prodhuesve vendorë.

Dhe, si ta bënte këtë?

- Për çdo prodhues vendor, i cili eksporton në vendet në rajon, do të ketë lirim të taksave deri në vlerën 5.000 euro për produkte.

Kjo do i krijonte favore kompanisë “VIPA chips”, e cila, si lider në tregun tonë, eksportin do e zhvillojë edhe më tej dhe këtë ta bënte pa embargo. Ky përfitim do të mund t’ia lehtësonte qarkullimin ditor, javor, por edhe vjetor.

Prodhuesit vendorë tanimë adresarin e tyre duhet ta kenë të orientuar në politikat e shtetit, sepse vendet e rajonit i kanë hapur korridoret. Shembull, sikur “VIPA chips” të bëjë eksportin e patateve në vendet në rajon dhe shteti favoret t’i ndërtojë mbi:

1. Bazën e vlerës eksportuese,

2. Bazën e shtimit të punësimit.

Baza e vlerës eksportuese për çdo vlerë të eksportit deri në 5.000 euro vlerë të mallit, tatimi të jetë 70% më lirë se në pragun aktual dhe pa kufizim të punëtorëve, se për çdo vlerë të kësaj sasie eksportuese të marrë punëtorë të rinj, e ata punëtorë të kenë kontratasezonale, kurse më vonë për aftësitë e tyre të kenë edhe kontrata afatgjata.

Vendimi i marrë për ndryshimin e TVSH-së nga qeveria është, po ashtu, një element më shumë, i cili nuk mund t’i ikë rekomandimit tonë. Vendimi i tillë ndihmon zhvillimin e bizneseve dhe shpërndarjen e barrës tatimore te të gjithë pjesëmarrësit. Ana më e fortë pozitive nga ulja e tatimit vjen nga ulja e tatimit në produktet themelore, ngase tash qytetari me të hyra mesatare mund të kërkojë produktin me çmim të cilin mund ta përballojë.

E, çka do të përfitonim me këtë rast?

Me përshkallëzim të politikave fiskale do të mund të liroheshim sado pak nga ngërçi i të zhvilluarit biznes me politika të rregullta dhe me liri të nivelit të zhvillimit të punës. Kjo nënkupton se deri më tani bizneset kanë qenë të ngarkuara dhe nuk do të mund të punësonin punëtorë të tjerë, por edhe ata që i kishin i kanë mbajtur pa kontrata të rregullta të punës ose në mënyra të tjera, që kanë sjell deri në evazion fiskal nga ana e biznesit. Themi, po ashtu, se përshkallëzimi i politikave tatimore në vend mund të hapë sado pak rrugën për rimëkëmbje të bizneseve dhe shtim të volumit të punës dhe të numrit të punëtorëve në ndërmarrjet e tyre.

KAPITULLI VII

LISTA E REFERENCAVE DHE SHKURTESAVE

1. Abdel Mowla, Somaya A., *“Vulnerable Employment in Egypt”*, 2011, fq. 43
2. A. Sakamoto, D. A. Powers, *“Education and the dual labor market for Japanese men”*, 1995, fq. 44
3. Anketa e fuqise punetore (AFP) te zyrove kombetare te statistikave, *“Nivelet e papunësisë, EJL6 dhe BE10*, 2012, fq. 65
4. Agjensia Kosovare e Statistikave, *“Migrimi Kosovar”* 2014, fq. 106
5. Agjensia Kosovare e Statistikave, *“Raporti i ASK-së”*, fq. 53, prill 2014, fq.110
6. Andersen, Bjørn., M. Moen Rune, *“Integrating benchmarking and poor quality cost measurement for assisting the quality management work”*, 1999, fq.44
7. Acemoglu, Daron., *“Technical Change, Inequality, and the Labor Market”*, 2002, fq. 41,51
8. Abdullahi , I.B., *“Budgetary Allocations and Selected Sectors’ Contribution to Economic Development in Nigeria”*, 2008, fq. 44
9. Ashenfelter, Orley,. and Ham, John., *“Education, Unemployment, and Earnings”*, 1979, fq. 42
10. Adetunji Babatunde, Musibau, & Adefabi, Rasak Adetunji., *“Long Run Relationship between Education and Economic Growth in Nigeria: Evidence from the Johansen’s Cointegration Approach”*, 2005, fq. 45
11. Aykac Alpa, Elcin., & Sefilb, Sinem., & Kursat Sakc, Ali, *“The Impact of Education Level and Gender on Job Search Duration in Turkey”*, 2000, fq. 42
12. Banka Botërore, *“Anketa e migrimit”* 2010, Fq. 100
13. Banka Botërore *“Raporti Final”* 2012 fq. 64
14. Banka botrore dhe europa juglindore *“ Raporti i zhvillimit ekonomik”* nr.3, 2002, fq. 99
15. Bratberg, E. and O. A. Nilsen, *“From School to Work: Search Time and Job Duration”*, 1998, fq. 43
16. Barro, Robert, *“Human Capital and Growth”*, 2001, fq. 45,46
17. Ramosaj, Berim., *“Bazat e menaxhmentit”*, Prishtinë, 2002, fq. 25

18. Becker, Gary S, J. Philipson Tomas and R. Soares Rodrigo, "*The Quantity and Quality of Life and the Evolution of World Inequality.*" *American Economic Review*", fq. 277-291, 2005, fq.43,44
19. Becker, G. S, "*Human Capital. New York: National Bureau of Economic Research*", 1976
20. Benhabib & Spiegel, "*The role of human capital in economic development evidence from aggregate cross-country data*",1994, fq. 45
21. Bertola, Giuseppe, & D. Blau, Francine, & M. Kahn, Lawrence, "*Comparative Analysis of Labor Market Outcomes: Lessons for the U.S. from International Long-Run Evidence*", 2002, fq. 50
22. Barro & Lee, "*International Comparisons of Educational Attainment*", 1993, fq. 45
23. Bound, John and Johnson, George., "*Changes in the Structure of Wages in the 1980's: An Evaluation of Alternative Explanations*", 1992, fq. 41
24. Brookings Papers on the Unemployment Rate, "NBER Macroeconomics Annual.Klasen, S, *Does Gender Inequality Reduce Growth and Development?*", 1999.
25. Biagi, Federico & Lucifora, Claudio., "*Demographic and Education Effects on Unemployment in Europe: Economic Factors and Labour Market Institutions*", 2005, fq. 42
26. Blackburn, McKinley L, "*What can explain the increase in earnings inequality among males?*", 1990, fq. 41
27. Card, David., "*The Causal Effect of Education on Earnings*", 1999, fq. 40
28. De la Fuente, Angel. and Ciccone, Antonio., "*Human capital in a global and knowledge based economy, Final Report, European Commission Directorate General for Employment and Social Affairs*, 2002, fq. 28
29. Dickens, William T, Kevin Land, "*A test of Dual Labor Market Theory*", 1985, fq.41
30. Dickens, W. T., Sawhill, I. and Tebbs, J. "*The Effects of Investing in Early Education on Economic Growth. Policy Brief*",fq 153, 2006, fq.44
31. Dahlin, Peter., "*Structural Change of Business Networks, Developing a structuration Technique*", 2005, fq. 45
32. Dornbusch, Rudiger., & Fisher, Stanly., "*Makroekonomia*" 2003, fq. 118

33. European Social Statistics, “*Dinamika e tregut të punës në Republikën e Kosovës*” fq. 198, 2006
34. European Commission Directorate General for Employment and Social Affairs, Final Report, 2002
35. Eurostat, “*Pagat minimale në shtetet ballkanike*” 2015, fq. 80
36. Francesconi, Marco., “*Education and the Natural Rate of Unemployment*”, 2000, 43
37. Goldin, Claudia., A. Margo, Robert “*The Great Compression: The Wage Structure in the United States at Mid- Century*”, 1992, fq.40
38. Grossman, Gene M., & Helpman, Elhanan, “*Quality Ladders in the Theory of Growth*”, 1991, fq. 45
39. Glewwe et. al., “*Early childhood nutrition and academic achievement: a longitudinal analysis*”, 2001, fq. 46
40. Guang, H. J.. “*Job Rotation from the Employees’ Point of View, Research and Practice in Human Resource Management*, 1999, fq. 48
41. Hoti, Avdullah., “*Procesi i tranzicionit dhe tregu i fuqisë punëtore*”, nëntor 2008, fq. 122
42. Haas, De., Migrimi dhe zhvillimi – “*Instituti ndërkombëtar i migrimit. Universiteti i Oksfordit “Një perspektivë teorike”* 2008, fq. 103
43. Hanushek & Wößmann, “*Education Quality and Economic Growth*”, 2007, fq. 45
44. Haouas, Ilham., & Yagoubi, Mahmoud., & Heshmati, Almas., “*The impacts of trade liberalization on employment and wages in Tunisian industries*”, 2005, fq. 45
45. Heneman, H. G. III, Schwab, D. P., Fossum, J. A., & Dyer, L. D.
“*Personnel/Human resource management. Homewood, IL : Irwin Inc*” 1986, fq. 52
46. Hersch, Joni., & Stratton, Leslie S., “*Housework and Wages*”, 2000, fq. 42
47. Ismaili, Hava., “*E drejta e punës*”, 2010, fq. 46
48. Instituti KIPRED, “*Kosova drejt BE-së: Migrimi i parregullt, sfidat, fq. 9-10 nr. 1/15*”, mars 2015, fq. 104,106
49. Jayaweera, Swarna, “*Women, Education, and Empowerment in Asia*’, *Gender and Education*” Vol. 9, no. 4, 1997, fq. 43
50. Jimeno & Rodriguez-Palenzuela, “*Youth unemployment in the OECD: demographic shifts; labour market institutions, and macroeconomic shock*”, 2002, fq. 51
51. Jungsoo Park, “*Dispersion of human capital and economic growth*”, 2006, fq. 45

52. Justi & Driel, *“The use of the Interconnected Model of Teacher Professional Growth for understanding the development of science teachers’ knowledge on models and modelling”*, 2006, fq. 46
53. Kuvendi i Republikës së Kosovës, *“Propozim për Kornizë Nacionale të Kualifikimeve të Kosovës”*, 2011, fq. 79
54. Kettunen, J. *“Education and unemployment duration, Economics of Education Review”*, 1997, fq. 41
55. Karoly, P. *“Pain-specific beliefs, perceived symptom severity, and adjustment to chronic pain”*, 1992, fq. 41
56. Katsanevasl, Theodore, & Livanos, Ilias., *“Unemployment in Greece: trends and main causes”* 2005
57. Katz & Murphy, *“Changes in Relative Wages”, 1963–1987 “ Supply and Demand Factors”*, 1992, fq. 41
58. Koster, M.H. *“Wages and Demographics” in M.H. Kösters (ed.) Workers and their Wag, Washington: AEI Press”*, 1991, fq. 41
59. Kiefer, N. M, *“Evidence on the role of education in labor turnover. The Journal of Human Resources”*, 1985, fq. 42
60. Klevmarken & Quigley, *“Age, Experience, Earnings and Investments in Human Capital”*, 1976, fq. 52
61. KEPE, *“Education and labour market, Study no. 50”* 2003, fq. 49
62. KEPE, *“Education and Employer-rl, Economic news, 3”* 2003 fq. 49
63. Korenman, S. and Neumark, D., *“Cohort crowding and youth labor markets: a cross-national analysis”*, *NBER Working paper 6031*” 1997, fq. 51
64. Komoni, Sabahudin., *“Financat”*, Prishtinë, 1976, fq. 125
65. Lazear, Edward P., *“Wage Differentials Are Larger Than You Think”*, 1996, fq. 52
66. Livanos, Ilias., *“Market in Greece: the Weakest Link”*, 1999
67. Lang, Kevin., *“Pareto Improving Minimum Wage Laws”*, 1987
68. Labour Market Policy, *“Expenditure and Participants”*, 2004
69. Legjislacioni i Kosovës, *“Liqji nr. 03/L-147”*, 2011, fq. 70

70. Loening, *“Estimating Human and Physical Capital stocks in data-scarce Environments: A Methodological note and Application to Guatemala”*, 2002, fq. 46
71. Limani, Musa., Ligjërata të autorizura, *“Ekonomiksi i zhvillimit të Kosovës”*, 2006, faqe 132, fq. 124, 129
72. Lucas, Robert E., Jr, *“On the Mechanics of Economic Development”*, 1988, fq. 45,46
73. Mankiw, N. Gregory & Taylor, Mark P., UET Press, *“Economics, South-Western, Centage Learning”* 2012. fq. 87
74. Manqellari, Ahmet., *“Tregtia ndërkombëtare”*, 2013, fq.128
75. McMahon, *“Education and Growth in East Asia”*, 1998, fq. 46
76. Mincer, J. *“Education and Unemployment”*, NBER Working Papper, n° 3838, September”, 1991, fq. 48
77. Moreau & Leathwood, *“Graduates' employment and the discourse of employability: a critical analysis”*, 2006, fq. 48
78. Nickell, S, *“Education and lifetime patterns of unemployment. The Journal of Political Economy”*, 1979, fq. 42,44,48
79. Nickell & Bell, *“Changes in the Distribution of Wages and Unemployment in OECD Countries”*, 1996, fq. 51
80. Olaniyan D.A. & T. Okemakinde, *“Human Capital Theory: Implications for Educational Development”*, 2008, fq. 46
81. Psacharopoulos, George., & Patrinos , Harry Anthony, *“Returns to Investment in Education”*, 2002, fq. 80
82. Phelps, Edmund S. and Zoega, Gylfi, *“Natural Rate Theory and OECD Unemployment”* *Economic Journal*, May 1998, fq. 43
83. Phelps dhe Zoega, *“The Rise and Downward Trend of the Natural Rate”* , 1997, fq. 43
84. Psacharopoulos, G. and Woodhall,M. *“Education for Development: An Analysis of Investment Choice. New York Oxford University Press”*, 1997, fq. 44,48,49
85. Porath, Ben., *“Market Government and Israel’s Muted Baby Boom Economics of Changing Age Distribution in Developed Countries”*, 1988 fq. 52
86. Qirici, Stefan., *“Ekonomiksi i punës”*, fq.26, 2005, fq. 28,30,131

87. Qirici S., & Hadri S., & Kule, Dh. & Manqellari A., *“Hyrje në ekonomi”*, Tiranë, 2000, fq. 119,123
88. Rom, Paul M ., *“Endogenous Technological Change”*, 1990
89. Rebelo, Sergio., *“Long-Run Policy Analysis and Long-Run Growth”*, 1991, fq. 45
90. Raporti nr. 60590 – XK, *“Migrimi dhe zhvillimi ekonomik në Kosovë”*, 25 maj 2011. fq. 100,102
91. Raporti i ASK-së, fq. 53,, prill 2014, fq. 110
92. Raportet e Komisionit Evropian” , 2003, fq. 49
93. Riinvest- *“Qëndrueshmëria ekonomike e Kosovës” (Sfidat, politikat dhe mundësitë)*, 2006, fq. 25
94. Riinvest *“Ekuilibri i tregut të punës”*, Prishtinë, 2003, fq. 54,86
95. Revenga, Ana L., Exporting Jobs, *‘The Impact of Import Competition on Employment and Wages in U. S. Manufacturing’*, 1992
96. Romer, *“Endogenous Technological Change”*, 1990, fq . 45
97. Salop, Steven., *“Monopolistic Competition with Outside Goods”*, 1979, fq. 44
98. Schultz, Theodore W., *“Investment in Human Capital”*, 1961, fq. 44,45
99. Strauss & Thomas, *“Human resources: Empirical modeling of household and family decisions”*, 1995, fq. 44
100. Smith, *“Knowledge and Values”*, 1976, fq. 47
101. Shimer, Robert, *“The impact of young workers on the aggregate Labour Market”*, 2001, fq. 51
102. Teulings, C.N. *“The Wage Distribution in a Model of the Assignment of Skills to Jobs”*, 1995, fq. 40
103. Teulings, C.N. *“Comparative advantage, relative wages, and the accumulation of human capital”*, 2005, fq. 40
104. Tilak, Jandhyala B. G., *“Economic Slowdown and Education Recession in Latin America”*, 1989, fq. 40,45
105. Tobin, James., *“International conference on Towards future sustainable development”*, 1986

106. Theodossiou and Zangelidis, *"Should I stay or should I go? The effect of gender, education and unemployment on labour market transitions"*, 2009, fq. 42
107. Thurow, Lester C., *"Economic Paradigms and Slow American Productivity Growth"* 1987, fq. 41
108. Woolbers, M.H., *"The effects of level of education and mobility bet on employment and unemployment in the Netherlands"*, *European Sociological Review*", 2000 fq. 48
109. Welch F., *"Effects of Cohort Size on Earnings : The Baby Boom Babies' Financial Bust"*, *Journal of Political Economy*, pp. S65-97", 1979, fq. 52
110. Zimmer, Timothy,. *"The Importance of Education for the Unemployed Based on a working paper"*, 2000, fq. 40
111. Zimmermann, Klaus F. , *"Ageing and the labor market, Age structure, cohort size and unemployment"*, 2005, fq. 51
112. Zyrrat statistikore kombëtare, *"Anketa e migrimit në Kosovë"*, 2009, fq. 65
113. http://www.worldbank.org/content/dam/Worldbank/document/SEERER_3_Report_FINAL_Albanian.pdf<http://www.bspk.org/rrethnesh.html> 2001
114. <https://mpms.rksgov.net/Portals/0/Ligji/Ligji%20per%20organizimin%20sindikal.pdf>
115. <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-212-alb.pdf>
116. <http://open.data.al/sq/lajme/lajm/lang/sq/id/1029/Pagat-Minimale-ne-Shqiperi--Rajon-dhe-Europe>,
117. <http://shqiptarja.com/neës.php?IDNotizia=280136>, Paga minimale në shtetet evropiane.